



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

## **RAPORT VJETOR**

**Për veprimtarinë e institucionit  
të Avokatit të Popullit**

**1 Janar – 31 Dhjetor**

**Viti 2017**

**Tiranë, Prill 2018**

# PËRMBAJTJA

## Faqe

Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit

### **KREU 1**

Vështrim i përgjithshëm për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2017

### **KREU 2**

Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut sipas fushave

- 2.1. Të drejtat e personave të privuar nga liria
- 2.2. Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit
- 2.3. Parandalimi i dhunës dhe torturës
- 2.4. Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria
- 2.5. E drejta për një proces të rregullt ligjor në Gjykatë
- 2.6. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative
- 2.7. Ndihma Juridike
- 2.8. Respektimi i të drejtës së pronës
- 2.9. Veprimtaria e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), në Bashki
- 2.10. Organet e Qeverisjes vendore
- 2.11. E drejta për kujdes shëndetësor
- 2.12. E drejta për arsimim
- 2.13. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut
- 2.14. Mbrojtja e konsumatorit
- 2.15. E drejta për strehim
- 2.16. E drejta për informim

### **KREU 3**

Grupet vulnerabel dhe respektimi i të drejtave të tyre

- 3.1. Ndihma Ekonomike
- 3.2. Të drejtat e fëmijëve
- 3.3. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- 3.4. Barazia gjinore dhe të drejtat e personave LGBTI
- 3.5. Të drejtat e të moshuarve
- 3.6. Të drejtat e minoriteteve

### **KREU 4**

Avokati i Popullit dhe roli proaktiv në respektimin e të drejtave të njeriut

- 4.1. Shërbimet ndaj qytetarëve
- 4.2. Ndryshimet legjislative
- 4.3. Konferenca kombëtare

### **KREU 5**

Rritja e angazhimeve institucionale të Avokatit të Popullit

- 5.1. Reforma në drejtësi
- 5.2. Respektimi i të drejtave të migrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve
- 5.3. Monitorimi i Pavarur i Kthimeve të Detyruara të qytetarëve shqiptarë
- 5.3. Monitorimi i zgjedhjeve të përgjithshme

### **KREU 6**

Bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja

- 6.1. Bashkëpunimi me institucionet e Administratës Publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së
- 6.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar
- 6.3. Bashkëpunimi në kuadër të projekteve
- 6.4. Projekti Danez

## **KREU 7**

Shërbimet mbështetëse

7.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

7.2. Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

7.3. Forcimi i kapaciteteve

## **KREU 8**

Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

8.1. Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të shqyrtuara

8.2. Rastet e mbartura në vite



## FJALA E HAPJES PËR RAPORTIN VJETOR TË AVOKATIT TË POPULLIT, 2017

Viti 2017 ka qenë një vit ndryshimesh për Institucionin e Avokatit të Popullit. Një etapë e re ka nisur në sfidën tonë të përhershme me veten dhe jo vetëm, për të rritur dhe forcuar raportin tonë të ngushtë me qytetarët.

Një provë e këtij përkushtimi, ishte edhe pranimi i afro 5000 ankesave për vitin 2017 si dhe shtimi i përpjekjeve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut kudo ku Avokati i Popullit e pati një zë apo një hapësirë veprimi.

Mirëpo, viti 2017 e pa institucionin tonë kushtetues – madje edhe përpara ndryshimit të gjeneratës së drejtuesve të tij - të përfshirë në procese të rëndësishme e të reja deri në atë moment për rolin e tij.

Reforma në Drejtësi ishte një nga frontet ku Avokati i Popullit, pavarësisht pengesave interpretative dhe buxhetore, e përmbushi me sukses detyrën e tij duke konfirmuar edhe një herë se ky institucion mbetet një adresë reference për pavarësinë, paanësinë dhe drejtësinë e tij.

Sigurisht, tani një vit më vonë, është koha e analizës. Është momenti i shqyrtimit të punës së bërë dhe ky Raport që keni në duar, është një sintezë e kësaj analize për punën. Analizë të cilën stafet tona e kryejnë me përkushtim çdo ditë.

Përtej punës së përditshme me njerëzit, luftës për të çuar përpara kauzat e tyre në dukje të vogla e vetjake e përmes tyre kauzën e madhe të ndërtimit të një shoqërie më të drejtë, ka gjithsesi vend për reflektim të thelluar strategjik.

Ky institucion jeton për të luftuar për njerëzit, por cilat janë arsytet që i bëjnë sot shumë shqiptarë që ende të kenë nevojë ta fitojnë me luftë të drejtën e tyre?

Rreth 5000 ankesa që ata i kanë adresuar Avokatit të Popullit për zgjidhje në raport me autoritetet s'janë veçse një fraksion i vogël i përmasës gjiganteske së marrdhënies së ndërlikuar mes qytetarit dhe autoritetit.

Çfarë qëndron në origjinën e mosmarrëveshjes? Pse autoriteti ynë demonstroi një shkallë ende shqetësuese të nëpërkëmbjes së qytetarit të vet? Pse prona, shkollimi, shëndeti apo puna e qytetarit

nuk është akoma e sigurt? Çfarë reziston në zanafillën e arbitraritetit, inkompetencës apo korrupsionit?

Arsyet janë të shumta, jo lehtë të detektueshme. Gjetja shteruese e shkaqeve apo zgjidhja e pasojave që ato krijojnë, do të meritonte një çmim Nobel. Por në këtë fjalë hyrëse po paraqes një prej tyre, për të cilin duhet vetëm vullnet qytetar për të bërë ndryshimin.

Mjerisht, Shqipëria dhe shoqëria e saj mbeten ende nën vargonjtë e asaj që njihet me emrin gjuha e urrejtjes. Dhe është pikërisht kjo gjuhë urrejtjeje, ajo që besojmë se përbën një nga arsyet më të shpërfaqura, më të dukshme e më pak të luftuara të gjendjes që përshkruam më lart.

Gjuha e urrejtjes gjeneron reperkursionë të dëmshme e të rrezikshme për pothuajse çdo aspekt të marrdhënieve mes shtetit, individit e shoqërisë. E maskuar me tisin e kometicionit politik, gjuha e urrejtjes është ekzistenca e një gjendjeje të përhershme lufte mes dy kampeve, e madje edhe garancia se vërtet të gjithë pa përjashtim jemi të ndarë në dy garnizone ndërluftuese që duan të asgjësojnë njëra-tjetrën.

Gjuha e urrejtjes ndaj tjetrit, të ndryshmit, të huajt ekziston vetëm me premisën që duhet të ekzistojë edhe tjetri, i ndryshmi dhe i huaji. E zakonisht, ky njeri “tjetër”, “i ndryshëm” e “i huaj”, s’është askush pos sërish një shqiptar tjetër.

Kjo gjuhë urrejtjeje që kultivohet në trajtë piramidale nga lart poshtë, modelon sipas shëmbëlltyrës së saj edhe ata që e marrin për referencë. Gjuha e rëndë e urrejtjes në fushatat politike, në Kuvend e në institucione, transferohet e pandryshuar, thuajse në gjendje frigoriferike edhe në zyrat poshtë, aty ku emërimet shpesh perceptohen si revansh ndaj armikut, e ku posti shpesh supozohet si mjet për të ushtruar supremacinë mbi të mundurin.

Janë pastaj këto zyra e këta nëpunës pika e kontaktit të parë të qytetarit me vrazhdësinë e autoritetit. Janë këto vende, skena ku luhet e interpretohet në një shoë të përditshëm e të pandalshëm, “shfaqja” e gjuhës së urrejtjes ndaj tjetrit, të ndryshmit, të pafuqishmit, të mundurit e të voglit.

Është kjo gjuhë dhe psikologji e urrejtjes e cila pastaj kontaminon dhe helmon edhe mendjen e pësuesve të saj. Është ajo që mbartet më pas në familjet e varfra shqiptare, ku jeta e gruas, fëmijës, të moshuarit apo të sëmurit, befash zhvlerësohet. Është kjo gjuhë urrejtjeje ajo që zëvendëson komunikimin normal mes njerëzve, është kjo mendësi urrejtëse ajo që i shndërron në atentatorë me pseudonim “komentatorët” në mediat sociale e jo vetëm.

Është falë frymëzimit nga gjuha e urrejtjes prej lart, që lindin tragjeditë e rënda poshtë, krimet monstruoze në qelizën e shoqërisë dhe lëkundja shkatërrimtare e vetë themeleve të saj.

Patëm rastin ta shohim gjuhën e urrejtjes në veprim madje edhe deri gjatë një procesi të rëndësishëm, ku edhe Institucioni i Avokatit të Popullit ishte aktor i dorës së parë: bëhet fjalë për reformën në drejtësi dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të reja.

A nuk iu nënshtruan më se një herë konkurrentët në këto procese shënjestrimit denigrues, dhe intimidues të gjuhës së urrejtjes me frymëzim dhe orkestrim politik? Vërtet duhet të ndjehemi fatlumë që në këtë peizazh kaq të zymtë e dekurajues gjithsesi pati njerëz me kurajo që e tejkaluan

këtë provë nervash e durimi. Por mbetet gjithsesi kureshtja për të parë nëse bombardimet rrënuese që artileria frenetike e urrejtjes kreu në themelet e kësaj reforme, i kanë lëkundur apo jo bazat e saj të besimit në të ardhmen.

Gjuha e urrejtjes, ndërgjegjësimi dhe shërimi prej saj, mbetet në gjykimin tonë një nga sfidat tona më të mëdha të viteve që vijnë. Kushdo prej nesh që sot mban një zyrë shtetërore duhet të nisë të mendojë kurën për të shpëtuar fillimisht veten prej saj. Të jemi të sigurt, se ky do të ishte në instancë të fundit, një rreze frymëzuese çlirimi për vetë Shqipërinë tonë.

Erinda Ballanca

## **KREU 1**

### ***Vështrim i përgjithshëm për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2017***

Avokati i Popullit në Shqipëri, si një institucion i promovimit, parandalimit dhe mbrojtjes ndaj shkeljes së të drejtave të njeriut, përbën një pjesë integrale të sistemit të kontrollit dhe balancës, i cili është sot një parim bazë i qeverisjes demokratike në të gjithë botën e qytetëruar.

Duke bërë pjesë në familjen e madhe të institucioneve të krijuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, shtetasve shqiptarë, të huajve, rezidentëve të rregullt ose jo në Shqipëri, refugjatëve, si dhe personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike. Ai është mbi çdo gjë një autoritet moral për të cilin kemi kaq shumë nevojë.

Duke pasur juridiksion administrativ, mbrojtja e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të individit, kryhet në kuadër të veprimtarisë së administratës publike si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, me përjashtimet e parashikuara në ligj.

Avokati i Popullit duhet vlerësuar si një institucion i cili ekzistencën e tij nuk e mbështet tek “forca shtrënguese e shtetit”, por tek misioni i tij universal, që përçon respektin e shtetit ndaj individit dhe vlerave që mbart qenia njerezore. Mjeti ligjor i tij kryesor është rekomandimi, gjë e cila e identifikon atë si një organ jo-penalizues.

Për këto arsye, Avokati i Popullit bën pjesë në ato institucione, të cilat siç parashikohet edhe nga Parimet e Parisit, janë “garante të demokracisë, të shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut”. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe specifikisht ligji organik nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, përcakton mandatin dhe objektin e veprimtarisë së tij. Sipas ligjit të tij organik, Avokati i Popullit veç detyrave të caktuara në këtë ligj, mund të kryejë edhe detyra të tjera, të caktuara në ligje të veçanta.

Është rasti i paketës ligjore të reformës në drejtësi, që i ngarkon Avokatit të Popullit kompetenca të rëndësishme për mbarëvajtjen e procedurave që lidhen me organizimin, administrimin, verifikimin dhe drejtimin e strukturave që ndihmojnë procesin e përzgjedhjes fundore të kandidaturave nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Këto procedura lidhen me verifikimin e kandidaturave për anëtarë të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, verifikimin e kritereve formale ligjore për kandidatët nga rradhët e avokatisë, të cilët shprehin interesin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ashtu si dhe për kandidatët që shprehin interesin nga rradhët e Shoqërisë Civile, për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Po kështu një kompetencë e rëndësishme ka të bëjë me monitorimin e proceseve, që lidhen me funksionimin e organeve që administrojnë drejtësinë, sikurse Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Nëpërmjet kësaj përmbledhje ekzekutive, kemi si qëllim që të japim një paraqitje transparente të konstatimeve, gjetjeve, si dhe opinioneve e rekomandimeve të përgatitura gjatë vitit 2017, për gjendjen dhe përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vend.

Gjatë vitit 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur një sërë arritjesh ku, ndërmjet të tjerash,



mund të përmenden realizimin me sukses të angazhimeve të Avokatit të Popullit në kuadër të zbatimit të Reformës në Drejtësi; forcimi i rolit dhe partneritetit në raport me organet qendrore të administratës publike, veçanërisht për sa i përket proceseve të iniciativave legjislative; rritja e pranisë aktive në mekanizmat ndërkombëtarë që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; forcimi i bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë në funksion të fuqizimit dhe mbështetjes institucionale të Avokatit të Popullit.

Sfidë mbetet krijimi i një administrate publike më të ndjeshme dhe llogaridhënëse ndaj opinionit publik dhe më të përgjegjshme ndaj kërkesave për drejtësi dhe besueshmëri; krijimi i një kulture demokratike të respektimit të të drejtave të njeriut; rritja e besueshmërisë së institucionit të Avokatit të Popullit tek qytetarët; ngritja dhe funksionimi i mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga administrata publike.

Gjatë vitit 2017, rezulton se nga 188 rekomandime të adresuara në total, 24 janë pa përgjigje; 29 Rekomandime të Refuzuara, 123 Rekomandime të Pranuara; pjesa tjetër në proces shqyrtimi. Nga numri i rekomandimeve të pranuar, rezultojnë 80 rekomandime të zbatuara ose pjesërisht të zbatuara, 19 rekomandime të pazbatuara dhe 24 rekomandime të tjera, të cilat janë pranuar në parim.

Problematik mbetet dhe moskthimi me korrektesë i përgjigjeve të shkresave për shpjegime nga institucionet shtetërore (kujtojmë që në disa raste shkresat u janë dërguar më shumë se një herë institucioneve shtetërore), duke penguar kështu hetimin administrativ që kryhet nga ana jonë.

Evidentojmë gjithashtu me shqetësim se në mjaft raste, nuk jemi ftuar për të dhënë mendim për projektligje, apo akte të tjera normative, të cilat lidhen me Liritë dhe të Drejtat e Njeriut.

Gjatë këtij viti, nga Institucioni i Avokatit të Popullit **janë trajtuar në total 4546 ankesa, kërkesa dhe njoftime** (duke përfshirë dhe ato të pritjes së qytetarëve). Ankesat e shqyrtuara sipas seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017 kanë qenë gjithsej 1752.

Nga zyra e pritjes së qytetarëve, 2408 ankesave, u është dhënë përgjigje menjëherë, ndërsa 386 ankesave u është dhënë përgjigje në formën e këshillimeve shkresore.

Nga të dhënat, rezulton se 101 ankesa kanë qenë jashtë juridiksionit, 163 ankesa jashtë kompetence, 412 ankesa të pabazuara, 32 Ankesa prej të cilave është hequr dorë, 490 Ankesa të pranuar pa Rekomandim (të zgjidhura në favor të qytetarëve).

Ndërkohë, ankesat e shqyrtuara sipas seksioneve janë:

Seksioni i Administratës	604 ankesa
Seksioni i Veçantë	574 ankesa
Seksioni i Përgjithshëm	412 ankesa
Njësia e parandalimit të Torturës	98 ankesa
Seksioni i Fëmijëve	64 ankesa

Gjatë vitit 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë proaktive, si dhe me kërkesë të institucioneve të ndryshme shtetërore ka dhënë mendimet dhe sugjerimet e tij, lidhur me një sërë projektligjesh dhe aktesh të tjera normative.

**Respektimi i të drejtave në institucionet penitenciare** është një fushë e monitoruar në vazhdimësi nga Avokati i Popullit. Personat e paraburgosur dhe të dënuar, që ndodhen në institucionet

penitenciare gëzojnë pjesërisht të drejtat e përcaktuara në nenet 5, 11, 23-28, 30, 32-42, të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

Përgjithësisht, ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim nuk janë projektuar, ndërtuar apo rikonstruktuar, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat për një jetë normale, me hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, apo për plotësimin e standardeve në mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes. Veçanërisht shqetësues është përdorimi i vazhdueshëm i ambienteve të observimit dhe veçimit, si ambiente banimi për efekt mbipopullimi apo të mospërshtatjes.

Detyrimi ligjor për veshje dhe pajisje të tjera individuale në sasi të mjaftueshme, në gjendje të mirë dhe të pastra, të tilla që të sigurojnë plotësimin e kërkesave normale të jetesës, nuk plotësohet në asnjë rast.

Në mungesë të ngritjes së institucionit të posaçëm me qëllim dhe trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale, për të cilët gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”, në bazë të nenit 46/2 të Kodit Penal, dhe persona ndaj të cilëve gjykatat kanë caktuar masën shtrënguese, “shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik” në bazë të neneve 46, 232/e dhe 239 të Kodit të Procedurës Penale, trajtimi i kësaj kategorie kryhet në kushte burgu.

Ka probleme të qenësishme në ofrimin e shërbimit shëndetësor dhe atij psikosocial, në ofrimin e mundësisë për arsim dhe për kurse të formimit profesional, sikurse dhe probleme në lidhje me shpërblimin e punës së kryer. Në tërësinë e vet trajnimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve nuk është në përputhje me synimin për rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, si rrjedhojë e problematikave në përfitimin e lejeve shpërblyese, në bashkëpunimin e munguar apo të cunguar me shërbimin e provës, shërbimet e mirëqenies sociale, organet vendore dhe organizatat jofitimprurëse në hartimin e programeve të riintegritimit në prapërlirimi.

***Në respektimin e të drejtave në organet policore*** janë konstatuar probleme në komisariate e që lidhen kryesisht me mospërbushjen e detyrimeve ligjore për ndërtimin, apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit, sipas standardeve të parashikuara në Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, si dhe me mospërbushjen e detyrimeve ligjore për ndërtimin, apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara dhe të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe Manuali i “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore”. Në disa raste janë konstatuar persona që flinin me shtroje përtokë, gjë që përbën trajtim çnjerëzor e denigrues. Po ashtu, ka pasur raste në të cilat është konstatuar ushtrim dhune fizike, mosdhënie e kopjeve të proces-verbaleve të bllokimit të sendeve, apo të dokumentacionit të shoqërimit, si dhe mosdhënie e sendeve të bllokuara.

Konstatohen ende probleme me instalimin apo vënien në funksion të sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë në pjesën më të madhe të komisariateve, si dhe në zyrat e marrjes në pyetje të shtetasve në të gjitha komisaritet në vend. Në një pjesë të komisariateve plotësimi i regjistrave të evidentimit të personave të shoqëruar nuk kryhet me përgjegjësi dhe saktësi. Përgjithësisht është garantuar aksesimi në mjek, avokat dhe në psikolog,

Gjatë monitorimeve *të respektimit të të drejtave në pikat kufitare* është vërejtur se nevojitet përmirësim i mbrojtjes së migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar përmes njohjes më të mirë të të drejtave prej tyre. Avokati i Popullit vëren se kërkohet rritje e përgjegjësisë së oficerëve të kufirit për respektimin e parimit të moskthimit dhe rritjen e cilësisë së intervistave të përzgjedhjes.

Ka ende shumë faktorë që ndikojnë në cilësinë e intervistave dhe që lidhen që me burimet njerëzore të kufirit, mungesën e oficerëve gra për rastet e migrantëve femra, numrin e kufizuar të përkthyesve në gjuhën arabe, mungesën e shërbimit social nga bashkitë respektive etj.

Po ashtu nevojitet përmirësimi i skemës së trajtimit mjekësor në rastet e shfaqura në kufi, përmes ngritjes së një shërbimi ambulator mjekësor në pikat kryesore të kalimit kufitar, jo vetëm për migrantët e huaj apo për emigrantët e paligjshëm shqiptarë që kthehen nga policitë e vendeve fqinjë, si edhe për trajtimin e rasteve mjekësore që shfaqen në kufi dhe që kanë nevojë për këtë trajtim të shpejtë.

*Në veprimtarinë e organit të ndjekjes penale*, në kuadër të cënimit të të drejtave në procesin penal, janë konstatuar zvarritje të pajustificuara të hetimit për rastet kriminale të filluara mbi bazën e ngjarjes, për vepra me rrezikshmëri shoqërore të madhe, të cilat në pjesën më të madhe ndiqen nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit.

Evidentohet moszbatim i dispozitave procedurale, të konstatuar si mosveprim i organit procedues dhe zvarritje deri në mosdhënie të akteve të procedimit penal; mos-shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave apo memove me shkrim, që palët kanë paraqitur në procesin penal, sidomos gjatë fazës së hetimit paraprak; mosnjoftim ose vonesa në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë sidomos kallëzuesit të veprës penale kryesisht në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal.

Mungesa e transparencës në komunikim dhe mangësitë në sjelljen etike e profesionale të prokurorit me kallëzuesin, dhe palët në procesin penal, si dhe fillimi i hetimit në ngarkim të personave të caktuar që ushtrojnë funksione publike janë pasuar me rekomandimet përkatëse nga ana jonë, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokurorive të Rretheve Gjyqësore përkatëse.

*E drejta për një proces të rregullt ligjor*, e kuptuar në elementin e saj të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga ana e gjykatave është trajtuar në ankesat për zvarritje të gjykimeve. Rastet më shqetësuese vërehen në zvarritjet e gjykimeve nga Gjykatat e Apelit, Gjykata Administrative të Apelit dhe nga Gjykata e Lartë.

Kryesisht është rekomanduar shpejtim gjykimi të rasteve të zvarritjeve nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, të cilat vijnë në kundërshtim me kërkesat e nenit 48/2 të Ligjit me Nr.49/2012”Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Mungesa e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të mbarimit të mandatit dhe moszëvendësimit të gjyqtarëve ekzistues me gjyqtarë të tjerë, ka sjellë zvarritje të gjata gjykimi për shkak edhe të ngarkesës së madhe të punës që ekziston në këto Gjykata. Në këtë

drejtim, është i rëndësishëm krijimi sa më shpejt i organeve të reja në sistemin e Drejtësisë me qëllim që t'i jepet fund zvarritjes të gjykimeve dhe respektimi i parimit të ligjshmërisë në veprimtarinë e këtyre organeve, pasi ky problem ka lidhje direkte me mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, e në mënyrë të veçantë me të drejtën e një gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Avokati i Popullit mendon se duhet të ketë një nismë të tërë faktorëve, për të zgjidhur edhe ligjërisht problemet që lidhen me çështjet e dala nga zbatimi i reformës.

**Procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë** nga ana e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror, apo atij Privat, si dhe autoriteteve të tjera të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre rast pas rasti, në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm, rezulton se nuk është zhvilluar në përputhje me parimin e ligjshmërisë, si dhe ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Autoritetet e ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nuk kanë kryer, apo nuk kryejnë në afatin e përcaktuar ose në një afat të arsyeshëm, veprimet e parashikuara në ligj për ekzekutimin e tyre.

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë, apo Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në një afat të arsyeshëm, mbetet me rëndësi thelbësore për shtetin, pasi lidhet me krijimin, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të besueshëm dhe respektueshëm për të gjithë.

**Aksesi në gjykata dhe konkretizimi i ndihmës juridike falas** për kategoritë e individëve përfitues të saj, janë elementë të cilët kanë gjetur vështirësi në realizimin e tyre. Zbatimi i kuadrit të ri ligjor për ndihmën juridike, që merr përsipër të rregullojë problematikat e konstatuara deri më tani, do të sigurojë një qasje më reale ndaj të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

*E drejta e pronës*, për kategorinë e subjekteve, prona e të cilëve është shpronësuar pa shpërblim, shtetëzuar apo konfiskuar pas vitit 1944, ka pësuar ndryshime thelbësore me hyrjen në fuqi, të Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”. Regjimi juridik i parashikuar në këtë ligj, është vlerësuar nga ana e Avokatit të Popullit, siç është raportuar edhe më pare, jo në përputhje me Kushtetutën, vlerësim i cili është pranuar pjesërisht prej Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr.1, datë 16.01.2017.

Kompesimi i pasurive të njohura në pronësi, kryesisht me shpërblim në të holla, ka rënduar dhe rëndon interesin e taksapaguesit shqiptar, sidomos të asaj kategorie që nuk është subjekt i kësaj së drejte, me vijimin e pagimit të faturave financiare në vlera qindra milion euro, në emër të balancës së “Interesit publik” ndaj të drejtës së pronës.

Kjo mënyrë, prezanton një standard tjetër të përkeqësuar të trajtimit të së drejtës së pronësisë së subjektit pronar, jo konkurrues me standardin e trajtimit të kësaj të drejte për personat që e kanë përfituar të drejtën e pronës, sipas Ligjit nr.7501/1991 “Për tokën”, i ndryshuar, Ligjin nr.8053/1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, VKM nr.452/1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, etj.

Mosekzekutimi i vendimeve të dhëna në vite, me të drejtë kompesimi të pronës së njohur, si dhe mospërfundimi i shqyrtimit të 11 mijë kërkesave të administruara, gjithashtu në vite, nga ana e Agjensisë së Trajtimit të Pronës (ATP), vijon të jetë tregues i mosrespektimit të së drejtës të pronësisë, si dhe i cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky konkluzion lidhet ngushtë me faktin e mospërfundimit të procedurave respektive administrative, për çdo kërkesë të paraqitur, brenda afatit ligjor të përcaktuar për përfundimin e një procedure administrative, në Kodin e Procedurave Administrative, të Republikës së Shqipërisë.

Mosdërgimi i akteve, vendimeve të prodhuara në vite prej, Agjencisë së Trajtimit të Pronës dhe jo vetëm, pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ku ndodhet prona, sipas të cilave është vendosur për fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi të, në përputhje me nenin 196 të Kodit Civil, ka bërë që procesi i regjistrimit fillestar sistematik të pronave në ato zona kadastrale ku ndodhen ato, të mos ketë përfundur ende.

Kërkimi prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i pagimit të kamatëvonesës prej subjektit përfitues, për shkak të paraqitjes me vonesë për regjistrimin e titullit të pronësisë, tej afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e prodhimit apo marrjes formës të prerë të tij, vjen në kundërshtim me nenin 196, të Kodit Civil dhe përbën shkak për shkeljen e së drejtës së pronësisë si dhe cënon të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Kufizimi i kryer për pranimin e kërkesave për njohjen e pronës vetëm gjatë 90 ditëve të para, nga hyrja e në fuqi e Ligjit Nr.133/2015, *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, ka privuar dhe privon gjithë individët e tjerë të cilët kanë disponuar dhe disponojnë dokumente pronësie për prona të caktuara, por që nuk kanë mundur të respektojnë këtë afat për arsye të ndryshme objektive.

Në veprimtarinë e **Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), në bashki** konstatohet mungesë transparence; raste të përsëritura të situatës së cënimit të pronësisë pa respektuar procedurën e njoftimit zyrtar mbi vendimmarrjen konkrete ndaj subjektit përkatës; veprimtari e IKMT-së, fragmentare, jo analizuese dhe jo reaguese, në rastet kur i kërkohet të ndërmarrë veprime të caktuara, nga ana e institucioneve të tjera shtetërore gjë që çon në mungesën e zhvillimit të një procesi të rregullt dhe të ligjshëm administrativ, shpesh edhe me shkaktim dëmi në kushtet e parashikuara nga Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”*, i ndryshuar; shkelje ligjore që çenojnë të drejta dhe liri të ligjshme të individit, ndërkohë që vazhdon gjendja e mosreflektimit ndaj kësaj paligjshmërie, duke përkeqësuar situatën juridike të subjekteve që kanë në pronësi, ose posedim ndërtimesh me statuse të ndryshme ligjore.

Në veprimtarinë e **Organeve të Qeverisjes vendore**, nevojitet rritja e bashkëpunimit mes organeve të qeverisjes vendore dhe organeve të tjera shtetërore që ushtrojnë kompetencat e tyre në nivel vendor, për zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”*, të VKM-së nr. 994/2015 *“Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, si dhe VKM-së nr.337/2015 *“Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”*, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të procesit të ndarjes së tokës bujqësore, si dhe pajisjen e individëve me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP), dhe regjistrimin e fitimit të drejtës së pronësisë, në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP).

Për zgjidhjen e problematikave të strehimit gjatë vitit 2017 u është rekomanduar organeve shtetërore hartimi i një kuadri të plotë ligjor, i përafuar me standardet ndërkombëtare, që i përgjigjet realizimit efektiv të kërkesave të individëve dhe familjeve të tyre për strehim, duke garantuar kështu sigurimin e një vendstrehimi për çdo kategori individësh, familjeje në nevojë, apo në vështirësi ekonomike.

Ky legjislacion duhet të shoqërohet me rritjen e buxhetit në këtë fushë, si dhe me mbështetjen që duhet të japë qeverisja qendrore ndaj organeve të qeverisjes vendore me projekte sociale të strehimit. Delegimi i kompetencave nga qeverisja qendrore tek qeverisja vendore, nuk u shoqërua me buxhete financiare, gjë që ka vënë në vështirësi organet e qeverisjes vendore për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave në rritje të qytetarëve. Puna në këtë drejtim është reflektuar në projektligjin për strehimin social.

Niveli i lartë i papunësisë kryesisht në zonat e thella malore dhe ato rurale, vjen si pasojë e mungesës së projekteve dhe fondeve nga ana e bashkive, për vënien në efikasitet dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore që ato zotërojnë, si dhe si rrjedhojë e mungesës së investimeve në tërësi dhe sidomos në infrastrukturën rrugore.

Organet e qeverisjes vendore lipset të planifikojnë më shumë fonde në buxhetet e tyre vjetore për zgjidhjen e problematikave që shqetësojnë komunitetet në nevojë, kryerjen e investimeve, si dhe të marrin masa për rekrutimin dhe trajnimin e stafeve sa më profesionalë, për trajtimin e grupeve vunerabël.

Për realizimin efektiv të **së drejtës për kujdes shëndetësor**, nevojitet në mënyrë permanente furnizimi me medikamente të mjaftueshme të qendrave shëndetësore dhe spitaleve, kryesisht në QSUT, Tiranë, për shkak të fluksit të pacientëve nga e gjithë Shqipëria.

Mungesa e mjekëve specialist në spitalet rajonale në gjithë vendin mbetet problematikë e mbartur ndër vite dhe si rezultat mungesa e shërbimeve apo aparaturave ndikon që pacientët të gjejnë rrugë alternative kurimi, siç është fluksi i pacientëve drejt kryeqytetit dhe QSUT-së.

Problematike paraqitet edhe mungesa e pajisjeve mjeksore, apo amortizimi i pajisjeve ekzistuese në spitalet rajonale e cila sjell më tej mosfrimin me cilësi dhe standard të shërbimit mjekësor në këto zona.

Lidhur me **të drejtën për arsimim**, konstatohet se, përveç problemeve infrastrukturore rrjedhimisht dhe atyre hapësinore, sistemi ynë arsimor dhe shkolla ballafaqohet edhe me një sërë problemesh të tjera. Zbatimi i reformave, cilësia, vlerësimi, edukimi, dhuna, bulizmi, rënia e interesimit apo e motivit për të nxënë, si dhe mospunësimi i studentëve pasi mbarojnë studimet e larta, janë ndër problemet më madhore. Sigurisht për t'i zgjidhur të gjitha këto probleme duhet angazhim maksimal i profesionistëve, kohë, mjete monetare dhe mbi të gjitha vullnet.

Ajo që duhet të jetë shqetësuese për shoqërinë tonë e në veçanti për mësimdhënësit, prindërit dhe Ministrinë e Arsimit është fakti që shkolla është ende larg pritshmërive krahasuar me bashkësinë e vendeve të zhvilluara ku aspirojmë të integrohemi.

Ministria e Arsimit duhet të zhvillojë politika dhe të hartojë plane, zbatimi i të cilave do ta bëjë shkollën një ambient më të dashur, atraktiv dhe stimulues për nxënësit. Kjo do të kishte një impakt direkt në ngritjen e cilësisë, rritjen e interesimit dhe në rezultate më të kënaqshme në përmbushjen e objektivave konkrete.

Për **mjedisin dhe të drejtat e njeriut**, konstatohet se, problemi kryesor që ekziston në fushën e mbrojtjes së mjedisit është mungesa e ndëshkimit, apo edhe gjobat mjaft të ulëta, të nxjerra si dënime administrative për ata individë apo subjekte që ushtrojnë një veprimtari të dëmshme ndaj

mjedisit. Nga ana jonë konstatohet në vazhdimësi se, shkaku kryesor i burimit ndotës të ambientit është pikërisht mosveprimi i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj, ndaj subjekteve të ndryshme, që shkaktojnë ndotjen mjedisore.

Problematikat në fushën e mjedisit në Shqipëri sërish mbeten; ndotja e ajrit në qytetet e mëdha në vend, sidomos në Tiranë; Hedhja e mbeturinave në lumenj e liqene, si edhe derdhja e ujërave të zeza të papërpunuara; mungesa e standardeve botërore për mbledhjen e mbeturinave dhe riciklimin e tyre; shpyllëzimi dhe zhdukja e masiveve pyjore si pasojë e prerjes së pyjeve dhe zjarreve që dëmtojnë ato.

Masa e **ndihmës ekonomike** është shumë e ulët dhe gati e papërfillshme në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme që i duhen një familjeje, ose një individ të vetëm për të mbijetuar, e jo më pastaj për të folur për dinjitet dhe integritet në shoqëri. Është i pajustificueshëm për ekzistencën e kësaj gjendje, mospërcaktimi i një minimumi jetik dinjitoz, qoftë edhe brenda mundësive të burimeve të shtetit Shqiptar, i cili pa dyshim, do t'i jepte më shumë dinjitet çdo qytetari në nevojë.

Nga monitorimi i ofrimit të kësaj ndihme konstatohet, informim i pamjaftueshëm dhe jo në kohë i qytetarëve për kriteret, procedurat dhe plotësimin e dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike; mungesë e burimeve njerëzore për të verifikuar fizikisht banesat dhe kushtet e jetesës të përfituesve; mungesë e parashikimit të fondeve të organeve të qeverisjes vendore, të destinuara për përfituesit e ndihmës ekonomike në masën 3%; mungesë e shumë shërbimeve shoqërore, të cilat do të rrisnin cilësinë e jetës të qytetarëve përfitues të ndihmës ekonomike dhe familjeve të tyre; mosofrim pranë vendbanimit të tyre i kurseve të formimit profesional dhe përmirësimi i cilësisë së tyre; përjashtim nga ndihma ekonomike e personave me aftësi të kufizuara në pjesën që i takon atyre, kur familja është në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike; mosaplikim i programeve sociale, ku përfituesit e ndihmës ekonomike të përfshihen duke dhënë kontribut me punën e tyre dhe kjo të influencojë në rritjen e të ardhurave të familjeve të tyre.

Sistemi i ndihmës ekonomike mund të sigurojë të ardhurat e nevojshme për të varfërit, por ai nuk i ndihmon ata që të shpëtojnë nga varfëria. Shumë familje shqiptare jetojnë me pagesat e ndihmës ekonomike, duke mos patur asnjë të ardhur tjetër në familje. Për shumë prej tyre, ndihma ekonomike apo pagesat e paaftësisë janë i vetmi burim jetese dhe për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara fizike, psikologjike e shoqërore, ata nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike.

**Mbrojtja e konsumatorit** është një tjetër fushë ku nevojiten zgjidhje të shoqëruara me një paketë ndryshimesh ligjore, për mos privimin e familjeve të varfra, apo individëve vulnerabël nga e drejta për akses në furnizimin e nevojshëm me energji elektrike, për t'ju siguruar atyre minimumin e mundshëm brenda një sasive limit këh energji. Është e nevojshme të shmanget absolutisht, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për grupet vulnerabël, me qëllim që gjithkush të marrë shërbimet bazike, pavarësisht statusit social dhe ekonomik që mund të gëzojnë qytetarët e këtij vendi.

Për problematikat që shoqërojnë reformën në sektorin e ujit, konstatohet se sidomos zonat rurale nuk furnizohen me ujë të pijshëm, apo furnizohen pjesërisht, duke përbërë kështu një vështirësi të madhe të jetesës dhe shërbimeve bazë e të nevojshme për banorët. Për zgjidhjen e kësaj problematike ka nevojë për subvencionim ndaj grupeve në nevojë dhe familjeve në nevojë, duke përfshirë dhe aplikuar për këtë qëllim edhe kritere të tjera të nevojshme me qëllim reduktimin maksimal të këtij fenomeni.

Sa i takon **të drejtës për strehim**, konstatohet se, numri i personave të pastrehë rezulton të jetë dyfish më i lartë se, numri i personave të pastrehë që kanë përfituar strehim social. Personat e pastrehë mbeten të painformuar përse i takon përmbushjes nga ana e tyre të kriterëve ligjore për përfitimin e strehimit. Programi për banesa me kosto të ulët nuk është i përballueshëm për të varfërit dhe për këtë arsye, të varfërit nuk përfitojnë nga ky program. Edhe procedurat bankare të aplikueshme për këtë qëllim janë tepër të gjata dhe të kushtueshme.

Programi i banesave sociale me qira ka në fokus familjet me të ardhura të ulëta, por njerëzit që jetojnë pranë ose nën kufirin e varfërisë, nuk mund ta përballojnë këtë program. Programi më i vogël është ai i subvencioneve të strehimit, ndërkohë që këto shihen si zgjidhje e përkohshme e problemeve të strehimit. Programet e strehimit social duhet të zgjerohen më tej për të përmbushur kërkesat e grupeve në nevojë dhe duhet të riorientohen drejt shtresave në pozita të pafavorizuara, për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes nga më të varfërit.

Konstatohet ende mosveprim, apo zvarritje në dhënien e informacionit brenda afateve procedurale ligjore, nga ana e institucioneve apo organeve përkatëse shtetërore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.119/2014 **“Për të Drejtën e Informimit”**. Problematik është shfaqur respektimi i kësaj të drejte gjatë procedurave administrative, që zhvillohen nga organe të ndryshme të administratës publike.

Nga monitorimi i respektimit **të të drejtave të fëmijëve** në institucione publike të përkujdesit rezidencial për fëmijë, Shkolla Speciale, Institute për fëmijë me aftësi të kufizuara etj, janë evidentuar problematika shumë dimensionale dhe lidhen me veprimet ose mosveprimet e këtyre institucioneve qoftë në nivel vendor si edhe në nivel qëndror.

Mungesa e kapaciteteve dhe mundësitë e kufizuara financiare në institucionet e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe Njësisë Për Mbrojtjen e Fëmijëve (strukturat e menaxhimit të rastit pranë Bashkive) bëjnë që qeverisja vendore të mos i përgjigjet kërkesave për ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve.

Vërehen gjithashtu, probleme të moskoordinimit dhe institucionalizimit të bashkëpunimit mes qeverisjes vendore, OJF-ve dhe strukturave të tjera shtetërore. Konstatohet se njohuritë në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve në praktikën e përditshme janë ende të kufizuara me gjithë trajnimet që janë ofruar herë pas here nga organizata të ndryshme.

Lidhur me **të drejtat e personave me aftësi të kufizuara**, pavarësisht disa rekomandimeve të dërguara për respektimin e tyre, konstatohet se mbeten problematike, mungesa e përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuar; Mospërfitimi i kompensimit të biletave në transportin urban të personave me aftësi të kufizuar; Mosdhënia e të drejtës për të përfituar rimbursimin për shpenzimet në blerjen e karburantit dhe vajit lubrifikant për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë; Mungesa e aksesit në transportin urban publik dhe mosrimbursimin e biletës; Moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin; Mungesa e statistikave për personat me sëmundje të rënda mendore; Mosngritja e qendrave rehabilituese rezidenciale për personat me sëmundje të rënda mendore; Aksesit i personave me aftësi të kufizuar në drejtësi, në strukturat qeveritare në nivel qëndror dhe lokal, media dhe biznes; Mungesa e statistikave për personat me sëmundje të rënda mendore; Qendrat e votimit (kopshte, çerdhe dhe shkolla) nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar.



Sa i përket **barazisë gjinore dhe të drejtat e personave LGBT**, duhet të theksohet fillimisht se ndihma aktuale ekonomike është e pamjaftueshme për të adresuar nevojat e grave kryefamiljare, grave rome apo atyre nga grupe të tjera vulnerabel, si viktimat të dhunës në familje apo viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore.

Mungesa e shpalljes së minimumit jetik mbetet një pengesë shumë e madhe, në përcaktimin e politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë, përfshirë këtu edhe gratë. Mekanizmat e Koordinimit dhe Referimit të rasteve të **dhunës në familje** në bashkitë e vendit duhen forcuar dhe mbështetur. Në nivel vendor mungojnë shërbime të tilla si akomodimi, linja telefonike 24 orëshe, programe rehabilitimi, etj, duke vështirësuar përmbushjen e përgjegjësive nga anëtarët e Mekanizmave të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës.

Mungesa e klinikave ligjore vendore duke filluar në rang qarqesh e më pas edhe më tej dhe mungesa e ofrimit të shërbimeve prej tyre sjell efekte në aksesin e grave nga qarqe të ndryshme në sistemin e drejtësisë.

Megjithëse është një nga objektivat sociale të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, **strehimi** përbën një nga çështjet më të mprehta me të cilën përballen gratë, në mënyrë të veçantë gratë në nevojë.

Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit të njësive të pushtetit vendor mbi buxhetimin e prioritetëve gjinore. Bashkitë duhet të parashikojnë dhe aplikojnë për fonde, me qëllim mbështetjen për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje, strehëzave të posaçme, shërbimeve psiko-sociale dhe ligjore për viktimat, programeve rehabilituese për dhunuesit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

**Të drejtat e Komunitetit LGBTI**, konsiderohen si pjesë të pandashme e tërësisë së të drejtave të njeriut, dhe për këtë institucioni ynë është shprehur qartë se nuk duhet të ketë pengesa ligjore për personat e komunitetit LGBTI në realizimin e të drejtave, të cilat gëzohen nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Sot në Shqipëri problematika më themelore e komunitetit LGBTI është njohja e identitetit gjinor. Duke mos u parashikuar me ligj, identiteti i ndryshuar i tyre, mosnjohja e bashkëjetesës dhe e martesës shkakton mosvijueshmëri të jetës normale të tyre.

Pavarësisht rekomandimeve të nisura nga Avokati i Popullit për njohjen e këtyre të drejtave deri më sot, nuk ka pasur iniciativa konkrete të institucioneve shtetërore për njohjen e këtyre të drejtave.

Situata e **të moshuarve** në Shqipëri nuk është e mirë. Ata përbëjnë një ndër grupimet më të mëdha numerike të shtresave dhe grupeve në nevojë. Për të garantuar dhe forcuar të drejtat e të moshuarve, kemi kërkuar prej vitesh miratimin e projekt-ligjit “Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimin të nevojave për moshën e tretë”.

Ka një zhvillim pozitiv në drejtim **të të drejtave të minoriteteve** që lidhet me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Megjithatë disa nga çështjet që vazhdojnë të mbeten aktuale kanë të bëjnë me:

-Përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus disa përmirësime në nenin 1, të Ligjit Nr.10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.

-Fillimin dhe përfundimin e procesit, për ratifikimin e Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale, ose

Minoritare.

-Zhvillimin e një censusi të ri të popullsisë, mbi bazën e kriterëve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, ku minoritetet do të gjenin veten për t'u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre.

Ndarja e re territoriale administrative ka krijuar problematikë, përse i takon pranis reale të popullsisë së ndryshme nga ajo në mazhorancë, të vendosur në zona të caktuara të vendit.

Sipas kësaj ndarjeje, në raste specifike rezulton se kufiri i ri territorial administrativ ndan në dy pjesë të veçanta komunitete, që i përkasin të njëjtit minoritet, por që pas kësaj nuk i përkasin më së njëjtës njësi territoriale administrative. Kjo gjendje faktike tashmë, gjykojmë se do të krijojë probleme me zbatimin e dispozitave të ligjit ku sanksionohet gëzimi dhe realizimi i disa të drejtave të lidhura paraprakisht me plotësimin e termave “numri thelbësor dhe kërkesë e mjaftueshme”, si dhe “mbi 20 % e numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj bashkie”.

## **KREU 2**

### **Vlerësim i situatës të respektimit të të drejtave të njeriut sipas fushave/sectorëve**

#### **2.1. Të drejtat e personave të privuar nga liria**

Në inspektimet e kryera gjatë vitit 2017 janë konstatuar problematika të evidentuara ndër vite, me disa përmirësime, por edhe ato përmirësime ende mbeten të pa përmbushura në përputhje me standardet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT).

Përmbledhtazi, gjetjet mbi problematikën në sistemin e burgjeve për vitin 2017 pasqyrohen në vijim:

- Neglizhencë e pajustificuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (D.P.B.) dhe Ministrisë së Drejtësisë për të përmbushur detyrimet ligjore dhe për të vënë në zbatim rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit, në krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe në sigurimin e bazës materiale të nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave ligjore ndaj të paraburgosurve dhe të dënuarve që trajtohen në një numër të konsiderueshëm të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Veçanërisht kushtet materiale tejet degraduese në regjimet e brendshme të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P.) Zahari Krujë, Institucionin e Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve (I.V.SH.B.), I.E.V.P. Sarandë, I.E.V.P. Tepelenë, I.E.V.P. Burrel, e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve, të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi.

Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara, Avokati i Popullit ka rekomanduar mbylljen e menjëhershme të I.E.V.P. Zahari Krujë, I.V.SH.B., I.E.V.P. Sarandë, I.E.V.P. Burrel, I.E.V.P. Tepelenë dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.

- Moszbatim i ligjit nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, me qëllim trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilët gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” në bazë të nenit 46/2 të Kodit Penal, dhe persona ndaj të cilëve gjykatat kanë caktuar masën shtrënguese “shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik” në bazë të neneve 46, 232/e dhe 239 të Kodit të Procedurës Penale. Trajtimi i kësaj kategorie në kushte burgu në I.V.SH.B. Tiranë dhe në I.E.V.P. Zahari, Krujë, dhe në seksione të kujdesit të veçantë të krijuara në disa IEVP, vijon të mbetet i paligjshëm.
- Neglizhencë e pajustificuar nga ana e organeve gjyqësore në zbatimin e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 46, paragrafi i parafundit, të Kodit Penal, për të shqyrtuar kryesisht të gjitha vendimet e dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” pas kalimit të afatit një vjeçar nga dita e dhënies së vendimit, si dhe dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës. Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Ministrit të Drejtësisë dërgimin e një letër - porosie të gjitha gjykatave në shkallë vendi, përmes të cilave t’u risillet në vëmendje detyrimi ligjor i parashikuar në dispozitën e mësipërme.
- Ulje e mbipopullimit krahasuar me vitet e mëparshme nga një rishpërndarje më e përshtatshme e të dënuarve/paraburgosurve në I.E.V.P. Megjithatë, problematike paraqitet situata në IVSHB ku 35 të paraburgosur/dënuar (33 me probleme të shëndetit mendor, nga të cilët 2 gra, dhe 2 pacientë me patologji) flinin me dyshek përtokë, në shkelje flagrante të nenit 24 të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Mbipopullim u konstatua edhe në I.E.V.P.-të Lezhë, Krujë, Rrogozhinë, Tepelenë, Drenovë e Sarandë, të cilat funksiononin në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Si rrjedhojë e mbipopullimit, një pjesë e I.E.V.P.-ve kishte aplikuar shtimin e numrit të shtretërve, gjë që kishte pakësuar numrin e personave që flinin me shtroje përtokë, por që kishte sjellë si pasojë cenimin e standardeve të hapësirës dhe kubaturës minimale ligjore për person.
- Infrastruktura në pjesën më të madhe të I.E.V.P.-ve paraqet probleme të qënësishme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. Përrjashtim bëjnë I.E.V.P.- të e reja dhe ato të rikonstruara të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penitenciar shqiptar.
- Përdorim i vazhdueshëm i ambienteve të observimit dhe veçimit si ambiente banimi për efekt mbipopullimi apo të mospërshtatjes. Flagrant është përdorimi i këtyre ambienteve si ambiente banimi në I.E.P.V. Krujë për persona me probleme të rënda shëndetësore. Ndërkohë që në I.E.V.P. Sarandë ishin kthyer në ambiente banimi edhe zyra e avokatit dhe magazina, në I.E.V.P. Peqin, Drenovë e Rrogozhinë të paraburgosurit e të dënuarit gjendeshin në pamundësi të realizimit të ajrosjes dhe aktiviteteve sipas parametrave ligjore.

Avokati i Popullit në rolin e vet si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimin të egër, çnjerëzor ose poshtërues i kushton vëmendje të veçantë personave të dënuar/paraburgosur, të mbajtur për çfarëdo arsye (për qëllime disiplinore si rezultat i sjelljes së tyre “të rrezikshme” ose “shqetësuese”, për interes të hetimit penal apo për arsye sigurie apo

me kërkesën e tyre), në kushte të ngjashme me izolim të zgjatur.

Parimi i përpjesëtueshmërisë kërkon të ruhet një ekuilibër ndërmjet kërkesave të çështjes dhe zbatimit të regjimit tip – veçim të tejzgjatur, që mund të ketë pasoja shumë të dëmshme për personat në fjalë. Në çdo rast, të gjitha format e veçimit duhet të jenë sa më të shkurtra që të jetë e mundur, por asnjëherë më shumë se 20 ditë. Në rastin kur një regjim i tillë imponohet ose zbatohet me kërkesë nga vetë i dënuari për arsye mospërshtatje, ndonëse kjo gjë nuk parashikohet në ligj dhe as në praktikat ndërkombëtare, një garanci thelbësore është prezenca e vazhdueshme e mjekut në ambientet e veçimit, me synimin që të kryejë vëzhgim dhe ekzaminimin mjekësor të të burgosurve në mënyrë të vazhdueshme.

Rezultatet e këtyre ekzaminimeve, përfshirë këtu një përshkrim të gjendjes fizike dhe mendore si dhe pasojat e parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet t'u paraqiten rregullisht me anë të një deklarate me shkrim nga ana e mjekut, autoriteteve kompetente për çështjet e regjimit dhe sigurisë në I.E.V.P. Në asnjërën prej I.E.V.P.-ve të përmendura nuk u gjetën të zbatuara këto garanci.

- Mungesa në ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese në një pjesë të I.E.V.P.-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit, apo ushtrimit të riteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi, apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë, në thuajse të gjitha I.E.V.P.-të, u konstatuan probleme sa i përket mundësisë për të zhvilluar aktiviteteve në grup apo individuale për mungesë të ambienteve të përshtatshme, bazës materiale apo dhe organikës së paplotësuar në sektorët psiko-socialë.
- Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim dhe për kurse të formimit profesional. Në I.E.V.P. Kukës, Tropojë, Lezhë, Lushnjë, Tepelenë, Sarandë dhe Rrogozhinë, nuk ofrohej arsimi i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Në asnjë prej institucioneve penitenciare, madje as në Institutin e të Miturve në Kavajë nuk ofrohej arsimi i mesëm.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, përveç IIEVP Burrel, bëheshin vetëm me ulje dënimi 3.9 ditë në muaj për të dënuarit, ndërsa për të paraburgosurit ky fakt regjistrohej në kartelë dhe në rastet kur dënoheshin me vendim gjyqësor të formës së prerë, bëhej llogaritja për uljen e dënimit. Po në këtë kuadër duhet theksuar se, ndonëse kanë kaluar mbi 19 vjet nga miratimi i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, nuk është miratuar ende VKM-ja përkatëse për përcaktimin e kriterëve për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe të paraburgosurve, për punën që ata kryejnë në këto institucione, pavarësisht rekomandimeve që institucioni i Avokatit të Popullit i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë. Me ta nuk janë lidhur kontratat e punës dhe nuk sigurohen sipas legjislacionit në fuqi, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk janë të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I.E.V.P.-të e reja si Vlorë, Berat, Fier, Durrës, dhe Elbasan, janë përgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo ndërhyrje mjekësore, e

të pa pajisura me materiale ndihmëse.

- Vonesat dhe mangësitë në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me libreza shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I.E.V.P.-ve, sjellin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit dhe probleme në furnizimin me medikamente. Furnizimet me medikamente kryhen kryesisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përgjigje të kërkesave për furnizime nga vetë I.E.V.P.-të.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike, si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej I.E.V.P.-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në I.E.V.P., që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike, apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Mosfunksionim i sistemeve qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha I.E.V.P.-të, ku ishin të instaluar si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarve/paraburgosurve nuk u sigurohej ngrohja sipas parashikimeve ligjore.
- Mungesa në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e I.E.V.P.-ve.
- Mungesa në dollapë e rafte të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndesh kryesisht në I.E.V.P. Lezhë, Tepelenë, Korçë, Sarandë, Kukës e Tropojë.
- Probleme për sa i përket plotësimit të nevojave për blerje të artikujve të ndryshëm nga ana e të paraburgosurve dhe të dënuarve. Në kushtet kur në pjesën më të madhe të IEVP-ve ishte hequr shërbimi i njësisë tregtare në institucion, dhe kur me urdhër të D.P.B.-së nuk funksionojnë më arkat e institucioneve, Urdhrat e D.P.B. nr. 4629/1 Prot., datë 11.07.2012 “Mbi pajisjen me karta debiti të të dënuarve në I.E.V.P.”, dhe nr. 2399 Prot., datë 01.04.2013 “Mbi përdorimin e arkës së të dënuarve dhe kartat e debitit për të dënuarit”, nuk kishin gjetur zbatim.
- Probleme me cilësinë dhe mungesën e larmisë së ushqimit në thuajse të gjitha I.E.V.P.-të.
- Vështirësi në përfitimin e lejeve shpërblyese dhe të veçanta, të lidhura kryesisht me përgjigjet negative apo evazive të ardhura nga komisaritet. Problematik në këtë drejtim Avokati i popullit konsideron edhe shkresën dërguar gjithë IEVP-ve nga Drejtori i Përgjithshëm i D.P.B.-së datë 18.10.2017 me lëndë “Tërheqje vëmendje mbi problematikat e konstatuara në lidhje me praktikën e lejeve shpërblyese në IEVP”, në pikën II të së cilës “Pritja nga familja dhe lëshimi i deklaratës”, përcaktohet se “Në çdo rast, në momentin e daljes me leje të veçantë dhe shpërblyese, i dënuari duhet të pritët të paktën nga njëri nga pjesëtarët e familjes, i cili duhet të paraqesë dokumentin e tij të identifikimit. Familjari nënshkruan një deklaratë, sipas formatit

bashkëlidhur”. Avokati i Popullit konsideron përmbajtjen e pikës së II të kësaj shkrese të pabazuar në ligj dhe pengesë për përfitimin e një të drejte të garantuar nga ligji veçanërisht për personat të cilët nuk kanë mbështetje familjare.

### ***Shqyrtimi i rasteve individuale***

Niveli i respektimit të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale është vlerësuar nga Avokati i Popullit edhe përmes shqyrtimit të ankesave individuale. Gjatë vitit 2017, janë paraqitur gjithsej 213 *ankesa individuale* që lidhen me të drejtat e të paraburgosurve/dënuarve dhe të stafit të punësuar në to, nga të cilat 193 janë përfunduar dhe 20 janë ende në shqyrtim.

Nga rastet e përfunduara: 68 janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit, 4 kanë përfunduar me rekomandim drejtuar D.P.B. dhe I EVP-ve përkatëse, 5 kanë rezultuar jashtë kompetence dhe 116 të pabazuara në ligj.

Ankesat e marra në shqyrtim janë paraqitur gjatë inspektimeve, si dhe nëpërmjet dërgimit me postë, apo njoftimit përmes telefonit në numrin e institucionit. Në rastet kur ankesa ka rezultuar jashtë kompetence, të interesuarit janë këshilluar për rrugën ligjore që duhet ndjekur. Në rastet kur ankesa është pranuar, ajo është regjistruar dhe ankuesi është njoftuar me një shkresë për veprimet gjatë procesit të ndjekjes dhe me numrin e kontaktit të punonjësit të cilit i është ngarkuar rasti për shqyrtim.

Numri më i madh i ankesave të mbërritura në institucion gjatë vitit 2017 ka pasur në objekt të tyre cilësinë e shërbimit shëndetësor, refuzimin e kërkesës për të përfituar leje shpërblyese, apo zvarritjen e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese, zvarritjen e procedurës për t’u transferuar në një I EVP tjetër, apo transferimin e padrejtë në një I EVP tjetër.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë inspektimeve dhe gjatë ndjekjes së ankesave në vend, gjejkojmë se mbipopullimi ende i lartë dhe mungesat në staf mjekësor, kanë sjellë si rrjedhojë mos përgjigjen në kohë e në cilësi nga ana e administratës së burgjeve ndaj kërkesave për trajtim mjekësor.

Në disa I EVP është konstatuar mungesë e mjekut pavarësisht parashikimeve në organikë, pasi nuk aplikohen përfitimet që rrjedhin nga vështirësia e pozicionit të punës dhe për rrjedhojë, pamundësohet punësimi i mjekëve apo vijimësia e punës së tyre në institucionet penitenciare.

Sa i përket ankesave lidhur me përcaktimin e institucionit penitenciar për kryerjen e dënimit, duhet të theksohet se kriteri kryesor ligjor është afërsia me vendbanimin e familjes. Nga hetimi i rasteve ku është pretenduar se kishte zvarritje të procedurave për të dërguar të burgosurin në një I.E.V.P. pranë vendbanimit të familjes, ka rezultuar se shkak i vonës ka qenë mbipopullimi. Në rastet kur nga të burgosurit është pretenduar transferim i padrejtë, D.P.B. ka kthyer përgjigje se arsyeja e transferimit të të burgosurit në një I EVP larg vendbanimit të familjes ka qenë siguria e tij për shkak të konflikteve me të burgosur të tjerë. Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë e vështirë të provohet në se me të vërtetë arsyeja e transferimit ka qenë siguria e të burgosurit, apo ndëshkim i tij për shkak të sjelljes në institucion.

Refuzimi i kërkesës për leje shpërblyese ka qenë objekt i disa ankesave të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit. Për këto raste, institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të ndërhyjë për të dhënë ose jo leje, por mund të verifikojë procedurën e shqyrtimit të kërkesave. Nga hetimi mbi ankesat ka rezultuar se arsyeja e refuzimit të tyre ka qenë mungesa e besueshmërisë lidhur me qëndrimin e të dënuarit jashtë institucionit: institucioni nuk ka patur garanci në se jeta dhe shëndeti i të dënuarit (apo të tjerëve) nuk do të cenohet gjatë përfitimit të lejes. Për të vlerësuar këtë mundësi institucioni ka marrë informacion nga policia e shtetit dhe përgjigjet kanë qenë negative. Avokati i Popullit ka disa vlerësime mbi procedurën që ndiqen nga komisariatet, por ende nuk ka një konkluzion për këtë çështje..

Respektimi i të drejtave të të paraburgosurve/dënuarve lidhet ngushtësisht me marrëdhëniet që krijohet ndërmjet tyre dhe personelit të burgjeve. Për të siguruar një administrim të mirë të I.E.V.P.-ve duhet të tregohet kujdes në rekrutimin e personelit (kujtojmë që gjatë vitit 2017 pati ndryshim të të gjithë drejtorëve të burgjeve në vend): paga dhe shpërblimet duhet të tërheqin interesin e profesionistëve; kushtet e punës dhe kompesimet ekonomike duhet të jenë të përshtatshme me vështirësinë që paraqet puna në burgje.

Në përfundim të hetimit të ankesave të punonjësve të policisë së burgjeve mbi mos respektimin e disa të drejtave të parashikuara nga legjisllacioni, institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Kryeministrit ndërhyrjen në organet kompetente: për respektimin e të drejtave të punonjësve të policisë së burgjeve në rastet kur ata nuk kryejnë lejen vjetore; rritjen e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për pajisjen me uniformë të punonjësve; trajtimin e barabartë financiar të punonjësve të policisë së burgjeve me punonjësit e policisë së shtetit; si dhe rritjen e numrit të punonjësve të policisë së burgjeve. *Ky rekomandim është pranuar në parim, por nuk është zbatuar me arsyetimin se nuk ka fonde të mjaftueshme.*

Gjatë shqyrtimit të një tjetër ankese të ardhur nga disa punonjës të policisë së burgjeve, të cilët ishin transferuar me detyrë nga IEVP Tiranë në IEVP Fier, u konstatua se kostot e transportit nuk mbulohehin nga punëdhënësi. Sipas legjisllacionit në fuqi, punonjësve të Policisë së Burgjeve, të cilët janë të punësuar në IEVP-të që ndodhen larg qendrave të banimit, duhet t'u garantohet transporti falas vajtje-ardhje nga vendi i punës (IEVP). Por, kjo e drejtë ligjore nuk zbatohet pasi nuk është miratuar VKM që duhet të përcaktojë rregullat e hollësishme për këto raste. Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave rregullat për mbulimin e shpenzimeve të transportit për punonjësit e policisë së burgjeve. *Rekomandimi është pranuar në parim, por nuk është zbatuar ende.*

### **Zbatimi i rekomandimeve**

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) dhe IEVP-të respektive pasi janë njohur me raportet e monitorimeve dhe me rekomandimet e sugjeruara mbi gjetjet e mësipërme, kanë kthyer përgjigje në të cilat pranohen konstatimet dhe pohohet se do të merren masat përkatëse për përmirësimin e situatës. Nga përgjigjet e marra nga D.P.B. si dhe nga institucionet e varësisë jemi informuar se:

- ✓ *Lidhur me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve janë marrë masat për plotësimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për kategorinë e të miturve, për krijimin e kushteve materiale të jetesës në dhomat e observimit dhe veçimit sipas standardeve të përcaktuara në*

Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Drejtoria e Përgjithshme ka realizuar furnizimin e institucioneve me materialet e kazermimit dhe ka informuar se do vazhdojë furnizimin për të plotësuar dhomat ku janë dëmtuar këto materiale. Për sa u përket masave për rregullimin e kushteve materiale dhe eliminimin e lagështirës në ambientet e dusheve dhe tualeteve janë siguruar fondet për rikonstruksionin e godinave respektive që kanë probleme dhe rikonstruktimi pritet të realizohet sipas buxhetit të vitit 2018.

- ✓ *Lidhur me Sektorin e Shëndetësisë* janë marrë masa për përmbushjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për rregullimin e ambienteve të sektorëve të shëndetësisë gjithashtu janë marrë masa për furnizimin e këtyre sektorëve me materiale mjekësore, krevate vizitash, karrocë invalidësh dhe barela. Dhomat e infermierive janë kompletuar me medikamentet dhe materialet e urgjencës. Janë bërë përpjekjet e duhura për plotësimin e organikave me mjek me kohë të plotë në IEVP, pavarësisht vështirësive në procesin e rekrutimit. Gjithashtu, kanë gjetur zbatim dhe rekomandimet për kompletimin e dhomave të stomatologëve dhe furnizimit të tyre me materiale stomatologjike nga depoja farmaceutike e D.P.B.-së. Që me miratimin e ligjit për trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve (i ndryshuar në Prill 2014) dhe VKM 337, datë 06.04.2011, “Për përfshirjen e personave të dënuar dhe paraburgosur në kategorinë ekonomikisht joaktivë”, kjo kategori përfiton pa pagesë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor dhe është në proces zbatimi i kontratave tri palëshe midis DRSKSH, IEVP-ve dhe Depove Farmaceutike për ofrimin dhe rimbursimin e medikamenteve. Në IEVP-të që kanë momentalisht vështirësi në implementimin e kësaj skeme, furnizimi me medikamente bëhet nga ana e Depos farmaceutike të D.P.B., sipas kërkesës së tyre.
- ✓ *Lidhur me Sektorin e Sigurisë* janë marrë masat e duhura për zgjidhjen e problematikave që lidhen me mbipopullimin në IEVP dhe respektimin e kohëzgjatjes së qëndrimit në ambientet e veçimit/observimit. Po ashtu, referuar rekomandimit të Avokatit të Popullit për rregullimin e situatës së shpërblimit për punën e kryer të të burgosurve dhe të paraburgosurve, D.P.B. bën me dije se janë në proces amendimesh të akteve ligjore dhe nënligjore për sistemin e burgjeve.

Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve, pretendohet se varet në një masë të konsiderueshme nga përcaktimet buxhetore. Për këtë arsye, Avokati i Popullit shqyrtoi parashikimet e bëra në Projektbuxhetin e vitit 2018 për institucionet penitenciare duke konstatuar se një sërë problematikash emergjente nuk janë parashikuar në buxhetin aktual. Më konkretisht:

- ✓ Nuk është parashikuar buxhet për ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”.
- ✓ Parashikimet për rikonstruktim godinash të IEVP-ve përfshijnë vetëm IEVP Lezhë, Vaqarr, Peqin, Burrel dhe Spitali i Burgjeve, ndërkohë që nuk është parashikuar buxhet për ndërtimin/rikonstruktimin e godinave të paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit për I.E.V.P. Zahari Krujë, I.E.V.P. Sarandë, I.E.V.P. Tepelenë, I.E.V.P. Kukës për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar **mbylljen e menjëhershme** pasi infrastruktura dhe kushtet materiale tejet degraduese në regjimet e tyre të brendshme, e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve, të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjisllacionin kombëtar në fuqi.



- ✓ Është parashikuar buxhet për përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me energji elektrike dhe ujë në disa I EVP (pa specifikime), ndërkohë që infrastruktura veçanërisht në I.E.V.P. Krujë, Lushnje, Rrogozhinë, Sarandë, Lezhë, Tepelenë, Sarandë dhe “Mine Peza” paraqet probleme serioze të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, këto të fundit të kthyer në mjedise banimi si rrjedhojë e mbipopullimit. Duhet të theksohet që ka edhe mungesa në ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese në një pjesë të I.E.V.P.-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit, apo ushtrimit të riteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzojnë llojin e aktiviteteve që mund të zhvillohen në to.
- ✓ Nuk është parashikuar një fond i veçantë financiar për shpërblimin dhe sigurimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve që janë përfshirë në listat e punësimit pranë I EVP-ve. Me qëllim që të garantohet respektimi i të drejtës ligjore për punësimin dhe shpërblimin e tyre, e parashikuar në nenin 34 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, dhe në nenet 54/3 dhe 54/4/a të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 437, datë 20.05.2015, sugjerojmë që ky fond të bëhet pjesë e buxhetit në zërin Sistemi i Burgjeve.

Funksioni rehabilitues i burgjeve është bërë një sfidë më e vështirë me rritjen e popullsisë në burgje dhe buxhetin e pamjaftueshëm. Masa e sigurisë “arrest me burg” dhe dënimi me burg duhet të zgjidhen si alternativë e fundit në sigurimin dhe ndëshkimin e personave që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të vogël. Përmirësimin e situatës në sistemin e burgjeve do t’i shërbente miratimi nga ana e Kuvendit i projekt-ligjit “Për ndryshimin e ligjit ‘Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve’, si dhe të ligjit “Për Policinë e Burgjeve”, hartuar përgjatë vitit 2016 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2017, dhe përcjellë për miratim në Kuvend. Këto amendime synojnë të përmirësojnë situatën aktuale, për ta sjellë atë në përputhje me standardet e Bashkimit Europian, Rregullat Europiane të Burgjeve dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

## 2.2. Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e policisë

Gjatë inspektimeve të kryera nga Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në komisariatet në varësi të tyre, janë konstatuar:

- Mbipopullim i ambienteve të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe në Komisaratin e Policisë Vlorë. Mbipopullimi vinte kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra nga policia për vepra penale të përhapura vitet e fundit, por edhe për shkak të kapjes së personave të dënuar me vendim të formës së prerë, në mungesë, për të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve vononte pranimin e tyre në I EVP. Për shkak të mbipopullimit dhe të mungesës së krevateve personat e arrestuar apo ndaluar flinin me shtroje përtokë, si dhe cenohej standardi i hapësirës jetike për person.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardeve të parashikuara në Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në

polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306, datë 31.03.2016 (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur), kërkesë e përsëritur në rekomandimet e Avokatit të Popullit drejtuar autoriteteve përkatëse. Në pjesën më të madhe të komisariateve të policisë, përfshirë këtu edhe komisariatet e Policisë Tiranë, dhomat e shoqërimit nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi ato rezultonin të pakta në numër dhe nuk krijonin kushte të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.

- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe Manuali i “Regullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar, në Njësitë Policore”. Të vetmet ambiente sigurie që plotësojnë standardet mbeten ato të Drejtorive Vendore të Policisë Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Kukës, Korçë dhe Fier. Edhe në Komisariatet e Policisë në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë ambientet e sigurisë nuk plotësojnë kriteret ligjore. Në disa komisariate që duhej të rezultonin me dhoma të sigurisë të nxjerra jashtë funksionit, vijon të konstatohet se nuk ishin të mbyllura me dyllosje e procesverbal. Përgjithësisht, këto dhoma u gjetën të mbajtura me çelës ose dryn.
- Probleme me instalimin apo vënien në funksion të sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë në pjesën më të madhe të komisariateve, si dhe në zyrat e marrjes në pyetje të shtetasve në të gjitha komisariatet në vend, edhe pse ky rekomandim ka qenë në fokus të Avokatit të Popullit, duke marrë parasysh se sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një standard sipas akteve ndërkombëtare dhe një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme të punonjësve të policisë ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- Në një pjesë të komisariateve, plotësimi i regjistrave të evidentimit të personave të shoqëruar kryhej me përgjegjësi lidhur me pasqyrimin e të gjitha të dhënave në rubrikat përkatëse. Ndërsa në disa komisariate rubrikat e regjistrave nuk plotësoheshin me saktësi dhe përgjegjësi (p.sh. emrat e familjarëve të kontaktuar, numrat e telefonave, etj.).

Referuar njohjes, respektimit dhe aksesit të të drejtave:

- *Procedura ligjore. Koha e arrestimit/ndalimit në polici*

Sipas informacionit të mbledhur gjatë vizitave nga grupet e monitorimit, u konstatua që përgjithësisht personat e arrestuar/ndaluar ishin pajisur me letrën me të drejtat e tyre, me kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, si dhe me kopje të procesverbalit të kontrollit personal. Për të shoqëruarit në shumicën e komisariateve zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.

108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e kopjes së procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Ndërkohë u konstatuan edhe raste që personat e arrestuar/ndaluar apo të shoqëruar nuk ishin pajisur me këto dokumente, si p.sh., në Komisariatit e Policisë Lushnje. Nga krahasimi i dy regjistrave, atij të personave të shoqëruar dhe të arrestuarve/ndaluarve, rezultoi se në disa komisariate kishte raste që koha e arrestimit apo ndalimit të të shoqëruarve, ishte e ndryshme

nga koha e shoqërimit të tyre dhe ajo lëvizte deri në 6 orë pas shoqërimit.

Avokati i Popullit vlerëson se kjo praktikë nuk është ligjore dhe duhet ndryshuar. Nëse për një person të shoqëruar në organet e policisë do të vendoset arrestimi apo ndalimi i tij, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet të vihet çasti (ora) e kapjes së tij në fakt, kur ai është privuar realisht nga liria. Bazuar në nenet 144 dhe 250 të K. Pr. Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit, ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Po ashtu, në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) i arrestimit ose ndalimit, fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vlerësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

- *Informimi*

Gjatë vizitave të bëra u konstatua që përgjithësisht, si në ambientet e komisariateve (korridore, zyra të oficerëve të policisë gjyqësore), ashtu dhe brenda dhomave të shoqërimit/sigurisë ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar. Gjatë intervistave të bëra me shtetasit e shoqëruar, arrestuar/ndaluar ata pohuan që ishin njohur me shkaqet e shoqërimit apo arrestimit/ndalimit, si dhe me të drejtat e tyre nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të shoqërimit, arrestimit/ndalimit.

- *Aksesi për avokat*

Nga kontaktet dhe informacionet e mbledhura gjatë vizitave monitoruese u vërejt që disa prej të intervistuarve gëzonin aksesin për një avokat që në momentin e parë të privimit nga liria, duke bërë të mundur që avokati të ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë. Megjithatë nga intervistat e zhvilluara u konstatuan edhe raste që të arrestuarit/ ndaluarit nuk donin avokat.

- *Lajmërimi i familjarëve*

Nga informacionet e mbledhura gjatë vizitave, u konstatua që në përgjithësi personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar u ishte dhënë mundësia për të folur apo njoftuar një familjar apo të afërm për vendin në të cilën ndodheshin.

- *Trajtimi me ushqim*

Gjatë monitorimit në komisariate përgjithësisht trajtimi me ushqim për të arrestuarit/ndaluarit kryhej tre herë në ditë me shërbim catering sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuara në Urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Kishte edhe komisariate në të cilat ky shërbim kryhej nga I.E.V.P. që gjendeshin afër Komisarivateve të Policisë (p.sh. në Komisarivat e Policisë Tropojë, Kukës, Berat dhe Sarandë).

- *Aksesi për mjek*

Për personat e arrestuar/ndaluar përpara akomodimit në sistemin e dhomave të sigurisë bëhej intervistimi dhe verifikimi nga ana e mjekut për shenja dhune, keqtrajtimi apo

sëmundje të ndryshme konform Kreut II, pika 7 të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, të cituar më sipër.

Gjithashtu zbatohet edhe detyrimi ligjor për kryerjen e vizitave mjekësore (kundrejt dëshirës) nga mjeku/ndihmësmjeku i drejtorisë apo komisariatit të policisë brenda 12 orëve nga arrestimi/ndalimi. E drejta për të pasur akses për mjek (duke përfshirë edhe mjekë të zgjedhur nga vetë i arrestuari/ndaluari) shoqërohet në Manual edhe nga e drejta për të përfituar shërbim mjekësor falas gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e sigurisë (Kreu III, pika 1.9, 1.10).

Zbatimi i duhur i këtyre dispozitave përbën ndër të tjera edhe garanci ndaj keqtrajtimeve të mundshme nga policia. Në Komisaritet e Policisë të cilët i janë nënshtruar rikonstruksioneve dhe plotësojnë standardet sipas Manualit të sipërcituar, ka një dhomë të veçantë për mjekun, me krevat të fiksuar, ku mbahen regjistri i vizitave, kartelat ditore të personave të arrestuar/ndaluar ku detajohet data, ora dhe këqyrja objektive, si dhe ankesat klinike. Vlen të theksohet se në disa DVP mjeku mungon, por kjo plotësohet me mjekë të spitaleve rajonale ose me ndihmësmjek.

- *Aksesi për psikolog*

Në mbështetje të nenit 35 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit, kujdestarit ligjor ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon”*, shërbimi psikologjik në komisariate mundësohet nga psikologët e drejtorisë/ bashkisë/ shkollave në rastet e të miturve në konflikt me ligjin.

- *Aksesi për t’u gjykuar brenda afatit ligjor*

Seanca gjyqësore për vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit personal për personat e arrestuar/ndaluar nga gjykata kryhej brenda afatit ligjor prej 96 orëve nga çasti i arrestimit/ndalimit të tyre. Pjesa më e madhe e personave të arrestuar/ndaluar ishte në pritje të zhvillimit të seancës gjyqësore për vlerësimin e masës së sigurimit. Gjithashtu gjatë inspektimeve nuk u konstatua ndonjë rast i mbajtjes së personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e sigurisë në organet e policisë pas caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, apo të masave të tjera më të lehta nga gjykata.

### ***Shqyrtimi i ankesave individuale***

Niveli i respektimit të drejtave të personave ndaj organit të Policisë së Shtetit është vlerësuar nga Avokati i Popullit edhe përmes shqyrtimit të ankesave individuale. Gjatë vitit 2017, në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar 91 ankesa.

Nëpërmjet ankesave qytetarët kanë paraqitur pretendime për shkelje të të drejtave të tyre ligjore nga strukturat, ose punonjësit e Policisë së Shtetit. Objekti i ankesave ka qenë i larmishëm: për trajtim çnjerëzor dhe keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë; për trajtim jo human në mjediset ku mbahen,

ruhen dhe trajtohen të shoqëruarit ose të arrestuarit/ndaluarit; për shoqërime të paligjshme; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave dhe të kërkesave të bëra prej tyre; për vendosje të masave administrative të padrejta; për bllokime të paligjshme të sendeve personale; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për mos dhënie informacioni;; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj të parregullt në Shqipëri; për largime nga Policia e Shtetit, etj.

Nga shqyrtimi i ankesave të administruara ka rezultuar se disa prej tyre kanë qenë të bazuara dhe konkretisht për trajtim çnjerëzor, për ushtrim dhune fizike, për mos dhënie të kopjeve të procesverbaleve të bllokimit të sendeve apo të dokumentacionit të shoqërimit, si dhe për mos dhënien e sende të bllokuara.

Dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe të akteve nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatimin e tij parashikojnë detyrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit për të respektuar të drejtat ligjore të shtetasve të shoqëruar, arrestuar ose ndaluar dhe trajtimin e tyre human dhe me dinjitet. Gjithashtu këto akte normative parashikojnë detyrimin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore për të marrë dhe administruar kallëzimet e bëra nga shtetasit, për të mbajtur procesverbalin përkatës për kryerjen e kontrollit dhe për sekuestrimin ose bllokimin e sendeve të ndryshme, si dhe dhënien e kopjes së tyre personit, ndaj të cilit janë kryer këto veprime procedurale apo policore.

Nga hetimi administrativ i rasteve për të cilat nga institucioni i Avokatit të Popullit janë provuar shkelje të të drejtave ligjore të shtetasve është konstatuar se disa nga shkaqet e kryerjes së këtyre shkeljeve nga punonjësit e policisë janë mos njohja e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit, si dhe neglizhenca për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për përmbushjen e rregullt të detyrës dhe misionit ligjor. Gjithashtu, një shkak tjetër është edhe mungesa e kontrollit nga strukturat eprorë të organeve vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit.

Për rastet për të cilat janë konstatuar shkelje të të drejtave të qytetarëve, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente për marrjen e masave të nevojshme penale, administrative dhe organizative me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura të qytetarëve, ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen.

### ***Zbatimi i rekomandimeve***

Nga përgjigjet e ardhura nga Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit rezulton se të gjitha rekomandimet e bëra pas inspektimeve janë konsideruar të drejta dhe janë pranuar në parim. Sipas përgjigjeve:

- ✓ Mbyllja e ambienteve ekzistuese të sigurisë në disa komisariate është vlerësuar e drejtë, por ajo nuk mund të zbatohet gjatë vitit 2017, pasi kapaciteti ekzistues në ambientet e sigurisë në Drejtoritë Vendore të Policisë është i limituar dhe nuk mjafton për akomodimin edhe të personave të ndaluar/arrestuar nga komisariatet në varësi të tyre.
- ✓ Në projekt buxhetin për vitin 2018, është parashikuar përgatitja e “Studim - Projektimit” për rikonstruksionin e godinave të disa komisariateve, në të cilin përfshihen dhe ambientet për të shoqëruarit dhe të ndaluarit/arrestuarit. Ndërtimi dhe krijimi i ambienteve të reja të shoqërimit në disa komisariate ku ato mungojnë, instalimi i sistemit të monitorimit në zyrat që shërbejnë për marrjen në pyetje të shtetasve në komisariate, aktualisht është e pamundur pasi nuk

disponohen burime të mjaftueshme financiare në zërin “Investime”, por do të shikohet mundësia e këtij investimi në vitet në vazhdim. Kjo çështje është e ndërvarur nga çelja e fondeve përkatëse për realizimin e investimeve në fjalë.

- ✓ Janë marrë masa të menjëhershme në disa komisariate për kompletimin e dhomave të shoqërimit me orenditë e nevojshme dhe përmirësimin e kushteve të qëndrimit dhe të jetesës në dhomat e shoqërimit dhe sigurimit ekzistuese duke i riparuar e lyer ato, si dhe rregulluar tualetet përkatëse me qëllim sigurimin e higjienës së nevojshme.
- ✓ Nga Drejtoritë Vendore të Policisë janë marrë masat organizative të domosdoshme për eliminimin e mangësive të konstatuara në hedhjen dhe pasqyrimin e të dhënave për personat e shoqëruar në regjistrin përkatës.
- ✓ Strukturat qendrore të Departamentit të Sigurisë Publike dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale do të planifikojnë dhe realizojnë kontrole ndaj strukturave vendore të policisë.
- ✓ Për rastet që Avokati i Popullit ka konstatuar mangësi në përmbushjen e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar janë analizuar nga drejtuesit e organeve vendore të policisë dhe ndaj personave përgjegjës janë dhënë masa disiplinore.

Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve, varet në një masë të konsiderueshme nga përcaktimet buxhetore. Për këtë arsye, Avokati i Popullit shqyrtoi parashikimet e bëra në Projektbuxhetin e vitit 2018 për Drejtoritë Vendore të Policisë dhe komisaritet në varësi duke konstatuar se një sërë problematikash emergjente nuk gjejnë mundësi trajtimi në buxhetin aktual.

Më konkretisht, në buxhetin e Policisë së Shtetit për vitin 2018 është parashikuar vetëm ndërtimi i bllokut të sigurisë dhe rikonstruksioni i dhomave të shoqërimit në DVP Tiranë, si dhe rikonstruksioni i dhomave të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Tiranë dhe blloku i sigurisë dhe i shoqërimit në Komisariatin e Policisë Laç.

Për këtë arsye, në vijim të rekomandimeve të përsëritura, Avokati i Popullit, rekomandoi që në buxhetin e Policisë së Shtetit për vitin 2018 të parashikohet ndërtimi dhe rikonstruksioni i blloqeve të sigurisë dhe i dhomave të shoqërimit në të gjitha organet policore ku nuk ka ambiente të tilla sipas standardeve ligjore.

### **2.3. Parandalimi i dhunës dhe torturës**

Ushtrimi i dhunës fizike dhe psikologjike ndaj personave të privuar nga liria përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut, për të mos ju nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie, që në disa raste përbën edhe torturë ose veprime arbitrare, cenon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit duke lënë pasoja në shëndetin e tij dhe në raste të veçanta edhe mund të shkaktojë humbjen e jetës.

Gjithashtu, këto veprime cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, si

dhe dëmtojnë dhe trondisin besimin e publikut tek këto organe. Disa nga shkaqet e ushtrimit të dhunës nga punonjës të policisë kanë të bëjnë me:

- ✓ moszbatimin e procedurave standarde gjatë kryerjes së veprimeve;
- ✓ infrastrukturën jo të përshtatshme të ambienteve të privimit të lirisë;
- ✓ mbipopullimin;
- ✓ shërbimin shëndetësor jo cilësor (të privuarit nga liria vepronjë dhunshëm kur nuk i sigurohet shërbim shëndetësor dhe të parët që përballen me këtë situatë janë punonjësit e policisë);
- ✓ mungesën e njohurive ligjore, veçanërisht e atyre që lidhen me trajtimin e personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor;
- ✓ presionin e drejtuesve për zbulimin me çdo kusht të autorëve të veprave penale;
- ✓ trajtimin jo të përshtatshëm financiar dhe material të punonjësve të policisë;
- ✓ vrasjen dhe plagosjen e punonjësve të policisë.

Ankesat për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike nga punonjës të Policisë së Shtetit dhe të Burgjeve janë shqyrtuar me përparësi nga institucioni i Avokatit të Popullit duke u përpjekur për të vepruar shpejt dhe me sa më pak burokraci edhe jashtë orarit zyrtar apo në ditët e pushimit.

Duhet të theksohet se njoftimi sa më parë i rasteve të dhunës në burgje dhe komisariate policie dhe nisja e menjëhershme e hetimit të tyre është thelbësore për të zbardhur ngjarjen, pasi pretendimet për ushtrim dhune, veçanërisht të dhunës psikologjike, nuk janë të lehta për t'u provuar.

Dhuna kryhet në vende të mbyllura, të pa monitoruara me kamera dhe pa dëshmitarë. Edhe në rastet kur ka dëshmitarë, ata druhen të flasin apo të japin deklaratime, sepse mund të përkeqësojnë marrëdhëniet me stafin që i mbikqyr, të cilët mund t'ia bëjnë më të vështirë jetesën gjatë vuajtjes së dënimit. Gjithashtu, tek qytetarët ka pasiguri e mosbesim në ndjekjen e rasteve të dhunës nga organet e policisë.

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 29 ankesa për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike, nga të cilat 10 ankesa janë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit dhe 19 ankesa ndaj punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Në përfundim të hetimit të ankesave ndaj Policisë së Shtetit, vetëm në një rast nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit është arritur në përfundimin dhe është provuar se, personit të ndaluar i është shkelur e drejta themelore e garantuar nga nenet 25 dhe 28/5 të Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, *për t'iu mos u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar.*

I ndaluar, i cili vuante nga probleme të rënda shëndetësore, mbahej i prangosur pas krevatit të spitalit civil, me qëllim për arsye sigurie, për të mos lejuar ndonjë largim të mundshëm të tij. Referuar legjisllacionit në fuqi, procedura e prangosjes së personave të arrestuar apo ndaluar nga policia e shtetit në kushte spitalore, nuk është e bazuar në ndonjë akt normativ.

Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në disa vendime të saj, ka trajtuar problemin e përdorimit të prangave ndaj të arrestuarve të sëmurë duke u shprehur se, mbajtja e personave të prangosur në kushte spitalore nuk justifikon gjithmonë qëllimet e sigurisë ndaj tyre.

Ky veprim është quajtur si jo human dhe degradues, veçanërisht për persona me një gjendje të rëndë shëndetësore. Pas shqyrtimit të rastit, institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar

Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë marrjen e masave për njohjen e punonjësve të policisë me rregullat që duhet të zbatohen në të tilla raste.

Ndërsa Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë i'u rekomandua fillimi i hetimit për veprën penale të "Torturës" në ngarkim të punonjësit të policisë që kishte urdhëruar prangosjen e të ndaluarit. DVP Tiranë e ka pranuar rekomandimin dhe ka marrë masa për zbatimin e tij. Organi i prokurorisë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se mungonte një nga elementët e figurës së veprës penale.

Në një rast tjetër, ankesa për dhunë ndaj punonjësve të policisë është regjistruar pasi i arrestuari ishte dërguar në një IEVP me masë sigurimi "arrest me burg". Për nevoja të hetimit, iu kërkua IEVP-së përkatëse të dërgonte sa më parë pranë institucionit të Avokatit të Popullit proceverbalin e mbajtur nga komisioni i pritjes ku duhet të shënohet nëse janë konstatuar ose jo shenja dhune të i burgosuri i ardhur rishtaz.

Në këtë dokument, që u dërgua disa muaj pas kërkesës, ishte pasqyruar fakti se i burgosuri kishte shenja dhune, të cilat pretendonte se i ishin shkaktuar nga punonjës të Policisë së Shtetit gjatë qëndrimit në ambientet e komisariatit. Meqenëse IEVP-ja nuk kishte zbatuar detyrimin ligjor për të vënë në dijeni organin e prokurorisë për rastin në fjalë dhe nuk bashkëpunoi në kohë me institucionin e Avokatit të Popullit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve iu rekomandua përgjithësimi i këtij rasti në të gjitha IEVP-të dhe marrja e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Disa të burgosur që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, gjatë vuajtjes së dënimit, kryejnë veprime për t'u vetëdëmtuar, për të dëmtuar të tjerët, ose objekte të ambientit rrethues. Sjellja e stafit të burgut për disa nga këto ngjarje është hetuar nga institucioni i Avokatit të Popullit, dhe në përfundim të hetimeve është arritur në përfundimin se këto raste jo vetëm që nuk monitorohen nga stafi mjekësor, por situata lihet vetëm në vlerësimin e punonjësve të policisë, të cilët aplikojnë kufizimin me pranga në krevat të burgosurit, apo vendosjen e skafandrës në kokë (kjo e fundit verifikuar në një rast nga shënimet në regjistrin përkatës në I.E.V.P. Fier).

Megjithëse legjislacioni i burgjeve e lejon përdorimin e prangave për të kufizuar fizikisht të burgosurin, legjislacioni për personat me probleme të shëndetit mendor kërkon që të përdoren mjete të veçanta kufizimi të mirë përcaktuara. Nga hetimi në vend ka rezultuar se, burgjet nuk janë të pajisur me mjetet e parashikuara të kufizimit fizik, ndaj Avokati i Popullit i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve blerjen e mjeteve të veçanta të kufizimit fizik në sasi të mjaftueshme për të gjitha I.E.V.P.-të. Rekomandimi është pranuar por ende mbetet i pazbatuar.

Hetimi ka përfunduar edhe për 19 ankesat ndaj Policisë së Burgjeve. Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore për verifikimin e dy prej tyre, Avokati i Popullit është vënë në dijeni se, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të burgjeve kishte hetuar gjithashtu këto raste dhe materialet e administruara i ishin përcjellë për procedim organit të prokurorisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve kishte zbatuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për largimin nga detyra të disa punonjësve dhe nisjen e procedimit administrativ për disa të tjerë. Ndërsa pretendimet e ankesave të tjera nuk janë provuar. Megjithatë, në dy raste, hetimi ka nxjerr në pah



probleme, ndreqja e të cilave mund të parandalojë ushtrimin e dhunës në të ardhmen. Rekomandimet e lartpërmendura janë pranuar nga D.P.B. dhe në vazhdimësi do të ndiqet zbatimi i tyre.

#### **2.4. Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria**

Gjatë vitit 2017, në 90 raste qytetarët kanë paraqitur kërkesë/ankesa ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë, dhe e krahasuar me vitin 2016, ka një rënie të ankesave në masën 9 përqind. Në mënyrë të grupuar dhe sipas rëndësisë së cënimit të të drejtave në procesin penal, ankesat e qytetarëve paraqiten si më poshtë:

##### *Së pari: Për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale*

Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale kapin 20% të numrit të përgjithshëm të ankesave. Ka zvarritje të pajustificuara të hetimit për rastet kriminale të filluara mbi bazën e ngjarjes, për vepra me rrezikshmëri shoqërore të madhe, të cilat në pjesën më të madhe ndiqen nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit.

Sipas përgjigjeve të dhëna nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, arsyet e zvarritjes në hetimin e procedimeve penale kanë qënë: kompleksiteti i çështjes; mosdërgimi i akteve të ekspertimeve me natyra të ndryshme si, mjeko-ligjor, psikiatriko-ligjor, grafik të shkrimit apo nënshkrimit, biokimik të lëndëve të dyshuara si narkotike; në mosgjetjen e personave të dyshuar si autor i kryerjes së veprës penale në vëndbanimet e tyre; moskthimi i përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet e drejtësisë të shtetave të huaja; procedurat e ndërlikuara që kanë kompanitë celulare për vënien në dispozicion të të dhënave të kërkuara; komandimi i prokurorit të çështjes në një prokurori tjetër etj.

Por gjatë trajtimit të këtyre ankesave kemi arritur në përfundimin se ka edhe arsye subjektive të prokurorëve, të cilat kanë sjellë zvarritje të pajustificuara të hetimit të procedimeve penale, të cilat janë:

- a. Moskryerja në vazhdimësi e veprimeve hetimore nga Policia Gjyqësore, rrjedhojë dhe e moskontrollit nga prokurori i çështjes të detyrave të lëna në urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore.
- b. Mosinteresimi i prokurorëve për kryerjen e shpejtë të ekspertimeve të ndryshme, dhe marrjen e akteve respektive nga institucionet përkatëse si Instituti Mjeko Ligjor Tiranë, etj.
- c. Moskryerja e veprimeve hetimore të lëna nga gjykata, pas shfuqizimit të vendimeve të marra
- d. nga prokurori për mosfillimin e procedimit penal apo pushimit të çështjes.
- e. Mosndjekjen e problematikave nga prokurorët e çështjeve dhe mosorganizimi i mirë i punës nga drejtuesi i Prokurorisë për rastet e dërgimit të shkresave drejtuar Institutit të Mjekësisë Ligjore, Institutit të Policisë Shkencore dhe Prokurorisë së Përgjithshme për letërporositë drejtuar autoriteteve të drejtësisë të shteteve të huaja.

- f. Mosrespektimi i nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, për rregjistrimin e personit konkret që i atribuohet vepra penale, veprim ky justifikues për mosmarrjen vendimit të zgjatjes së afatit të hetimit dhe zvarritjen e hetimit në disa raste deri në 1 vit.
- g. Vonesa në hetim për rastet e procedimeve penale kryesisht të filluara mbi bazën e ngjarjes për vepra të tilla si: “vrasje”, “vjedhja e pasurisë me dhunë”, etj.

*Së dyti: Mosrespektimi i dispozitave procedurale që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin penal, të cilat zenë 40 përqind të ankesave, dhe paraqiten:*

- a. *Në mosdhënien e akteve të ndryshme të sekuestuara gjatë hetimit të procedimeve penale*

Qytetarët kanë ngritur shqetësimin se megjithë kërkesën e paraqitur, organi i Prokurorisë nuk ju ka vënë në dispozicion aktet e fashikullit të hetimit. Nga mosveprimi i organit procedues dhe zvarritjet për mosdhënie të akteve të procedimit penal në rastet e mësipërme kanë ardhur pasoja në zvarritjet e procedurave për ankimin në gjykatë ndaj vendimeve të mosfillimit të procedimit penal apo pushimit të çështjes penale.

- b. *Në mos shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave apo memove me shkrim, që palët kanë paraqitur në procesin penal, sidomos gjatë fazës së hetimit paraprak*

Ky veprim bie në kundërshtim me pikën 2 të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos u shprehur me vendim brënda pesëmbëdhjetë ditëve, dhe në mjaft raste pa njoftuar kërkuesin.

- c. *Në mosnjoftimin ose vonesat në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë sidomos kallëzuesit të veprës penale kryesisht në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal( rreth 25 përqind të ankesave)*

Ky vendim, palëve në disa raste, nuk i është njoftuar menjëherë ashtu si parashikohet në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale. Vonesa për njoftimet e palëve në procesin penal kanë ndodhur dhe për rastet kur organi i Prokurorisë ka marrë vendim për pushimin e çështjes.

Konstatohet se për rastet e pezullimit të hetimit, Prokuroria në pjesën më të madhe të rasteve nuk njofton apo nuk iu dërgon palëve vendimin përkatës, me arsyetimin se “*ky detyrim nuk parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale*”.

Avokati i Popullit ka insistuar në respektimin e të drejtës së qytetarit për t’u informuar me vendimet përfundimtare të marra nga Prokuroria, dhe veç kësaj në rekomandimin legjislativ drejtuar Ministrin të Drejtësisë, është kërkuar shtesë në dispozitën e Kodit të Procedurës Penale, për të drejtën e ankimit që duhet të kenë qytetarët në se duan të bëjnë ankim ndaj vendimit të pezullimit të hetimit, parashikuar nga neni 326 i Kodit të Procedurës Penale, por ende nuk është marrë në konsideratë nga ligjvënësi.

Veç detyrimit ligjor që ka organi procedues në zbatimin e dispozitave procedurale, në disa raste kur ato nuk janë zbatuar, është ndërhyrë pranë punonjësve të Prokurorisë (kancelari, punonjësve të arkivës, apo kryesekretarisë), për shpejtimin e procedurave në marrjen e akteve të kërkuara nga

qytetarët. Këto janë realizuar pasi kemi gjetur predispozicionin dhe bashkëpunimin me këto struktura si, në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Vlorë, Kurbin, Durrës.

*Së treti: Për akuzë të padrejtë*

*Së katërti: Ndryshim i kualifikimit të veprës penale*

*Së pesti: Nxjerrja me vonesë e urdhërit të ekzekutimit të vendimit penal që ka marrë formë të prerë.*

Vazhdojnë kërkesat e qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit: për ndihmë juridike; për detyrimin e organit të prokurorisë për verifikimin e kallëzimeve penale brenda afatit 30 ditor e pas kësaj për të marrë vendim për mënyrën e zgjidhjes së tij; për paraqitjen e kërkesave në gjykatë dhe jo kallëzime penale në Polici, në rastet kur ata paraqiten në cilësinë e të dëmtuarit akuzues sipas nenit 59 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale; për mënyrën e formulimit të “*kallëzimit penal*” drejtuar organit të Prokurorisë; për t’u ankuar në gjykatën e vëndit të vuajtjes së dënimit, në rast ankese për llogaritje gabim të kohës së vuajtjes së dënimit, etj.

Gjatë vitit 2017, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë 2 rekomandime të cilat paraqiten si më poshtë:

1. Rekomandimi i datës 28.02.2017, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm “*Marrjen e masave me qëllim hetimin e shpejtë të procedimeve penale, vënien në dispozicion të akteve palëve në procesin penal dhe njohjen e tyre me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale, apo përfundimit të çështjes penale*”, duke vënë theksin për transparancë në komunikimin dhe sjelljen etike e profesionale të prokurorit me kallëzuesin, dhe palët në procesin penal. Rekomandimi është vlerësuar nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Rekomandimi i datës 26.01.2017, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, “*Fillimi i hetimit në ngarkim të shtetases A.K., me detyrë drejtore në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollorë 3-6 vjeç Shkodër, person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal*”. Rekomandimi është vlerësuar dhe pranuar, duke filluar procedimin penal.

Ka patur një mirëkuptim dhe bashkëpunim institucional të mirë me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, e cila është vënë në dijeni dhe në të gjitha rastet ka marrë në shqyrtim rekomandimet, mandej me shkresë ka njoftuar jo vetëm Institucionin e Avokatit të Popullit, por dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor përkatës për të vlerësuar dhe ndjekur rekomandimin.

Konstatohet se disa Prokurori të Rretheve Gjyqësore si psh, Tirana, Lushnja, etj, nuk kane përmbushur detyrimin ligjor për dhënien e informacionit të kërkuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, duke tejkalluar afatet e përcaktuara nga ligji për këtë qëllim.

## **2.5. E drejta për një proces të rregullt ligjor në Gjykatë**

E drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuara në nenin 42 të Kushtetutës, paraqitet si një garanci për individët ndaj veprimeve të padrejta dhe të paligjshme të organeve të pushtetit shtetëror

nga njëra anë, dhe si një detyrim i këtyre organeve që me veprimtarinë e tyre të mos çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, duke siguruar gjithashtu respektimin dhe mbrojtjen e procedurave ligjore.

Duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj me vendimet me Nr.12/2012 dhe vendimin me Nr. 35/2013 në lidhje me mosgjykimin brenda një afati të arsyeshëm ka vendosur konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mos gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në shkelje flagrante të kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës së RSH, dhe të nenit 6 të KEDNJ. Nga ankesat e shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit në lidhje me shkeljet e konstatuara nga Gjykatat e të gjitha shkallëve janë përgatitur dhe dërguar rekomandimet përkatëse me qëllim zgjidhjen e problemit dhe rivendosjen e të drejtë së shkelur apo të cënuar nga Gjykatat.

Gjatë vitit 2017, janë trajtuar gjithsejt 147 raste, të ardhura të reja dhe 16 raste të tjera të mbartuar nga vitit 2016, ndaj Gjykatave të të gjitha shkallëve. Këto ankesa kanë patur si objekt kryesor zvarritjet e gjykimeve nga të gjitha gjykatat por më shqetësuese janë zvarritjet e gjykimeve nga Gjykatat e Apelit, Gjykata Administrative e Apelit dhe nga Gjykata e Lartë.

Në rastet e konstatuara nga ana jonë si zvarritje të pajustificuara rast pas rasti janë bërë rekomandime përkatëse dhe kërkesa të ndryshme duke kërkuar shpejtim gjykimi. Kryesisht nga ana jonë janë rekomanduar shpejtim gjykimi të rasteve të zvarritjeve nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, të cilat vijnë në kundërshtim me kërkesat e nenit 48/2 të ligjit me Nr.49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Në fakt nga kjo Gjykatë, zvarritja e gjykimeve shkon rregullisht deri në 2 vjet dhe kjo zvarritje justifikohet nga ngarkesa e madhe e punës, si dhe mungesa e gjyqtarëve të mjaftueshëm për të përballuar këtë ngarkesë, e për të gjykuar sa më shpejtë dosjet e paraqitura për shqyrtim.

Po kështu vazhdojnë të vijnë ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të Gjykatave duke ngritur pretendime për shkelje të ndryshme ligjore në dhënien e drejtësisë, si dhe duke kërkuar nga institucioni ynë ndërhyrjen për prishjen e tyre.

Duke analizuar ankesat e ardhura gjatë vitit 2017, ato ndahen si vijon: në 51 raste ato u përkasin Gjykatave të shkallëve të para; në 15 raste Gjykatave të Apelit; dhe në 6 raste ato kanë qënë ndaj Gjykatës së Lartë Tiranë. Për shkeljet e konstatuara gjatë këtij viti nga ana jonë janë dërguar 15 rekomandime të ndryshme, me të cilat është kërkuar shpejtim gjykimi dhe nga verifikimet e kryera rezulton se ato janë gjetur të drejta dhe janë pranuar nga Gjykatat.

Në lidhje me ankesat e ardhura në institucionin e Avokatit të Popullit, ndaj gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të shkallëve të para dhe të Gjykatave të Apelit, për shkelje të ndryshme ligjore dhe veprime korruptive, nga ana jonë në bazë të kërkesave të nenit 17/c të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i janë dërguar për kompetencë shqyrtimi Inspektoriatit të Lartë të KLD-së për verifikime më të hollësishme.

Po kështu, gjatë vitit 2017, ka pasur ankesa në lidhje: me zvarritjen e gjykimeve për shkak të mosparaqitjes së ekspertëve mjeko ligjor; mungesës së ngritjes së një institucioni të posaçëm mjeksor për personat që vuajnë nga sëmundjet psikike dhe mendore dhe nuk mbajnë përgjegjësi

penale në lidhje me veprat penale të kryera prej tyre; me mosshqyrtimin dhe mos kthimin e përgjigjeve për kërkesat për falje dënimi të të dënuarve me burgim; moskthimin e përgjigjeve në lidhje me mospagimin e dëmshpërblimit financiar sipas kërkesave të ligjit nr. 9831 datë 12.11.2007, nga Ministria e Drejtësisë, apo Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, etj.

Një problem i madh dhe shqetësim qytetar kohët e fundit, janë bërë mungesat e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, pasi gjyqtarëve ekzistues iu ka mbaruar afati i caktuar me ligj dhe ata nuk janë zëvendësuar akoma nga me gjyqtarë të tjerë. Rezulton se nga viti 2013 dhe në vijim nuk është plotësuar asnjë vakancë.

Gjithashtu, mbetet një shqetësim i madh numri i ulët i gjyqtarëve në gjykatat e apelit. Kjo gjë ka përkeqësuar dhe pritet të përkeqësojë më tej situatën në këtë drejtim, me zvarritjet e gjata të gjykimeve, të cilat kanë si shkak tjetër edhe ngarkesën e madhe të punës që ekziston në këto gjykata.

Gjykojmë se zbatimi i reformës në Drejtësi, si një reformë jetike për mirëfunktionimin e sistemit gjyqësor, nuk do të sjellë në këto kushte efektet e pritshme, nëse numri i gjyqtarëve në gjykatat e apelit do të mbetet i pandryshuar me atë që ekziston sot.

Pavarësisht problematikave të evidentuara, një zhvillim pozitiv mund të konsiderohet ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale me ligjin me Nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin me Nr.1905 datë 21.03.1995”, i ndryshuar. Këto ndryshime parashikojnë: të drejtat e viktimës të veprës penale si një detyrim për tu garantuar nga ana e organeve publike gjatë procesit penal<sup>1</sup>; organizimin e gjykatave në nivel Gjykate Rrethi Gjyqësor, si dhe Gjykatë e Rrethit Gjyqësor e shkallës së parë, kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, etj.

## **2.6. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative**

Procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv nga ana e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror apo atij Privat, si dhe autoriteteve të tjera të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre rast pas rasti, në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm, gjatë vitit 2017 rezulton se nuk është zhvilluar në përputhje me parimin e ligjshmërisë. Në procesin e shqyrtimit të një numri ankesash prej institucionit të Avokatit të Popullit, është konstatuar cënimi i së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosëkzekutimit të titujve ekzekutiv në një afat të arsyeshëm, sikundër sanksionohet në nenin 42/2, të Kushtetutës, apo në nenin 6/1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Edhe pse procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv mbart problematika të njëjta sikundër nga vite të mëparshme, autoritetet e ngarkuara me ligj për ekzekutimin e tyre nuk kanë kryer, apo nuk kryejnë në afatin e përcaktuar ose në një afat të arsyeshëm, veprimet e parashikuara në ligj për ekzekutimin e tyre. Vlen të përmendet, se fryma e aplikimit të ligjit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv ndaj subjektit privat është më “agresive” dhe efçente ndaj subjekti debitor privat krahasuar me atë shtetëror. Kjo situatë vërehet si në veprimtarinë e Shërbimit të

<sup>1</sup> Në nenin 58 të KPrP, parashikohet se viktimas e veprës penale ose pëfaqësuesi i tij ka të drejtë të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit, të zgjedh mbrojtës dhe kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas nga shteti sipas legjislacionit në fuqi, të kërkojë dëmshpërblimin e demit si dhe ti pranohet padia civile në procesin penal

Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror ashtu dhe Privat.

Ka disa shkaqe që lidhen me këtë gjendje dhe ato kanë të bëjnë me:

- ✓ Problematikën që mbartin dispozitat e Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.
- ✓ Mungesa e cilësisë profesionale të përmbartuesve gjyqësorë, e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.
- ✓ Mosnjohja e legjislacionit civil dhe atij procedural, nga ana e përmbartuesve gjyqësorë.
- ✓ Kryerja e veprimeve përmbartimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keqinterpretimi i dispozitivit të vendimit gjyqësor.
- ✓ Mungesa e vullnetit prej përmbartuesve gjyqësorë, për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që është vendosur me vendim të gjykatës.

Gjykohet e nevojshme që të amandohet nenit 529, i Kodit të Procedurës Civile, për zgjerimin e rrethit të sendeve mbi të cilët nuk mund të vendoset masa e sekuestros, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor. Gjithashtu nevojitet nxjerrja nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, e udhëzimit për përcaktimin e metodologjisë në caktimin e vlerës së sendit të sekuestruar, prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, konform parashikimit të nenit 7 dhe nenit 11, të Ligjit 114/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8116, Datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore administrative, Ligji Nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, parashikon se, vendosja e sanksioneve ndaj subjektit pengues, me rastin e mospërbushjes së detyrimit në afatin ligjor sikurse pasqyruar në dispozitivin e vendimit gjyqësor, vendosen nga Gjykata dhe jo nga përmbartuesi gjyqësor i çështjes.

Ky i fundit, relatton çështjen para Gjykatës Administrative, e cila në zbatim të parashikimit të Nenit 68 të Ligjit Nr. 49/2012, vendos sanksionin e gjobitjes në masën 20 për qind të pagës minimale, në shkallë vendi, për çdo ditë vonesë në ekzekutim dhe në rastet e konstatimit të moszekutimit të vendimeve, pa shkaqe të përligjura, kërkon marrjen e masave disiplinore dhe, kur është rasti, paraqet edhe kallëzim penal ndaj personave përgjegjës.

Kjo situatë e parashikuar në dispozitën ligjore, Neni 68 i Ligjit Nr. 49/2012, vlerësojmë se, do të rris efektivitetin e veprimeve përmbartimore në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv të ndyshëm nga ata të dhënë nga Gjykata Administrative, në rast se gjen pasqyrim në Nenin 606 të Kodit Civil.

Në ndryshim nga vitet e shkuara numri i ankesave të marra në shqyrtim, që kanë pasur si objekt mosdorëzimin e detyrimeve në të holla nga ana e organit shtetëror, sikurse është vendosur nga gjykata, ka qenë tepër i ulët.

Ankesa janë paraqitur në lidhje edhe me problemet në praktikën e përditshme, që ndeshen në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, duke kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjet e institucionit të Avokatit të Popullit për zgjidhje të problemit me anë të rekomandimit, për ndreqjen e gabimeve të bëra nga organet e ndryshme shtetërore.

Procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, si dhe autoriteteve të tjera të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre, në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm, ka qenë objekt shqyrtimi gjatë vitit 2017, nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në 5 prej çështjeve të paraqitura për shqyrtim mbi këtë çështje, ka pranuar kërkesën e subjekteve kërkuar duke u shprehur gjatë gjykimit të tyre për konstatimin e cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të titullit ekzekutiv në një afat të arsyeshëm, si dhe në dy raste në procesin e gjykimit të çështjeve civile.

Fakti që Gjykata Kushtetuese ka evidentuar në vendimmarrjet e veta, vit pas viti, cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, është tregues se nga ana e institucioneve përgjegjëse nuk merren masat përkatëse për shmangien e kësaj shtate të përsëritur.

Kjo situatë përveç se ndikon në humbjen e besimit të individit ndaj dhënies së drejtësisë, gjeneron dhe fatura financiare të cilat paguhen nga taksapaguesi dhe nuk i rikthehen atij në respektim të parashikimeve ligjore të Kodit Civil, apo akteve të tjera nënligjore si, Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012, i Ministrisë të Financave, “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, (neni 62); Udhëzimi nr.1, datë 13.06.1997, i Ministrisë të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7, sipas të cilit, përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryej auditimin e gjithë procesit, i cili ka passjell dëmin ekonomik, si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile, kundër personave që kanë shkaktuar dëmin. Mosrespektimi i akteve ligjore të lart-përmendura, ka sjellë dhe do të sjellë cënim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë.

Çështja e cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv në Shqipëri, është konstatuar dhe prej Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, në vendimet e saj të vitit 2017, për çështjet me numër 23136/13, 57065/14, 15373/15, 3604/16 dhe nr.49976/13.

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë, apo Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në një afat të arsyeshëm, mbetet me rëndësi thelbësore për shtetin, pasi lidhet me krijimin, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të besueshëm dhe respektueshëm për të gjithë.

Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve të gjykatave është një nga hallkat kryesore të shoqërisë demokratike. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, nga ana e organeve të administratës publike, në cilësinë e debitorit, mbetet një çështje që shkel parashikimet e bëra në Nenin 142/3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Nenin 451/a, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e organeve të administratës publike.

Në procesin e shqyrtimit të ankesave gjatë vitit 2017, me objekt mosekzekutimin e titujve ekzekutiv, Avokati i Popullit, gjykon se, shkaku i cili sjell cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor është dhe problematika që mbart Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, “*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*”. Për përmirësimin e kësaj shtate, Avokati i Popullit, rast pas rasti ka ndërhyrë dhe do të vijojë ndërhyrjen pranë organeve përkatëse për rregullimin e saj.

Edhe pse objektivi i Qeverisë ka qenë dhe është moslejimi i borxheve të reja, i shprehur ky edhe në VKM nr.50, datë 05.02.2014, *“Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”*, rezulton se ky objektivi nuk është arritur.

Organet apo institucionet debitoare, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është vendosur nga gjykata, nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr.2, Datë 06.02.2012, të Ministrit të Financave *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, (Neni 62), apo në Udhëzimin nr.1, datë 13.06.1997, të Ministrit të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, Paragrafi 7.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, titullarët e tyre, si organe përgjegjëse për ekzekutimin e detyrimeve në të holla të rrjedhura nga vendimet gjyqësore civile të formës së prerë, nga konstatimet e institucionit tonë, në asnjë rast nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë analizimin e vendimeve gjyqësore civile, si dhe kërkimin për nxjerrjen e përgjegjësive administrative.

Situata në të cilën ndodhet prej vitesh procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv, me objekt; *“Detyrim të organit, institucionit shtetëror për pagim të hollash”*, shtron nevojën e marrjes së masave të menjëhershme prej institucionit qendror, si në aspektin administrativ ashtu dhe civil, sipas shkallës së përgjegjësisë së individit përgjegjës.

Respektimi i procedurës sikurse përcaktuar në aktet nënligjore të lartpërmendura, do të mundësojë jo vetëm rikthimin në buxhetin e shtetit të vlerave në të holla të paguara në zbatim të vendimit gjyqësor civil, por do të minimizojë detyrimet në të hollat të institucioneve shtetërore.

Shkaqe të tjera të cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, vazhdojnë të jenë edhe:

1. Mungesa e cilësisë profesionale të përmbauesve gjyqësorë, e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.
2. Mosnjohja e legjislacionit nga ana e përmbauesve gjyqësorë.
3. Kryerja e veprimeve përmbaimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keqinterpretimi i dispozitivit të vendimit gjyqësor.
4. Mungesa e vullnetit prej përmbauesve gjyqësorë, për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet, ose kryejnë të kundërtën e asaj që është vendosur me vendim të gjykatës.

Në raportet e viteve të shkuara Avokati i Popullit ka sjellë në vëmendje çështjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, të dënimit me gjobë të subjektit, që vijon të mbetet e pandryshuar, edhe pse i është rekomanduar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.K2/I40-9 prot, datë 22.02.2016, *“Marrja e nismës për ndryshim legjislacioni”*. Megjithëse rekomandimi është pranuar në parim nga ana e Ministrit të Drejtësisë, nuk është bërë i mundur ende përmirësimi i kuadrit ligjor, që lidhet me procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, mbi



bazën e të cilëve është vendosur dënimi me gjobë i personit.

Tjetër çështje, e cila nuk është trajtuar dhe zgjidhur në afat prej Ministrisë së Drejtësisë, është mosnxjerrja e udhëzimit për përcaktimin e metodologjisë në caktimin e vlerës së sendit të sekuestruar, prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, konform parashikimit të nenit 7 dhe nenit 11, të ligjit 114/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8116, Datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Mosnxjerrja e aktit nënligjor nuk lejon kryerjen e veprimeve përmbartimore në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në fazën për të cilën përmbartuesi gjyqësor do të duhet të respektojë parashikimin e dhënë në nenet e sipërcituara, të ligjit 114/2016.

## **2.7. Ndhma Juridike**

Çështjet që lidhen me ofrimin e ndihmës juridike falas nga shteti, të shtetasve në nevojë dhe që nuk kanë mundësi ekonomike dhe financiare për të zgjedhur vet një avokat mbrojtës privat, kur ato kanë probleme me organet gjyqësore, kanë qenë të rregulluara me ligjin nr.10039, datë 22.12.2008, “Për Ndhmën Juridike”. Bazuar në dispozitat e këtij ligji, është krijuar dhe ka funksionuar Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, i cili rast pas rasti ka shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me kriteret e dhënies së kësaj ndihme ligjore falas nga shteti.

Në kuadër të bashkëpunimit institucional me Komisionin Shtetëror të Ndhmës Juridike falas nga shteti, institucioni i Avokatit të Popullit rastet e paraqitura pranë tij në lidhje me pamundësinë ekonomike dhe financiare të ankuesve për të zgjedhur vet një avokat privat me qëllim përfaqësimin në Gjykatë, i ka dërguar pranë këtij Komisioni për trajtim të mëtejshëm.

Më konkretisht, gjatë vitit 2017, në institucionin e Avokatit të Popullit, kanë ardhur gjithsej 28 *kërkesa* nga shtetas të ndryshëm të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike falas nga shteti, dhe nga ana jonë i janë dërguar për kompetencë shqyrtimi Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike në Ministrinë e Drejtësisë. Nga ky Komision, këto kërkesa janë shqyrtuar rast pas rasti dhe janë njoftuar ankuesit mbi nevojën e plotësimit të disa dokumentave shtesë, siç janë plotësimi i formularit përkatës, dërgimi i fotokopjes së kartës së identitetit, etj.

Për shkak të problemeve në zbatimin e këtij ligji, disa mangësive në legjislacion për sa i përket shmangies së pengimit të aksesit në gjykata (në drejtësi) të personave që janë në vështirësi ekonomike të cilët nuk përballojnë dot shpenzimet gjyqësore, si dhe me qëllim garantimin e një aksesit të shpejtë, të drejtë dhe të rregullt në drejtësi, gjatë vitit 2017 nisi procesi i hartimit të një ligji në përputhje me standardet evropiane në këtë fushë.

Gjatë këtij procesi, institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë mendime konkrete për përmirësimin e tij, të cilat kanë gjetur pasqyrim në dispozitat ligjore të ligjit Nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, të miratuar më datë 14.12.2017 nga Kuvendi i Shqipërisë. Institucioni i Avokatit të Popullit, do të vijojë me ndjekjen e zbatimit të këtij ligji, për të cilin duhet theksuar se nuk ka ende buxhetimin përkatës.

## 2.8. E drejta e pronës

Në lidhje me respektimin e të drejtës së pronës nga ana e organeve dhe institucioneve shtetërore gjatë veprimtarisë së tyre në vitin 2017, janë konstatuar problematika që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës së pronësisë, apo cënimin e të drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 41 dhe nenin 42/2, të Kushtetutës, nenin 1, të Protokollit nr.1, dhe nenin 6/1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Çështja e së drejtës të pronës për kategorinë e subjekteve, prona e të cilëve është shpronësuar pa shpërblim, shtetëzuar apo konfiskuar pas vitit 1944, ka pësuar ndryshime thelbësore me hyrjen në fuqi, të Ligjit Nr.133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*. Regjimi juridik i parashikuar në këtë ligj, lidhur me trajtimin e së drejtës të pronës është vlerësuar nga ana e Avokatit të Popullit, siç është raportuar edhe më pare, jo në përputhje me Kushtetutën, vlerësim i cili është pranuar pjesërisht prej Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr.1, datë 16.01.2017.

Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e pikës 3 dhe 5, të nenit 6 të ligjit të sipërcituar, dhe ka refuzuar kërkesën për shfuqizimin e nenit 6, pika 1, shkronja “b”, si dhe të nenit 7, pika 2, shkronja “a”, dhe “b”, për mungesë kuorumi. Moskrijimi i kuoromit të anëtarëve të trupit gjykues në këtë gjykatë, ka passjellë zbatimin e dispozitave të ligjit në fjalë. Ndërkohë jemi vënë në dijeni të faktit se shoqata “Pronësi me Drejtësi” ka rikërkuar shqyrtimin e kushtetueshmërisë së nenit 6, pika 1, shkronja “b”, si dhe të nenit 7, pika 2, shkronja “a”, dhe “b”, në Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit ka theksuar se çështja e kompensimit të pasurive të njohura në pronësi, kryesisht me shpërblim në të holla, ka rënduar dhe rëndon interesin e taksapaguesit shqiptar, sidomos të asaj kategorie që nuk është subjekt i kësaj së drejte, me vijimin e pagimit të faturave financiare në vlera qindra milion euro, në emër të balancës së “Interesit publik” ndaj të drejtës së pronës.

Bazuar në Udhëzimin e ish-Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, me nr.3, datë 18.07.2002, *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”*, Agjensia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, ka përcaktuar detyrimin e njësive të qeverisjes vendore, për inventarizimin e pasurive të paluajtshme të çfarëdo lloji, sipas zërit kadastral të tyre. Nga të dhënat e këtij inventari kemi konstatuar se, nuk janë pasqyruar në relacionin bashkëlidhur Ligjit Nr. 133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, në fazën e draftimit dhe shqyrtimit të tij si projektligj.

Zgjidhja e çështjes së njohjes të pronës me të drejtë kompesimi, duke u mbështetur kryesisht tek kompensimi në të holla sipas mënyrës së vlerësimit financiar të përcaktuar në këtë Ligj, prezanton një standard tjetër të përkeqësuar të trajtimit të së drejtës së pronësisë së subjektit pronar, jo konkurues me standardin e trajtimit të kësaj të drejte për personat që e kanë përfituar të drejtën e pronës, sipas Ligjit nr.7501/1991 *“Për tokën”*, i ndryshuar, Ligjin nr.8053/1995 *“Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”*, VKM nr.452/1992 *“Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”*, etj.

Gjykojmë se, evidentimi sa më parë i pasurive të paluajtshme me regjim juridik “Shtet”, sipas zërave kadastral, si dhe vënia në dispozicion të Agjensisë së Trajtimit të Pronës (ATP), si fond për kompesimin e pronës së njohur subjektit pronar, mund dhe duhet të jetë forma kryesore e kompesimit. Krijimi i fondit të kompesimit fizik nga fondi i tokës, bujqësore, jo bujqësore, pyjor, kullosor, si dhe vënia e tij sa më parë në dispozicion të ATP-së për kompesimin e subjektit pronar,

gjykojmë se, është qëndrimi më i drejtë dhe i plotësisht i mundur për trajtimin e kësaj çështjeje. Pas ezaurimit të kësaj mënyrë trajtimi, mund të kalohet më pas tek mënyra e kompesimit në të holla, për subjektin pronar.

Mosekzekutimi i vendimeve të dhëna në vite, me të drejtë kompesimi të pronës së njohur, si dhe mospërfundimi i shqyrtimit të 11 mijë kërkesave të administruara, gjithashtu në vite, nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronës (ATP), vijon të jetë tregues i mosrespektimit të së drejtës të pronësisë, si dhe i cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky konkluzion lidhet ngushtë me faktin e mospërfundimit të procedurave respektive administrative, për çdo kërkesë të paraqitur, brenda afatit ligjor të përcaktuar për përfundimin e një procedure administrative, në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Një tjetër çështje që mbetet aktuale është mosrespektimi prej ish Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve, ish-AKKP (sot ATP), i detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 196, të Kodit Civil, dhe nenin 38, të ligjit nr.33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar, për dërgimin për regjistrim pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të të gjithë vendimeve të dhëna në vite, sipas të cilëve është vendosur për njohjen e pronës me të drejtë kthimi në natyrë, apo kompesimit me një nga format e parashikuara në ligj. Kjo situatë konstatohet edhe në rastin e nxjerrjes së, akteve prej noterëve, përmbaruesve gjyqësorë dhe organeve të tjera shtetërore, apo të vendimeve prej gjykatave, që përmbajnë fitimin, njohjen, ndryshimin, apo pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi të.

Për ato raste kur, ATP-ja ka dhënë vendimin për njohjen e pronës me të drejtë kompesimi në një nga format e parashikuara në ligj është konstatuar se, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kanë mbajtur dhe mbajnë qëndrim refuzues për regjistrimin e tyre, qëndrim i cili ka qenë dhe është në kundërshtim me përcaktimin e dhënë në nenin 196, të Kodit Civil.

Për ndërprerjen e kësaj situate, e cila nuk vjen në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, Avokati i Popullit, me shkresën nr.K3/I51-2 prot, datë 18.10.2016, i ka rekomanduar shprehimisht Ministrin të Drejtësisë *“Zbatimin e detyrimit të dërgimit nga ana e gjykatave, noterëve, përmbaruesve gjyqësor dhe organeve të tjera shtetërore, sidomos prej Agjencisë së Trajtimit të Pronës, të kopjes së vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme e cila administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme”*.

Deri më sot, nuk ka reagim nga ana Ministrisë së Drejtësisë ndaj këtij rekomandimi. Mosdërgimi i akteve, vendimeve të prodhuara në vite prej, Agjencisë së Trajtimit të Pronës, dhe jo vetëm, pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ku ndodhet prona, sipas të cilave është vendosur për fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi të, ka bërë që procesi i regjistrimit fillestar sistematik të pronave në ato zona kadastrale ku ndodhen ato, të mos ketë përfundur ende sot e kësaj dite.

Edhe në ato raste kur është bërë i mundur regjistrimi fillestar sistematik i titujve të pronësisë, konstatohen probleme lidhur me vërtetësinë e hedhjes së tyre në hartat kadastrale, duke prodhuar në këtë mënyrë konflikte civile, të cilat do të mund të shmangeshin apo shmangen, në rast të ushtrimit korrekt të funksioneve nga ana e regjistruarëve të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, siç parashikohet në nenin 30 dhe 31, të ligjit nr.33/2012, *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, të ndryshuar.

Kërkimi prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i pagimit të kamatëvonesës prej subjektit përfitues, për shkak të paraqitjes me vonesë për regjistrimin e titullit të pronësisë, tej afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e prodhimit apo marrjes formës të prerë të tij, vjen në kundërshtim me nenin 196, të Kodit Civil.

Ky penalitet nuk duhet t'i kërkohet subjektit që e ka prodhuar titullin e pronësisë, sipas dispozitës ligjore në fjalë. Mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor prej gjithë subjekteve të përmendur në nenin 196, të Kodit Civil, si dhe mosreagimi i Ministrisë së Drejtësisë për këtë situatë, është e pajustificueshme, pasi përbën shkak për shkeljen e së drejtës së pronësisë si dhe cënon të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Mosushtrimi i autoritetit dhe kontrollit për zbatimin e legjislacionit në fuqi, nga ana e Kryeregjistruesit të Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, apo Ministrisë së Drejtësisë, ndaj këtyre veprimeve dhe qëndrimeve në kundërshtim me ligjin, prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, janë bërë me dije në çështje konkrete nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit.

Kufizimi i kryer për pranimin e kërkesave për njohjen e pronës vetëm gjatë 90 ditëve të para, nga hyrja e në fuqi e ligjit nr.133/2015, *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, ka privuar dhe privon gjithë individët e tjerë të cilët kanë disponuar dhe disponojnë dokumente pronësie për prona të caktuara, por që nuk kanë mundur të respektojnë këtëafat për arsye të ndryshme objektive. Amendimi i nenit 27, pika 1 dhe 2, të Ligjit, do të mundësojë rivendosjen në vend të ushtrimit të së drejtës për kërkimin e njohjes së pronës. Duhet të silllet në vëmendje fakti se edhe ekspertët e Këshillit të Europës dhe ata të Bankës Botërore, kanë ngulmuar në heqjen përfundimisht të një afati taksativ për pranimin e kërkesave për njohjen e pronës.

Vërehet se Agjencia e Trajtimit të Pronës në zbatim të ligjit nr.133/2015, vijon marrjen e vendimeve për kompesimin e pronave të njohura subjektit pronar me të drejtë kompesimi në të holla. Edhe pse deri më sot është mundësuar dhënia e një numri të konsiderueshëm vendimesh, ekzekutimi i tyre, pra dorëzimi i vlerës në të holla në favor të subjektit pronar, nuk ndodh, duke krijuar në këtë mënyrë një problem tjetër, krahas atyre të mbartur në vite prej Agjencisë së Trajtimit të Pronave.

Një tjetër çështje e pazgjidhur në afatin ligjor të përcaktuar është mospërfundimi i shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të akteve të marrjes së tokës në pronësi, prej komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë, pranë Prefektit të Qarkut.

Po kështu, mbetet problematike moszhvillimi i procedurave prej, njërive të qeverisjes vendore, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, ALUIZNI-t, Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kryeregjistruesit të ZQRPP, apo ATP-së, për zbatimin e VKM nr.608, datë 05.09.2012, *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”*, të ndryshuar. Kjo gjendje vjen edhe për shkak të mosmiratimit ende të aktit rregullator, për caktimin e tarifave të shërbimit në procesin e pajisjes me titull pronësie, të poseduesve të ndërtimeve të kryera para datës 10.08.1991, etj.

Çështje të tjera të cilat janë përmendur në vite dhe nuk kanë gjetur ende zgjidhje, janë;

- ✓ Mospërfundimi i procesit të regjistrimit fillestar sistematik të pronave, në ato zona kadastrale ku është vendosur për njohjen dhe kthimin/kompesimin e pasurive të paluajtshme.

- ✓ Tejzgjatja e procesit të shqyrtimit të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve, të cilët kanë kryer ndërtimin e objekteve informale, nga ana e ALUIZNI-t.
- ✓ Tejzgjatja e procesit të shqyrtimit të kërkesave për njohjen e pronës me të drejtë kompesimi fizik, etj.
- ✓ Tejzgjatja e procesit të shqyrtimit të titujve të pronësisë, të nxjerra në zbatim të Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për token”, etj.
- ✓ Mosbashkëpunimi dhe mosndërveprimi i institucioneve publike, në procesin e krijimit dhe regjistrimit të titujve të pronësisë.
- ✓ Mosrespektimi i afateve prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për dhënien e shërbimeve ndaj qytetarit, kryesisht në regjistrimin e titujve të pronësisë, lëshimin e dokumenteve të pronësisë, apo dhënien e informacionit të kërkuar.
- ✓ Mosushtrimi i kompetencave, prej regjistruarëve të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sikurse është parashikuar në nenin 30, të Ligjit Nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, për korrigjimin e hartës kadastrale.
- ✓ Marrja në posedim e pronës së shpronësuar prej organit shtetëror, pa u kryer më parë dorëzimi i vlerës së shpronësimit, ndaj subjektit të shpronësuar.
- ✓ Mosregjistrimi dhe “vënia në diskutim” prej zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i vendimeve gjyqësore të administruara.
- ✓ Moskrijimi i një harte të vetme unike, dixhitale, që mund të japë informacion mbi pronën.
- ✓ Mosgarantimi i ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të vendit, si dhe i vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, që lidhen me respektimin e së drejtës së pronësisë.

Procesi i pezullimit të shqyrtimit të kërkesave të subjekteve për njohjen e pronës me të drejtë kthimi apo kompesimi në natyrë të pronës prej disa vitesh, ka krijuar një situatë problematike, nga e cila nuk po gjëndet zgjidhje prej vitesh.

ATP administron jo më pak se 11.000 kërkesa të pashqyrtuara, të cilat janë të administruar prej vitit 1993 e deri më sot. Kjo situatë edhe pse është përmendur prej institucionit të Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur nuk po gjen zgjidhje. Kjo situatë çënon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, siç parashikohet në nenin 42/2 të Kushtetutës, apo në nenin 6/1 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Gjetja e rrugëve për daljen nga kjo situatë ka qenë dhe mbetet një kërkesë imediate për organet shtetërore, të cilat kanë në përgjegjësi dhe administrim veprimtarinë e ATP-së.

## **2.9. Veprimtaria e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), në Bashki.**

Dy organet kryesore që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre, ndër të tjera, edhe respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore të territorit, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, janë Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit (IMT), në bashki. Juridiksioni dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara në Ligjin nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

Natyra e veprimtarisë së këtyre dy organeve, në rastin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në bashki, shtrihet në nivel vendor, ndërsa në rastin e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në një nivel horizontal dhe vertikal ndërhyrjeje dhe kontrolli, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor. Të dy këto organe shfaqen me kompetenca vendimmarrëse/ekzekutive, që nga vendosja e gjobave, pezullimi i punimeve të ndërtimit, e deri tek prishja e ndërtimeve të kundërligjshme.

Gjatë vitit 2017, janë paraqitur 27 ankesa ndaj veprimtarisë së IKMT-së dhe IMT-ve, nga të cilat 15 prej tyre lidhen me veprimtarinë e IKMT-së dhe 12 të tjera, me veprimtarinë e IMT-ve, në bashki. Objekti i këtyre ankesave lidhet me shkeljen e procedurave ligjore gjatë procesit të prishjes së ndërtimeve nga ana e IKMT-së, si dhe mosveprim ndaj rasteve kur ka pretendim për ekzistencë të ndërtimeve të kundërligjshme. Në rastin e IMT-ve, në bashki, objekti i ankesave të paraqitura lidhet me, tejkalimin e kompetencës së vendimmarrjes për prishje objekti, ndërkohë që ky i fundit rezulton ende në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t; mosveprimin për fillimin e procedurës së konstatimit dhe sanksionimit të ndërtimeve të kundërligjshme; mosveprimin në ekzekutimin e vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme.

Nga një total prej 18 ankesash, për të cilat ka përfunduar procesi i shqyrtimit nga ana jonë, që lidhen me aktivitetin e IKMT-së apo IMT-ve në bashki, janë konstatuar disa problematika kryesore, si më poshtë vijon:

- ✓ Konstatohet mungesë transparence në veprimtarinë e këtyre organeve, e referuar shpesh nga ankuesit në ankesat e tyre, por edhe e evidentuar konkretisht gjatë veprimtarisë sonë institucionale.
- ✓ Konstatohen raste të përsëritura, kur ankuesit janë gjendur para situatës së cënimit të pronës së tyre, nga ndërhyrjet e IKMT-së, apo IMT-ve në bashki, pa u vënë në dijeni dhe pa patur paraprakisht një njoftim zyrtar, mbi vendimmarrjen për ndërhyrjen që do të kryhej. Kjo gjë ka cënuar të drejtën e ankuesve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.
- ✓ Megjithëse në disa ankesa është kërkuar informacion i ndërthurur, qoftë nga ana e IMT-ve në bashki, apo qoftë edhe nga ana e IKMT-së, konstatohet se mënyra e raportimit të IMT-ve pranë IKMT-së, për çështje konkrete mbetet problematike, pasi ka vonesa dhe shpesh mungesë informacioni në vartësinë vertikale të detyrimit ligjor në këtë rast.
- ✓ Veprimtaria e IKMT-së, shfaqet fragmentare, jo-analizuese dhe jo-reaguese, në rastet kur i kërkohet të ndërmarrë veprime të caktuara, nga ana e institucioneve të tjera shtetërore. Në këto raste, IKMT-ja, shërben dhe duhet të shërbejë edhe si një filtër i ligjshmërisë së vendimmarrjeve

paraprake të organeve të tjera, gjë që kërkon angazhimin e tij të drejtëpërdrejtë administrativ, përmes ezaurimit të procedurave përkatëse administrative, në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë në fushën e inspektimit të ndërtimit.

Çdo procedurë administrative që fillohet nga ana e IKMT- së, nuk duhet dhe nuk mund të trajtohet thjesht si zbatim i një vendimmarrje paraprake nga një organ tjetër, që vepron në një juridiksion të ngjashëm me atë të IKMT-së. Procedurat konkrete administrative, që duhet të zhvillohen rast pas rasti nga IKMT-ja, nevojitet të kenë si një element të domosdoshëm hetimin aktiv nga ana e vet këtij organi, të rrethanave, provave, veçantisë së problematikës së paraqitur, me qëllim që të parandalohen shkelje të ligjit.

Nëse mungon kjo mënyrë veprimi, atëherë kemi mungesën e zhvillimit të një procedimi të rregullt dhe të ligjshëm administrative, sikurse konstatohet edhe mungesë bashkëpunimi dhe harmonizimi të nevojshëm të veprimtarisë me organe të tjera që veprojnë në fushën e urbanistikës.

- ✓ Në procesin e prishjes së ndërtimeve informale, rezulton se lidhur me këto ndërtime, IKMT-ja, por edhe IMT-ja në bashki, kanë mangësi në procesin e verifikimit të procedurave ekzistuese të aplikimeve pranë organit të ALUIZNI-t, për legalizimin e objekteve, në të cilat ose është ndërhyrë me prishje, ose janë sanksionuar me vendime për prishje. Ky mosveprim bie ndesh me parashikimin e kryer në nenin 66/1, të Kodit të Procedurave Administrative, ndërkohë që konstatohet mungesë e bashkëpunimit dhe harmonizimit të nevojshëm të veprimtarisë së IKMT-së, me organe të tjera që veprojnë në fushën e urbanistikës dhe mbrojtjen e territorit.
- ✓ Dëmi financiar i shkaktuar nga ana e IKMT-së, apo të IMT-ve në bashki, gjatë prishjes së objekteve të ndërtuara me leje që, paraprakisht janë përfshirë në procesin e shpronësimit për interes publik, por që ende nuk kanë marrë vleftën e dëmshpërblimit që i takon, si dhe të objekteve informale të përfshira në procesin e legalizimit dhe për të cilat nuk ka patur ende vendimmarrje përfundimtare nga ana e ALUIZNI-t, përbën kosto shtesë që në mënyrë të kundërligjshme i shtohet detyrimeve që shteti duhet t'u paguaj në këto raste subjekteve të dëmtuara. Ky veprim e vendos veprimtarinë e këtyre organeve në kushtet e parashikuara nga ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar.
- ✓ Në këtë veprimtari, vërehen shkelje ligjore që çenojnë të drejta dhe liri të ligjshme të individit, ndërkohë që vazhdon gjendja e mosreflektimit ndaj kësaj paligjshmërie, duke përkeqësuar situatën juridike të subjekteve që kanë në pronësi, ose posedim ndërtime me statuse të ndryshme ligjore.
- ✓ Në kundërshtim me përcaktimet ligjore, të dhëna në pikën “c”, të nenit 21, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nuk ka patur reagim nga ana e organeve eprore të drejtorive rajonale të IKMT-së, apo të IMT-ve në bashki, lidhur me rekomandime tonat mbi marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve përkatës, të cilët kanë qënë në kushtet e refuzimit për bashkëpunim me Avokatin e Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave të caktuara nga ana e këtij të fundit.

Sikurse kemi informuar në dy raportet paraardhëse më të fundit vjetore, nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur një raport i veçantë, mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën Shtator

2014 - Maj 2015. Ky raport i është dërguar Kuvendit, në datën 22.12.2015. Raporti analizon veprimtarinë e IKMT-së, konkretisht për disa zona si ajo e Selitës, Tiranë (ku po zbatohet projekti i ndërtimit të unazës së re të qytetit); zona e Udenishtit, Pogradec, (ku po zbatohet projekti i rehabilitimit të segmentit rrugor Lin-Pogradec), si dhe zona e segmentit rrugor Rrogozhinë – Lushnjë.

Raporti i Veçantë, mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën shtator 2014 - maj 2015, nuk është diskutuar ende në Kuvend, megjithëse problematika e tij mbetet ende aktuale për faktin se, veprimtaria e IKMT-së, vazhdon të mbetet në të njëjtat çështje problematike.

Veprimtaria e IKMT-së është gjithashtu një nga elementët e analizës ligjore, të një raporti të veçantë që ka filluar të përgatitet nga ana e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017, lidhur me problematikat e vërejtura në veprimtarinë e disa organeve të administratës publike, gjatë zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Marteniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”



## 2.10. Organet e Qeverisjes vendore

Avokati i Popullit gjatë vitit 2017 i ka kushtuar rëndësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave të individëve gjatë veprimtarisë së organeve të qeverisjes vendore. Ky fokus është rritur pas zbatimit të reformës administrativo-territoriale në vitin 2015, pasi tashmë këto organe kanë një gamë të gjerë funksionesh, ushtrimi i të cilave ka një ndikim të madh në jetën e qytetarëve.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020, organet e qeverisjes vendore kanë të përcaktuara tashmë prioritete të reja në bashkëpunim të ngushtë me organet e qeverisjes qendrore, për thellimin më tej të procesit të decentralizimit në përputhje me parimin e autonomisë vendore. Mirëqeverisja, transparenca dhe llogaridhënia në menaxhimin e burimeve publike në interes të qytetarëve, rritja e cilësisë të shërbimeve publike që u ofrohet qytetarëve, rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, në kuadër të Rekomandimit 349 (2013) të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës për Qeverinë Shqiptare, janë kërkesa permanente dhe jetike për krijimin e një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të besueshme me qytetarët.

Gjatë vitit 2017, në institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur 365 ankesa ndaj veprimtarisë së organeve të qeverisjes vendore, nga ku 80 ankesa kanë si objekt të tyre pretendimin për shkelje të së drejtës së pronës, 77 ankesa kanë si objekt mosplotësimin e kërkesave të shtetasve për sigurimin e strehimit për familjet e tyre, 29 ankesa lidhen me pretendimin për shkelje të të drejtave të qytetarëve nga veprimet e kundraligjshme e të parregullta të IMT-ve në bashkitë përkatëse, ndërkohë që 15 ankesa lidhen me veprime të kundraligjshme të Policisë Bashkiake, 12 ankesa për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mjedisit, etj.

Numri më i madh i ankesave të paraqitura në vitin 2017, lidhet me mënyrën e trajtimit të çështjes së pronës. Nga hetimi administrativ dhe analiza e këtyre rasteve ka rezultuar se, është e nevojshme rritja e bashkëpunimit mes organeve të qeverisjes vendore dhe organeve të tjera shtetërore që ushtrojnë kompetencat e tyre në nivel vendor, për zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”*, të VKM-së nr. 994/2015 *“Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”*, si dhe VKM-së nr.337/2015 *“Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”*, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të procesit të ndarjes së tokës bujqësore, si dhe pajisjen e individëve me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP), dhe regjistrimin e fitimit të drejtës së pronësisë, në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme (ZVRPP).

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave ka konstatuar problematika të cilat kanë të bëjnë me:

- ✓ zvarritje të pajustificuara të kërkesave të individëve dhe mungesë kompetence në veprimtarinë e organeve të njëjsteve të qeverisjes vendore, lidhur me plotësimin e mangësive të akteve/dokumenteve të konstatuara nga ZVRPP, gjatë procesit të regjistrimit të AMTP-ve
- ✓ mosrespektimin e detyrimit ligjor që ngarkon këto organe për verifikimin faktik të tokës që zotërohet nga familjet bujqësore, në rastin e mbivendosjeve, apo zgjidhjen e konflikteve mes

familjeve bujqësore brenda kompetencave ligjore të organeve vendimarrëse, kryesisht për saktësimin dhe konfirmimin e planvendosjeve për sipërfaqet e çdo pasurie të dhënë me AMTP dhe dërgimin në mënyrë shkresore të akteve/dokumentacionit pranë ZVRPP

- ✓ mosadministrimin e saktë nga organi i qeverisjes vendore në një regjistër të veçantë, të të gjitha kërkesave të paraqitura nga përdoruesit faktikë të tokës bujqësore, të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP
- ✓ mungesa e bashkëpunimit mes njësisë të qeverisjes vendore, ZVRPP-ve, Drejtorive Rajonale të ALUIZNI-t, Agjencisë së Trajtimit të Pronave dhe Drejtoria e Administrimit të Tokave pranë Këshillave të Qarqeve, gjatë gjithë procesit të regjistrimit të AMTP-ve të familjeve bujqësore, etj.

Në lidhje me këto problematika, pas shqyrtimit të tyre i kemi rekomanduar organeve vendimarrëse dhe strukturave të administrimit të tokave pranë bashkive, marrjen e masave teknike dhe ligjore për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit të AMTP-ve, të familjeve bujqësore, sipas detyrimeve që përcakton ligji. Ndërkohë, për rastet që nuk kanë qënë në kompetencën e trajtimit nga ana e këtyre organeve, kemi orientuar individët dhe subjektet e interesuara t'i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të konstatuara.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, janë adresuar një numër i madh ankesash nga individë, familje dhe grupe në nevojë apo në vështirësi ekonomike, ndaj organeve të qeverisjes vendore, për **mostrajtimin dhe zgjidhjen e problemit të strehimit.**

Nisur nga problematikat e evidentuara nga ankesat e trajtuara ndër vite në këtë fushë është konstatuar se, kryesisht në zonat rurale por edhe në periferitë e qyteteve, ekziston një numër i konsiderueshëm familjesh, të cilat përballen me nevoja ekstreme për të siguruar strehim, pasi ndodhen në kushtet e pamundësisë totale të pagesës dhe përfitimit nga programet sociale të strehimit, që ofrohen aktualisht nga qeverisja vendore në bashkëpunim me qeverisjen qendrore. Ndërkohë, nga trajtimi i kësaj çështjeje ka rezultuar se, ky problem ka qënë dhe mbetet shqetësim kryesor edhe për vetë veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore.

Avokati Popullit, në kuadër të zgjidhjes të problematikave të strehimit iu ka rekomanduar organeve shtetërore hartimin e një kuadri të plotë ligjor, të përafruar me standardet ndërkombëtare, që i përgjigjet realizimit efektiv të kërkesave të individëve dhe familjeve të tyre për strehim, duke garantuar kështu sigurimin e një vendstrehimi për çdo kategori individësh, familjeje në nevojë, apo në vështirësi ekonomike.

Gjithashtu, vlerësohet se hartimi i legjislacionit duhet të shoqërohet me rritjen e buxhetit në këtë fushë, si dhe me mbështetjen që duhet të japë qeverisja qendrore ndaj organeve të qeverisjes vendore me projekte sociale të strehimit. Nëse i referohemi statistikave, me përjashtim të Bashkisë Tiranë dhe ndonjë prej bashkive të mëdha në vend, që kanë mundur të përfitojnë projekte nga programet sociale të strehimit, njësitë e tjera të qeverisjes vendore kanë mungesë kapacitetesh për të konkuruar në këto projekte dhe nuk kanë mundësi financiare për të ndërtuar banesa sociale, për kategoritë e familjeve në nevojë. Në këtë kuadër, është për tu vlerësuar fakti se gjatë vitit 2017

është hartuar drafti dhe aktualisht ndodhet për miratim, në Kuvendin e Shqipërisë, ligji i ri për strehimin social.

Nga shqyrtimi i ankesave ndaj veprimtarisë së **organit të Policisë Bashkiake**, janë konstatuar raste të shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Legjislacioni në fuqi parashikon se punonjësit e këtij organi kanë kompetenca të vendosin gjopa në vend, ndaj subjekteve fizike dhe juridike që kryejnë veprimtari të kundraligjshme brenda territorit që administrohet nga çdo bashki. Ndërkohë rezulton se punonjës të policisë bashkiake në kundërshtim dhe tejkalim të kompetencave të tyre ligjore, krahas dënimit administrativ me gjobë në vend ndaj kundërvajtësve, kanë ndërmarrë edhe masa të tjera administrative plotësuese, si ajo e bllokimit të mjeteve në pronësi të subjekteve kundërvajtëse, si një masë shtrenguese për të detyruar kundërvajtësin që të kryejë pagesën e gjobës. Ky veprim i punonjësve të organit të Policisë Bashkiake, në vlerësimin e Avokatit të Popullit është konsideruar i kundërligjshëm, ndaj është rekomanduar ndryshimi i kësaj praktike, që bie ndesh me kompetencat ligjore të punonjësve të Policisë Bashkiake, të përcaktuara në ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë”, të ndryshuar.

Reforma administrative-territoriale dhe krijimi i bashkive si njësi bazë të qeverisjes vendore, ka në themel të saj vizionin e rritjes së mirëqënies së individëve dhe familjeve të tyre, përmes procesit të **ofrimit të shërbimeve publike më afër qytetarëve dhe rritjes së cilësisë të tyre**, si dhe **kryerjes së investimeve në infrastrukturën rrugore**, me qëllim përmirësimin e cilësisë të jetës të qytetarëve.

Pavarësisht se kanë kaluar disa vjet nga krijimi i njësisive të reja të qeverisjes vendore, si dhe disa reformave të ndërmarra nga qeveria, qytetarët vazhdojnë të paraqesin ankesa për mungesën e shërbimeve bazike pranë qendrave ku ata banojnë. Ndërkohë, bashkitë nga ana e tyre justifikohen për mungesën e fondeve financiare, të cilat janë mjaft të reduktuara për ofrimin e këtyre shërbimeve. Kjo situatë, vjen si pasojë edhe e ndryshimeve strukturore që pësuuan njësitë e qeverisjes vendore, për arsye të delegimit të kompetencave të reja nga qeverisja qendrore, delegim ky që nuk u shoqëruan me buxhete financiare, gjë që ka vënë në vështirësi organet e qeverisjes vendore për t’iu përgjigjur në kohë kërkesave në rritje të qytetarëve.

Ankesa nga individë kryesisht kryefamiljarë, janë paraqitur lidhur edhe me **pamundësinë e sigurimit të një vendi pune**, nga njësitë e qeverisjes vendore. Nga analiza e këtij fenomeni rezulton se, niveli i lartë i papunësisë kryesisht në zonat e thella malore dhe ato rurale, vjen si pasojë e mungesës të projekteve dhe fondeve nga ana e bashkive, për vënien në efikasitet dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore që ato zotërojnë, si dhe të mungesës së investimeve në tërësi dhe sidomos në infrastrukturën rrugore. Gjithashtu, në këto ankesa janë ngritur shqetësime edhe për mosfunksionimin si duhet, të zyrave të punës pranë bashkive, të cilat janë larg plotësimit të kërkesave dhe nevojave të individëve për punë, si dhe plotësimit të nevojës së tregut për punëtorë të kualifikuar.

Strukturat e reja të bashkive, pas zbatimit të reformës administrative territoriale, pësuan një ridimensionim sa i takon **trajtimit të grupeve vulnerabël** si romëve, egjiptianëve, grave të dhunuara, fëmijëve, komunitetit LGBTI etj. Në veçanti vlen të përmendet krijimi i njësisive për mbrojtjen e fëmijëve, pranë çdo njësie të qeverisjes vendore. Pavarësisht kësaj, nuk kanë munguar ankesa nga individë dhe organizata të shoqërisë civile që punojnë me këto komunitete, objekti i të cilave ka të bëjë me mungesën e punësimit, problemin e shkollimit të fëmijëve, diskriminimin në marrjen e shërbimit shëndetësor, trajtimin e diferencuar për përfitimin e ndihmës ekonomike, probleme me mungesën e strehimit, regjistrimin në zyrat e gjendjes civile etj.

Në këtë aspekt, Avokati i Popullit veç shqyrtimit të ankesave individuale i ka kushtuar një rëndësi të veçantë trajtimit dhe zgjidhjes të problematikave që shqetësojnë këto komunitete, duke i rekomanduar organeve shtetërore në nivel qendror përmirësimin dhe përshtatjen e legjislacionit në fushat si arsimi, shëndetësia, gjendja civile dhe strehimi social, mbi bazën e problematikave që mbartin këto komunitete, si dhe plotësimin e standardeve ndërkombëtare të parashikuara në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Avokatit i Popullit ka patur një bashkëpunim të ngushtë me strukturat e shërbimit social pranë bashkive, si dhe me organizatat e shoqërisë civile, me të cilat janë organizuar inspektime të përbashkëta në qendrat e trajtimit të tyre, për zgjidhjen e mjaft rasteve në favor të këtyre individëve pjesë e grupeve vulnerabël. Shqetësuese për mirëfunksionimin e këtyre qendrave ngelet buxhetimi i vogël nga ana e bashkive, mungesa e investimeve dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve që kryejnë këto detyra. Avokati Popullit i ka rekomanduar organeve të qeverisjes vendore, planifikimin e më shumë fondeve në buxhetet e tyre vjetore për zgjidhjen e problematikave që shqetësojnë komunitetet në nevojë, kryerjen e investimeve, si edhe marrjen e masave për rekrutimin dhe trajnimin e stafeve sa më profesionale, për trajtimin e grupeve vulnerabël.

Në këtë këndvështrim sjellim në vëmendje, Rekomandimin 349 (2013), të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës. Për zbatimin e këtij rekomandimi është i nevojshëm plotësimi i legjislacionit për rritjen e autonomisë vendore, fuqizimi i kompetencave të organeve vendimarrëse, si dhe sigurimi i mjeteve të mjaftueshme financiare për realizimin efektiv të kompetencave të deleguara. Ndërkohë, theksojmë se ende nuk janë bërë përmirësimet e nevojshme ligjore për të qartësuar dhe shtuar kompetencat e qarkut; saktësimin e kompetencave me natyrë dualiste të Këshillit të Qarkut dhe Institucionit të Prefektit; përcaktimin e rregullave për pjesëmarrjen e shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore në procesin e konsultimit me Qeverisjen Qëndrore me qëllim ngritjen e një strukture të unifikuar administrative; mungesën e instrumentave financiare, fiskale dhe buxhetore të përshtatshme, sidomos për Bashkinë e Tiranës, etj.

## **2.11. E drejta për kujdes shëndetësor**

E drejta për kujdes shëndetësor është një nga të drejtat e njeriut të parashikuara nga kushtetuta si dhe pjesë e objektivave sociale të shtetit. Përmeshja e kësaj të drejte ka lidhje të drejtpërdrejtë me shëndetin, me jetën dhe cilësinë e jetës së çdo anëtari të shoqërisë. Duke qenë se bën pjesë në grupin e të drejtave pozitive, mënyra e zbatimi i saj varet shumë nga masat ligjore, administrative, organizative dhe financiare të shtetit. Shëndeti në vetvete është i lidhur dhe varet nga faktorë të ndryshëm socialë, ekonomikë, politikë ndaj edhe masat e ndërmarra nga shteti janë të

shumëllojshme dhe të shtrira në fusha të ndryshme të jetës. E përbashkëta e tyre është ndikimi te shëndeti i çdo individi në shoqëri.

Një sistem shëndetësor duhet të jetë i dizenuar për të adresuar nevojat e ndryshme të popullatës në mënyrë të drejtë, efikase dhe të përgjegjshme. Sistemet shëndetësore edhe pse ndryshojnë në masë të madhe në mënyrën se si janë të organizuara, të menaxhuara, dhe të financuara, duhet të sigurojnë barazinë në akses, në cilësinë e lartë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve të kujdesit shëndetësor për të gjithë popullsinë, bazuar kryesisht në nevojën dhe jo në aftësinë për të paguar.

Gjatë vitit 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 45 ankesa në fushën e shëndetësisë në përgjithësi. Nga këto 15 kanë qënë raste me inisiativë të trajtuara nga ana jonë. Objekti i ankesave kanë qënë trajtimi mjekësor jo konform standardeve, kërkesa për kurim jashtë vendit, ankesa për mungesa në medikamente, kryesisht në QSUT-në, mardhënie punësimi, etj. Nga numri i ankesave të marra në total për 40 ankesa ka përfunduar shqyrtimi, ndërsa 5 të tjera janë në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 30 ankesa janë zgjidhur në favor të qytetarit.

Në kuadër të veprimtarisë së tij, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar gjatë vitit raportues e në vazhdim problematikat e bëra prezent, si nëpërmjet ankesave të ndryshme të paraqitura në institucion, por edhe të rasteve të bëra publike në median e shkruar dhe online.

Në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe standardet e trajtimit të pacientëve të çdo spitali apo qëndre shëndetësore, duhet të ketë në mënyrë permanente medikamente të mjaftueshme kryesisht në QSUT, Tiranë, për shkak të fluksit të pacientëve nga e gjithë Shqipëria. Mungesa të mbartura vit pas viti ka siç dihet në spitalin onkologjik për shkak të specifikës dhe shtimit të numrit të pacientëve që trajton ky institucion spitalor në veçanti.

Mungesa e mjekëve specialist në spitalet rajonale në gjithë vendin mbetet problematikë e mbartur ndër vite dhe si rezultat mungesa e shërbimeve apo aparaturave ndikon që pacientët të gjejnë rrugë alternative kurimi, siç është fluksi i pacientëve drejt kryeqytetit dhe QSUT-së. Problematike paraqitet edhe mungesa e pajisjeve mjeksore, apo amortizimi i pajisjeve ekzistuese në spitalet rajonale e cila sjell më tej mosfrimin me cilësi dhe standard të shërbimit mjekësor në këto zona.

Referuar ankesave më specifike të shqyrtuara për të cilat janë hartuar edhe rekomanime për vitin 2017 do veçonim ankesën e *Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë*, e cila përcjell një shqetësim të infermierëve të QSUT-së. Konkretisht ata ankoheshin lidhur me tarifën e vendosur për parkimin prej 100 lekësh në ditë, pagesë që kërkohet të kryhet vetëm nga infermierët dhe jo nga mjekët, të cilët janë të pajisur me karta elektronike dhe janë të përjashtuar nga kjo pagesë<sup>1</sup>. Gjithashtu, rast tjetër ka qënë edhe problematika e shtetaseses D.XH e cila vuan nga një sëmundje e rrallë, e

---

<sup>1</sup> I është rekomanduar QSUT - së” Përfshirja sa më parë në listën e personelit mjekësor për përjashtimin nga tarifa ditore e parkimit në ambientet spitalore, kategorinë e infermierëve të QSUT - së, bazuar në nenit 2 të aktmarveshjes së 21 Janarit të vitit 2013 pika 1/c, ndërmjet shoqërisë “Steoalb” shpk dhe QSUT - Nënë Tereza”.

papërfshirë në protokolle mjekësore, me pasojë mostrajtim të denjë shëndetësor dhe social për këtë shtetase<sup>2</sup>.

Rast tjetër ka qënë ankesa nga një gup pacientësh që trajtohen me Hemodializë në QSUT, Nënë Tereza. Kjo kategori pacientësh ka shumë shqetësime me të cilat ata përballen në jetën e përditshme si pacientë. Konkretisht ata kërkojnë marrjen e disa medikamenteve që janë të domosdoshme për shëndetin e tyre<sup>3</sup>.

Një risi për vitin 2017 në fushën e shëndetësisë është edhe projekti USAID-it “Transparencë në Sistemin Shëndetësor në Shqipëri”, dhe qëllimi i tij për të përmirësuar shërbimet shëndetësore të shqiptarëve duke mbështetur Qeverinë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të luftuar korrupsionin, është mëse i domosdoshëm dhe shpresdhënës.

Gjithashtu, vlerë e shtuar e këtij projekti është inkurajimi dhe bashkëpunimi i institucioneve të pavarura përfitues të tij si Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, shoqërisë civile dhe medias për të kërkuar dhe luftuar secili prej nesh brenda kuadrit ligjor jo vetëm korrupsionin në shëndetësi, por edhe një qeverisje më të mirë të sistemit shëndetësor. Ky projekt ka organizuar trajnime të ekspertëve të këtyre institucioneve, trajnime të cilat do vijojnë edhe për vitin 2018.

Monitorimi i të drejtës së shëndetit duhet të jetë thelbësore për të siguruar se janë respektuar detyrimet e shtetit që rrjedhin nga zbatimi i të drejtës së shëndetit. Monitorimi dhe vënia para përgjegjësisë i autoriteteve përgjegjëse duhet të bëhet në planin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar nëpërmjet mekanizmave administrativ, politik dhe mekanizmave gjyqësorë, duke përfshirë një sërë aktorësh siç janë, OJQ-të, institucionet kushtetuese ose vetë qytetarët.

Avokati i Popullit përmes rekomandimeve të tij, ka si qëllim sensibilizimin e punonjësve të administratës shëndetësore për një shërbim cilësor dhe me standarde ndaj të drejtave të qytetarëve të çfarëdo kategorie shoqërore që t’i përkasin ato, të cilat, ndërmjet të tjerash, rrisin dhe besimin e qytetarëve te sistemi shëndetësor.

#### *Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike*

Spitali Universitar Psikiatrik “Xhavit Gjata” pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Shërbimi i Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër, Spitali Psikiatrik Elbasan dhe Spitali Psikiatrik Vlorë kanë në funksionin e tyre trajtimin më të specializuar dhe rehabilitimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët kanë shteruar të gjitha mundësitë ekzistuese për të marrë një shërbim të tillë në komunitet, nuk ka mundësi të trajtimit të tyre në kushte ambulatorë, apo nevojitet konsultë psikiatrike nga kërkesat që vijnë nga urgjencat e spitaleve të përgjithshme. Vizitat monitoruese në këto spitale përveç objektit të përgjithshëm të vizitave kishin si qëllim specifik: vlerësimin e respektimit të të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor

---

<sup>2</sup> I është rekomanduar MSHMS “Marrja e masave të nevojshme dhe të menjëhershme për futjen në protokolle mjekësore të sëmundjes së fibromialgjisë, si një detyrim që ka çdo institucion shtetëror për respektimin e të drejtave të njeriut të njohura me kushtetutë dhe ligje të veçanta”.

<sup>3</sup> I është rekomanduar QSUT - së “Marrja në konsideratë dhe zgjidhjen sa më parë të problematikave të ngritura nga pacientët që trajtohen me Hemodializë në QSUT “Nënë Tereza”

të specializuar me shtretër, të përcaktuara në ligjin nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; vlerësimin e procedurave të kryerjes së shtrimeve të pavullnetshëm; masat shtrënguese e kufizimin fizik; kushtet në të cilat mbahen këta persona, trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitues dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të prezantuara për këto ambiente gjatë viteve të mëparshme.

Nga gjetjet prej vizitave monitoruese të kryera gjatë vitin 2017, në spitalet e lartpërmendura psikiatrike, Avokati i Popullit konstatoi se, ndonëse disa prej rekomandimeve janë të përsëritura ndër vite, ato nuk janë zbatuar, ndaj kërkoi përmes rekomandimeve të dërguara vëmendje të veçantë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të drejtuesve të shërbimeve përkatëse për ndërhyrje të menjëhershme në zgjidhjen e problematikave.

Ndër të tjera u rekomandua marrja e masave të nevojshme nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë për:

- ✓ Vënien në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar.
- ✓ Gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, efektive dhe të qëndrueshme, për shqyrtimin kryesisht brenda afateve ligjore nga gjykatat të të gjitha vendimeve të dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”, si dhe për dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës.
- ✓ Shtimin në organikat e spitaleve të mjekëve psikiatër, infermierëve “kujdestarë/task forcë”, stafit të sigurisë, sanitarëve dhe berberit, me qëllim ofrimin e një shërbimi të përshtatshëm për specifikat e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër. Avokati i Popullit vlerëson së është i nevojshëm:
  - Shtimi i menjëhershëm dhe në vitet në vijim i kuotave për specializantë në Psikiatri;
  - Reformulimi i kriterëve të punësimit për funksionet klinike “kujdestar” dhe “task forcë”, me edukim infermieristik dhe njohuri të thelluara në rehabilitim psikiatrik spitalor, si dhe me aftësi moshore e fizike të përshtatshme për menaxhimin e axhitimit dhe riskut të lartë;
  - Trajnimi i punonjësve aktualë.
- ✓ Vendosjen e sistemit monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të spitaleve psikiatrike.
- ✓ Krijimin/rikonstruksionin e plotë të dhomave të izolimit, duke i kompletuar ato në përputhje me pikën 4.6 “Infrastruktura e Izolimit”, të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, pjesë e paketës së akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.

- ✓ Pajisjen e spitaleve me mjete të kufizimit mekanik, konform pikës 1.2 “Elementët e kufizimit”, germa b “Kufizimi Mekanik”, aktit nënligjor të cituar në pikën e mësipërme.
- ✓ Uljen e mbipopullimit duke i dhënë zgjidhje problemit të trajtimit si rezidentë të personave me aftësi të kufizuara intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si dhe duke mundësuar trajtimin e personave abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin në reparte toksikologjie të përshtatshëm për këtë qëllim.
- ✓ Mundësimin e riorganizimit të pavijoneve të pacienteve akutë më vete.
- ✓ Përmirësimin e kushteve në pavijone, ngrohje, dushe dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz të personave që trajtohen në spitalet psikiatrike, si dhe sigurimin e bazës së nevojshme materiale për stafet psiko-sociale.
- ✓ Pajisjen/vënien në funksion të plotë të laboratoreve klinike bio-kimike si dhe të aparateve të EKG-së.

## 2.12. E drejta për arsimim

Arsimi është një nga fushat më të vjera të çdo shoqërie. Përmes arsimimit shoqëritë dhe kombet u transmetojnë pjesëtarëve të tyre dijen, kulturën, trashëgiminë kulturore, vlerat përmes të cilave shkon përpara shoqëria.

Nevoja për më shumë arsimim, duhet të theksohet edhe në kontekstin social, ku niveli i dobët i arsimit dhe aftësimin është i lidhur drejtpërdrejtë me përjashtimin shoqëror për një numër të grupeve. Në përgjithësi, imazhi i arsimit në sytë e qytetarëve nuk është i mirë, prandaj edhe janë shtuar kërkesat për cilësi në arsim. Kjo reflektohet në debatet publike dhe shkrimet kritike të mediave për cilësinë e arsimit. Mund të ndodhë që kërkesat për përmirësim të cilësisë së arsimit të shtrohen edhe në formën që reflekton mungesë mirëkuptimi për situatën në të cilën ndodhet vendi dhe sistemi universitar i arsimit të lartë.

Gjatë vitit 2017, institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 60 ankesa në fushën e arsimit në përgjithësi. Nga këto, 10 kanë qenë raste me inisiativë të trajtuara nga ana jonë. Objekt i këtyre ankesave kanë qënë kryesisht zbatimi i procedurave për moskthime përgjigjesh nga MAS, probleme administrative nga stafi i universiteteve dhe punonjësve të administratës, mungesa e mësuesve ndihmës për fëmijët me emërime, transferime apo largime nga puna të mësuesve nga ana e DAR-eve, probleme financiare etj.

Nga numri i ankesave ka përfunduar shqyrtimi për 50 ankesa dhe 10 janë ende në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 40 ankesa janë të zgjidhura pozitivisht.

Problematikat kryesore që ka trajtuar institucioni ynë lidhur me fushën e arsimit kanë qënë të ndryshme por dotë veçoni m problemet e studentëve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë, të cilëve u është dashur të përballen me vështirësi administrative dhe përjashtimin pa të drejtë të tyre nga përgjysmimi apo përjashtimi i tarifës shkollore sipas VKM-së nr.269, dt.29.03.2017.

Një problematikë tjetër që vlen për tu theksuar ka qënë edhe ankesa nga kryetari i komunitetit Egjiptian për Qarkun e Elbasanit. Shqetësimi i tij ishte për studentët e komunitetit egjiptian dhe



rom në qarkun e Elbasanit, për përjashtimin nga pagesa e tarifës së shkollimit për arsimin e lartë në shkollat publike.

Universiteti A. Xhuvani, Elbasan kërkonte nga shoqatat listën me emrat e komunitetit rom dhe egjiptian referuar shkresës me nr.2441, datë 20.04.2017 të ish-Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Rinisë, drejtuar Rektorëve të Universiteteve si dhe Ministrit të Arsimit dhe Sportit për dijëni, e cila përcakton dokumentin që duhet pranuar nga fakultetet për studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, e që duhet të jetë: *“Deklaratë noteriale nga studentët të cilët të vetëdeklarojnë etninë e tyre”*. Nëse ky komunitet do kishte mjaftueshëm të ardhura, nuk do të përjashtohet me vendim të KM nga kjo tarifë. Për këtë problematikë i është dërguar rekomandim MPCSR.

Një çështje tjetër që mori vëmendjen e institucionit tonë ishte dhe Vendimi nr. 269 datë 29.03.2017 *“Për Përcaktimin e Kategorive të Individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”*. Pika 1 e këtij vendimi përcakton se: *“Përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentët të cilët janë pranuar në një program të ciklit të parë të studimeve në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, në institucionet publike të arsimit të lartë, të kategorive të mëposhtme a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuara nga KMCA-së....”*.

Gjithashtu, pika 3 e këtij vendimi citon se: *“Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të njëjtë studimi të të njëjtit cikël. Në këtë rast kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer”*. Sa më sipër, konstatojmë se për këtë kategori personash në krahasim me ligjin e vjetër të arsimit të lartë por edhe me VKM-në e shfuqizuar, ata në ciklin e dytë paguanin 50% të shumës për të vazhduar studimet në ciklin master shkencor dhe profesional, ndërsa vendimi i cituar më sipër i detyron të përballojnë vetë këtë cikël.

Ndërkohë, neni 8 i ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e të Verbrit”*, përcakton se: *“Arsimimi i të verbërve në sistemin shtetëror bëhet falas...”*. Ky përcaktim ligjor detyron administratën publike që këtë kategori personash ta përjashtojë nga tarifat e përcaktuara në VKM. Nisur nga fakti se ligji prevalon mbi çdo akt tjetër nënligjor, u është dërguar rekomandim disa universiteteve dhe MARS, për marrjen e masave përkatëse.

Rastet e trajtuara me iniciativë nga ana jonë kanë qënë kryesisht rastet e bëra publike në mediane dhe vizive që lidhen me kushtet infrastrukturore në shkolla të ndryshme të vendit, mungesa e ngrohjes në muajt e dimrit apo lagështira dhe mungesa e artikujve bazë për zhvillimin normal të një ore mësimore si banka, dyer e dritare, të cilat janë problematike në shumë shkolla që u përkasin zonave të largëta.

Përveç problemeve infrastrukturore rrjedhimisht dhe atyre hapësinore, shkolla ballafaqohet edhe më një sërë problemesh të tjera. Zbatimi i reformave, cilësia, vlerësimi, edukimi, dhuna, bulizmi, rënia e interesimit apo e motivit për të nxënë, si dhe mospunësimi i studentëve pasi mbarojnë studimet e larta, janë një ndër problemet më madhore në shkollat tona.

Ajo që duhet të përbëjë shqetësim madhor për shoqërinë tonë e në veçanti për mësimdhënësit, prindërit dhe Ministrinë e Arsimit është fakti që shkolla është ende larg pritshmërive krahasuar me vendet e zhvilluara që aspirojmë të integrohemi. Ministria e Arsimit duhet të zhvillojë politika dhe të hartojë plane, zbatimin e cilave do ta bëjë shkollën një ambient më të dashur, atraktiv dhe stimulues për nxënësit. Kjo do të kishte një impakt direkt në ngritjen e cilësisë, rritjen e interesimit dhe në rezultate më të qënësishme në përmbushjen e objektivave konkrete.

### **2.13. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka si prioritet të punës së tij, monitorimin e situatës mjedisore në Republikën e Shqipërisë, si edhe zbatimin e legjislacionit të miratuar për këtë fushë, nga institucionet qëndrore, entet publike dhe organet e qeverisjes vendore, përsa i takon akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe Konventave dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Përtej mundësive të kufizuara me të cilat haset institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2017 kemi patur një fokus të veçantë në zbatimin me rigorozitet të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim që të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Shqipëri, si edhe garantimin e standardeve të një mjedisi sa më të shëndetshëm.

Në vijim të shqetësimeve të ngritura edhe në vitet e kaluara, Avokati i Popullit konstaton në vijimësi faktin se, problemi kryesor që ekziston në fushën e mbrojtjes së mjedisit është mungesa e ndëshkimit, apo edhe gjobat mjaft të ulëta, të nxjerra si dënime administrative për ata individë apo subjekte që ushtrojnë një veprimtari të dëmshme ndaj mjedisit.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2017 ka trajtuar 20 ankesa, të paraqitura ndaj organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, si dhe për promovimin e një ambienti e mjedisi sa më të pastër dhe të shëndetshëm.

Gjithashtu, Avokati i Popullit është treguar aktiv në trajtimin e rasteve të ndryshme me iniciativën e tij. Janë 3 rastet e filluara me iniciativë nga ana jonë, me qëllim hetimin dhe verifikimin e çështjeve të ndjeshme në këtë fushë, nga ku edhe janë konstatuar veprime, apo mosveprime në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat çënojnë të drejtën për një ambient të pastër e të shëndetshëm.

Në këtë kuadër mund të theksojmë çështjet e iniciuara lidhur me ndotjen alarmante për shkak të djegies së mbetjeve urbane, në qytetin e Shkodrës, si edhe pastrimin e hapësirave publike në liqenin e Pogradecit, me qëllim që ato, t'u vihen në dispozicion qytetarëve për shfrytëzimin gjatë periudhës së sezonit veror.

Avokati i Popullit po ndjek në vijim, me interes dhe përparësi, veprimet e ndërmara nga Ministria e Mjedisit në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të shtetit Shqiptar, në zbatim të Marrëveshjes së Parisit, si një akt ndërkombëtar që parashikon ulje të niveleve të ndotjeve nga shtetet palë të saj, me qëllim garantimin dhe respektimin e një mjedisi sa më të shëndetshëm, jo vetëm për popullsinë aktuale të botës, por edhe për brezat e ardhshëm. Ky angazhim është vlerësuar edhe si një element thelbësor për respektimin e së drejtës për një ambient të pastër e të shëndetshëm.

Shqetësimet dhe pretendimet e ndotjes së mjedisit janë evidentuar dhe iniciuar si raste për shqyrtim, edhe në kuadër të bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit, me organizatat e shoqërisë

civile nëpër qarqe, të cilat përcjellin pranë institucionit tonë shqetësimet e komuniteteve lokale në qytetet e tyre. Është konstatuar në vazhdimësi se shkak i burimit ndotës është pikërisht mosveprimi i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj, ndaj subjekteve të ndryshme, që shkaktojnë ndotjen mjedisore.

Nga çështjet e shqyrtuara nga ana jonë, 14 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve, në dy raste ankuesit kanë hequr dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm i pretendimeve të tyre, ndërkohë që tre të tjera kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2018.

Objekti i ankesave të paraqitura dhe marra në shqyrtim kanë qenë: ndotjet e ambientit nga hedhja e mbeturinave në vende publike; ndotja e ajrit nga djegiet e mbetjeve urbane; aktivitetet e subjekteve që veprojnë në tejkalim të lejeve me të cilat janë pajisur; si edhe ndotjet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në zonat e banuara, të prekura nga këto ndotje.

Shqetësuese paraqitet ende edhe situata gjatë vijës bregdetare, përse i përket largimit të ujërave të zeza të hoteleve dhe shtëpive të banimit, si në zonën e Durrësit, apo edhe plazhet e jugut, kryesisht gjatë stinës së verës. Situata në plazhet publike paraqitet në kundërshtim me synimin për një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm, për kryerjen e pushimeve.

Gjatë vitit 2017 janë konstatuar raste të përsëritura të ndotjes flagrante të liqenit të Fierzës, nga mbetje të ndryshme urbane, të cilat janë evituar me angazhimin e strukturave të ndryshme të pushtetit qendror dhe vendor, por që ende mbetet një problem ekzistues, për shkak edhe të shtrirjes së këtij liqeni në hapësirat mes shteteve, duke bërë që burimi i ndotjes të mbetet në mjaft raste i paidentifikueshëm.

Problematikat në fushën e mjedisit në Shqipëri sërish mbeten si më poshtë:

- ✓ Ndotja e ajrit në qytetet e mëdha shqiptare, sidomos në Tiranë, e cila vjen si pasojë e rritjes së numrit të makinave në qarkullim dhe pakësimit të hapësirave të gjelbërimit, pavarësisht projekteve modeste të njësive të caktuara të qeverisjes vendore, apo edhe strukturave të pushtetit qendror, për mbjelljen e fidanëve të rinj në zona që veçohen për nivele të larta të ndotjes.
- ✓ Hedhja e mbeturinave në lumenj e liqene, si edhe derdhja e ujërave të zeza të papërpunuara.
- ✓ Mbledhja e mbeturinave në Shqipëri dhe riciklimi i tyre nuk është ende në standardet e konsoliduara botërore. Mbeturinat nuk mbledhen pothuajse fare nëpër fshatra. Në këtë kuadër duhet theksuar edhe fakti se ka nisma lidhur me procesin e ndarjes dhe veçimit të mbeturinave,, si një nga fazat që do të shërbente jo vetëm në mbledhjen sa më të shpejtë të mbeturinave nga vendet e tyre të grumbullimit, por edhe në trajtimin e tyre të mëtejshëm të specializuar, në impiantet e riciklimit. Avokati i Popullit beson dhe shpreson ende se këto nisma do të jenë eficiente në zgjidhjen përfundimtare të problemit të trajtimit të mbetjeve në Shqipëri.
- ✓ Prerjet e pyjeve dhe zjarret janë shkaqet kryesore për shpyllëzimin dhe zhdukjen e pyjeve në Shqipëri, duke dëmtuar në këtë mënyrë një nga burimet e vlefshme të ruajtjes së parametrave të pranueshëm të mjedisit.

Avokati i Popullit konfirmon rëndësinë që duhet t'i kushtohet gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjes

së ambientit në Shqipëri të cilat lidhen ngushtësisht me respektimin e të drejtave të njeriut. Këto fusha kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe bashkëpunim të të gjithë faktorëve, me qëllim që të garantohet kujdesi për shëndetin dhe të rritet cilësia e jetës në vend. Avokati i Popullit thekson se çështjet e mjedisit janë shumë të mprehta dhe kërkojnë më shumë vëmendje.

#### **2.14. Mbrojtja e konsumatorit**

Mbrojtja e konsumatorit paraqitet një nga fushat kryesore që lidhet drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rregullimi i kësaj fushe mbështetet në tri shtylla kryesore sikundër janë, shëndeti i konsumatorit, sigurimi i konsumatorit dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike të konsumatorit.

Ligji nr.9902, datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar, përbën legjislacionin bazë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit. Në nenin 56 të këtij ligji, Avokatit të Popullit i njihet një rol i veçantë për mbrojtjen e interesave të ligjshme dhe të drejtave të konsumatorit, si për rastet e paraqitjes së ankesave individuale, ashtu dhe përmes proaktivitetit të shfaqur në ndjekjen e rasteve me inicjativë kur preken interesat e një komuniteti të gjerë.

Për vitin 2017, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë adresuar në total 72 ankesa, të cilat lidhen kryesisht me pretendime për mbifaturime nga operatorë në treg, që ofrojnë shërbime publike (“OSHEE” sh.a., dhe “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a.), si edhe për cilësinë e shërbimeve që ofrohen prej tyre.

Fokus të veçantë kanë marrë ankesat për; cilësinë dhe ofrimin e shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë në vështirësi dhe pamundësi ekonomike; për pagesën e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike; për familjet të cilat jetojnë në kushte ekstreme varfërie; për familjet me anëtarë të moshuar pensionistë; familjet anëtare të komuniteteve rome, apo familje të tjera me individë të papunë, punëkërkues dhe të përjashtuara edhe nga skema e ndihmës ekonomike.

Në mjaft raste rezultojnë detyrime financiare të akumuluar ndërmjet vite, ku edhe pse palët kanë lidhur akt-marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura, të konsumit të energjisë elektrike, përsëri subjektet familjare janë ndodhur në kushtet e pamundësisë financiare, qoftë edhe pagesës së një shume minimale prej 1000 lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të tyre.

E drejta për të pasur disa shërbime elementare, si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe furnizimi me energji elektrike është një nevojë thelbësore njerëzore, një e drejtë themelore, mungesa e së cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Në këto rrethana, i kemi sugjeruar Entit Rregullator të Energjisë, gjetjen e mundësive sa më të përshtatshme për konsumatorët vulnerabël, me qëllim përfshirjen e politikave të mbrojtjes sezonale, ku të mund të mbahen si referencë kushtet atmosferike, temperaturat ekstreme të ftohta në dimër dhe shumë të nxehta në verë, si dhe sipas të cilave, të ndalohet ndërprerja e energjisë elektrike për konsumatorët, kryesisht në orarin 08:00 - 23:00, të ditës.

Pavarësisht hartimit të rregullores “*Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë*”, nga Enti Rregullator i Energjisë, në të cilën përcaktohen një sërë masash lidhur me detyrimet e Furnizuesit Universal, apo procedurat që duhet të ndiqen për ndërprerjen e energjisë elektrike (në rast mospagese të energjisë elektrike për më shumë se katër muaj, si dhe në rast të mosrespektimit të akt-marrëveshjes për pagesën e energjisë, sipas një plan-

pagese të dakordësuar me furnizuesin), gjykojmë se mbrojtja sociale dhe ekonomike e këtyre grupeve të cënueshme nuk është e mjaftueshme dhe duhet të konsiderohet si prioritet, për shkak se familjet në nevojë ekstreme nuk arrijnë dot të sigurojnë mbijetesën dhe jo më të përballen me pagesat e këtyre shërbimeve publike.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, kjo duhet të shoqërohet me një paketë ndryshimesh ligjore, për ofrimin e zgjidhjeve të menjëhershme, me qëllim që këto familje të mos privohen nga e drejta për akses në furnizimin e nevojshëm me energji elektrike, për t'ju siguruar atyre minimumin e mundshëm brenda një sasive limit kËh energji.

Gjithashtu është e nevojshme të shmanget absolutisht, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për këto grupe, me qëllim që gjithkush të marrë shërbimet bazike, pavarësisht statusit social dhe ekonomik që mund të gëzojnë qytetarët e këtij vendi. Një problematikë tjetër ka të bëjë me reformën në sektorin e ujit. Pavarësisht *se treguesit e fundit dëshmojnë se reforma në sektorin e ujit, në lidhje me kthimin e ligjshmërisë të pagesat e faturave është në rrugë të mbarë, për më tepër shërbime cilësore dhe më shumë investime në të ardhmen, ajo ka edhe problemet e saj.*

Një pjesë e territorit të Shqipërisë, e sidomos zonat rurale nuk furnizohen me ujë të pijshëm, apo furnizohen pjesërisht, duke përbërë kështu një vështirësi të madhe të jetesës dhe shërbimeve bazë të nevojshme për banorët. Për zgjidhjen e kësaj problematike ka nevojë për subvencionim ndaj grupeve në nevojë dhe familjeve në nevojë, duke përfshirë dhe aplikuar për këtë qëllim edhe kritere të tjera të nevojshme me qëllim reduktimin maksimal të këtij fenomeni.

### **2.15. E drejta për strehim**

Gjatë vitit 2017, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar në total 77 ankesa, lidhur me problemin e strehimit. Problematikat e evidentuara në shqyrtimin e çështjeve mbi respektimin e së drejtës për strehim, lidhen me: mungesën e zgjidhjes së strehimit për personat e pastrehë, të cilët për shkak të varfërisë nuk mund të përballojnë shpenzimet e pjesës së detyrimit, për bonus qiraje, apo kreditë e buta; problematika dinamike e strehimit të personave të komunitetit rom, që në disa raste janë zhvendosur me forcë nga qendrat e vendbanimit të tyre; zvarritjen e procedurave administrative nga strukturat shtetërore ndaj kërkesave për strehim social, etj.

Numri i personave të pastrehë rezulton të jetë dyfish më i lartë se numri i personave të pastrehë që kanë përfituar strehim social. Personat e pastrehë mbeten të painformuar sa i takon përmbushjes nga ana e tyre të kritereve ligjore për përfitimin e strehimit. Programi për banesa me kosto të ulët nuk është i përballueshëm për të varfërit dhe për këtë arsye, të varfërit nuk përfitojnë nga ky program.

Gjithashtu, edhe procedurat bankare të aplikueshme për këtë qëllim janë tepër të gjata dhe të kushtueshme. Programi i banesave sociale me qira ka në fokus familjet me të ardhura të ulëta, por njerëzit që jetojnë afër, ose nën kufirin e varfërisë, nuk mund ta përballojnë këtë program. Programi më i vogël është ai i subvencioneve të strehimit, ndërkohë që këto shihen si zgjidhje e përkohshme e problemeve të strehimit. Programet e strehimit social duhet të zgjerohen më tej për të përmbushur kërkesat e grupeve në nevojë dhe duhet të riorientohen drejt shtresave në pozita të pafavorizuara, për përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes nga më të varfrit.

Avokati i Popullit ka luajtur një rol aktiv që prej muajit Shkurt 2016, duke u përfshirë në një proces intensiv konsultimi me Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe me aktorë të tjerë të fushës, mbi

hartimin e ndryshimeve të ligjit nr.9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, dhe më pas të hartimit të projektligjit “Për strehimin social”.

Një pjesë e konsiderueshme e sugjerimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbi përmbajtjen e dispozitave të këtij projektligji janë përfshirë tashmë në projektligjin e miratuar në Këshillin e Ministrave. Po kështu, nga komunikimet zyrtare me disa nga Komisionet Parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, jemi vënë në dijeni të procesit të shqyrtimit dhe miratimit të këtij projektligji, ku edhe gjatë kësaj faze kemi mbajtur një qëndrim aktiv.

## **2.16. E drejta për informim**

Të drejtës për informim, si një e drejtë themelore e individit, e afirmuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në të drejtën ndërkombëtare, i është kushtuar një vëmendje e veçantë nga ana e Avokatit të Popullit, për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e kësaj të drejte në rast shkeljeve gjatë veprimtarisë së organeve të administratës publike në vend.

Regjimi juridik bazë i së drejtës për informim është përcaktuar nga ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore të tjera në fuqi, të cilat plotësojnë dhe saktësojnë aspekte specifike të këtij regjimi juridik.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka vijuar të marrë në shqyrtim dhe ka trajtuar ankesat e paraqitura, të cilat kanë patur si objekt shkeljet e pretenduara të së drejtës për informim, si dhe kërkesat për informim, në lidhje me veprimtarinë institucionale të Avokatit të Popullit.

Në të gjitha rastet, procedurat e ndjekura nga ana jonë gjatë kryerjes së veprimeve për hetim administrativ të ankesave kanë qënë konform kompetencave ligjore të Avokatit të Popullit, dhe në respektim të rolit dhe kompetencave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si autoriteti publik përgjegjës në mbrojtjen e kësaj të drejte, sikurse përcaktohet në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Nisur nga analiza e rasteve të paraqitura dhe problematikat e evidentuara në institucionin e Avokatit të Popullit, gjatë këtij viti, rezulton se:

- ✓ 24 ankesa janë paraqitur nga subjekte të interesuara, për mostrajtim të kërkesave nga ana e organeve të administratës publike në shkelje të drejtës për informim dhe për mosvënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare nga këto organe, sipas përcaktimeve në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- ✓ 5 ankesa kanë për objekt, shkeljen e të drejtës për informim lidhur me ecurinë e procedurave specifike ligjore, nga organet përgjegjëse gjatë procedurave administrative, të përcaktuara në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

- ✓ 30 kërkesa i janë drejtuar institucionit nga subjekte të interesuara për t'u informuar mbi veprimtarinë tonë institucionale, sipas rregullimeve të regjimit juridik, të përcaktuar nga ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Pas marrjes në shqyrtim dhe ndërhyrjes nga ana jonë për ankesat e paraqitura për mosveprime, apo zvarritje të konstatuara në kuadrin e të drejtës për informim, reagimi i institucioneve shtetërore në trajtimin e kërkesave të subjekteve të interesuara, ka qenë brenda kompetencave ligjore të organit përgjegjës dhe afateve kohore, të përcaktuara në ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në këtë kuadër vlen të përmendet fakti se, nga ana e organeve të administratës shtetërore ka një qasje më institucionale dhe reagim pozitiv për zbatimin e ligjit dhe për zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga individët.

Kjo gjë reflektohet gjithashtu në numrin e ulët të ankesave, që i referohen mosrespektimit të regjimit juridik të së drejtës për informim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Problematika të hasura të së drejtës për informim, janë trajtuar në këtë raport edhe në kuadër të ankesave të shqyrtuara nga ana jonë, sipas fushave të tjera të ndërhyrjes sonë institucionale, që si objekt kryesor trajtimi kanë patur një problematikë të ndryshme nga ajo e së drejtës për informim.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, institucioni i Avokatit të Popullit, ka plotësuar detyrimet si subjekt i këtij ligji, kryesisht në plotësimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, pasqyrimin e tij në faqen zyrtare të Institucionit, për të qënë i aksesueshëm nga publiku i interesuar, si dhe për regjistrimin e kërkesave dhe kthimin e përgjigjeve subjekteve të interesuara, brenda afateve ligjore.

## **KREU 3**

### **Grupet vulnerable dhe respektimi i të drejtave të tyre**

#### **3.1. Ndhima Ekonomike**

Ndhima ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë dhe e kushtëzuar, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara. Kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike vlerësohen sipas nevojave dhe mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive dhe transparente, si pjesë e një formule të pikëzuar, e përkufizuar në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili është ligji që rregullon funksionimin e ndihmës ekonomike në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj dhe aktet nën ligjore në zbatim të tij parashikojnë rregullim të qartë për përfituesit, kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për përfitimin e kësaj ndihme.

Sistemi për përfitimin e ndihmës ekonomike duket se ka krijuar konfuzion dhe shqetësim të madh për qytetarët. Sipas familjeve në nevojë, problemet fillojnë që nga përjashtimi në mënyrë të padrejtë nga ndihma ekonomike deri tek ulja e shumës së parave në shifra qesharake. Për familjet, me të ardhura minimale për jetën, ndihma ekonomike është i vetmi burim financiar për të përballuar shpenzimet e jetesës.

Ajo që përbën një problem kryesor dhe lehtësisht të evidentueshëm është se: masa e ndihmës ekonomike është shumë e ulët dhe thuajse e papërfillshme në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme që i duhen familjes, ose një individit të vetëm për të mbijetuar, e jo më pastaj për të konsideruar për dinjitet dhe integritet në shoqëri.

E pajustificueshme për ekzistencën e kësaj gjendje është mos përcaktimi i një minimumi jetik dinjitoz, qoftë edhe brenda mundësive të burimeve të shtetit shqiptar, i cili, pa dyshim, do të plotësonte më mirë nevojat e çdo qytetari në nevojë. Qeveria duhet të programojë më mirë plotësimin e këtyre nevojave në lidhje me vlerën e minimumit jetik.

Në vitin 2016, Avokati i Popullit ka realizuar studimin “Llogaritja e minimumit jetik në Shqipëri”. Pas prezantimit publik të këtij studimi, janë përgatitur dhe dërguar dy rekomandime, përkatësisht për Ministrin e Shëndetësisë dhe Ministrin e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, megjithatë ende nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve, apo edhe për konsiderimin e gjetjeve të dhëna në studimin e sipërcituar. E kuptojmë se ka vështirësi në këtë drejtim, por ndoshta paraqitja e një plani të qartë të rritjes së këtyre vlerave do të kishte impakt tek qytetarët



Disa nga problematikat e kostatuara nga shqyrtimi i ankesave për ndihmën ekonomike janë:

- ✓ Mos informimi i mjaftueshëm dhe në kohë i qytetarëve për kriteret, procedurat dhe plotësimin e dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike.
- ✓ Masa e ulët e shumës së përfituar nga përfituesit në përgjithësi, dhe jetimët dhe viktimat e trafikimit në veçanti.
- ✓ Mungesa e burimeve njerëzore për të verifikuar fizikisht banesat dhe kushtet e jetesës të përfituesve 1 herë apo dy herë në vit, siç parashikohet në ligj.
- ✓ Mungesa e parashikimit të fondeve të organeve të qeverisjes vendore, të destinuara për përfituesit e ndihmës ekonomike në masën 3%, siç parashikohet në ligj.
- ✓ Mungesa e shumë shërbimeve shoqërore, të cilat do të rrisnin cilësinë e jetës të qytetarëve përfitues të ndihmës ekonomike dhe familjeve të tyre.
- ✓ Mosofrimi pranë vendbanimit të tyre i kurseve të formimit profesional dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.
- ✓ Përjashtimi nga ndihma ekonomike e personave me aftësi të kufizuara në pjesën që i takon atyre, kur familja është në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike.
- ✓ Mos aplikimi i programeve sociale, ku përfituesit e ndihmës ekonomike të përfshihen duke dhënë kontribut me punën e tyre dhe kjo të influencojë në rritjen e të ardhurave të familjeve të tyre.

Gjejmë rastin të theksojmë se shtrirja e zbatimit të regjistrimit elektronik të ndihmës ekonomike në të gjithë vendin do të shkaktojë problematika të cilat u vunë re gjatë pilotimit të tij në 3 qarqet e vendit, Tirane, Elbasan dhe Durrës, ku zbatimi i tij filloi në muajin qershor 2014.

Duke qenë se programi i ndihmës ekonomike ka si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tyre, shteti shqiptar duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për arritjen e objektivave sociale të parashikuara në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë.

Axhenda “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2015 - 2030”, objektivin nr.1 të saj e lidh me zhdukjen e varfërisë duke theksuar ndër të tjera nevojën e marrjes së masave për zbatimin e sistemeve të përshtatshme për mbrojtjen sociale, zbatimin e programeve dhe politika për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha dimensionet e saj.

### **3.2. Të drejtat e fëmijëve**

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit për të drejtat e fëmijëve gjatë vitit 2017 ka vijuar e ndërthurur në dy funksione kryesore: atë të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve.

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 18, datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Avokati i Popullit gëzon rolin e monitoruesit për zbatimin e këtij ligji në përputhje me nenin

34 të këtij ligji ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar”. Sipas këtij ligji, për herë të parë vendoset standardi që të paktën në çdo Bashki për 3000 fëmijë, të ketë një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve.

Avokati i Popullit duke u nisur nga eksperiencia e fituara gjatë veprimtarisë së këtyre viteve, ku janë konstatuar një sërë problematikash, vlerëson se sfidat që lidhen me zbatimin legjislativ për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve lidhen me: buxhetimin real i nevojshëm nisur nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve; ngritja e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve; hartimi i politikave gjithëpërfshirëse sociale në nivel vendor i bazuar në një bazë të dhënash të sakta mbi numrin e familjeve në nevojë si dhe kategoritë e fëmijëve me probleme sociale; konsolidimin e mekanizmave përgjegjës që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës si dhe krijimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Organizatës Ndërkombëtare “Save the Children në Shqipëri për zbatimin e projektit “*Children Keeping Children Safe*”, nënshkruar në dhjetor 2016, janë hartuar dokumentet e mëposhtëm:

- **Udhëzuesi: “Për bashkëpunimin e Institucionit të Avokatit të Popullit me Fëmijët dhe me Shoqërinë Civile”,** është dokument orientues dhe rekomandues, në ndihmë të Institucionit të Avokatit të Popullit për të rritur bashkëpunimin e tij me fëmijët dhe me shoqërinë civile në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është përmirësimi dhe bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe shoqërinë civile.
- **Raporti “Zëri i të rinjve në Shqipëri,** përbën një studim i cili synon vlerësimin e pikëpamjeve të fëmijëve lidhur me problematikat e tyre sipas përcaktimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Partneriteti i krijuar nëpërmjet institucionit të Avokatit të Popullit dhe “Zërit të të Rinjve në Shqipëri” do të jetë instrumenti kryesor për të advokuar dhe ndërgjegjësuar të gjitha institucionet në nivel vendor dhe qendror, kombëtar dhe ndërkombëtar për përmbushjen e detyrimeve të tyre në respektimin e të drejtave të fëmijëve në vend.
- **Draft-Plani Kombëtar për Monitorimin e të Drejtave të Fëmijëve,** qartëson dhe përcakton mekanizmat, institucionet përkatëse për monitorimin e të drejtave të fëmijëve bazuar në dy dokumenta kryesorë: Agjendën Kombëtare për Fëmijët 2017-2020 dhe Ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.
- **Draft-paketa e standardeve për pjesëmarrjen e fëmijëve gjatë procesit të monitorimit të të drejtave të fëmijëve,** ka si qëllim hartimin e mekanizmave dhe instrumentave të nevojshme për të garantuar pjesëmarrjen e fëmijëve gjatë procesit të monitorimit të institucioneve të cilat ofrojnë shërbime për fëmijët. Kjo paketë standardesh është pilotuar nga Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në bashkëpunim me ekspertët lokalë në tre institucione të përkujdesit social që ofrojnë shërbime të përkujdesit social rezidencial për fëmijët në nevojë.

Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile, në mars 2017, së bashku me organizatën Terre des Hommes Institucioni i Avokatit të Popullit organizoi ëorkshopin me 24 Organizata të Shoqërisë Civile që punojnë në fushën e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, me qëllim bashkërendimin e punës dhe mbështetjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për zbatimin e planeve të advokatisë

për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Pas zbatimit të planeve të advokacisë, ky Rrjet do të hartojë një draft-raport me rekomandime për institucionet në nivel vendor dhe qëndror të cilat do t'i propozohen Institucionit të Avokatit të Popullit për zbatimin e tyre në vazhdimësi.

**Rritja e kapaciteteve** të punonjësve të Seksionit për Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit me qëllim përvetësimin e njohurive bazë të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar të të drejtave të fëmijëve, ka qenë një nga angazhimet e realizuara gjatë vitit raportues me mbështetjen e vazhdueshme të Save the Children. Kjo, me synimin e qasjeve praktike drejt nevojave si dhe krijimin e mundësive të përdorimit të analizës dhe mjeteve për shqyrtimin e sfidave praktike në planifikimin dhe menaxhimin e një procesi. Synimi është përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dedikuar fëmijëve dhe sigurimin e buxhetit të nevojshëm.

Një fokus i veçantë në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë dhe garantimi i **pjesëmarrjes së fëmijëve në promovimin e të drejtave të tyre**. Gjatë vitit 2017, Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve i AOMF në kuadrin e veprimtarive “Të rinjtë frankofonë dhe të drejtat e tyre”, lancoi si një aktivitet të këtij viti “Vizato të drejtat e tua, të drejtat e veçanta për fëmijët migrantë”.

Mbi këtë bazë, institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në një nga shkollat e kryeqytetit aktivitetin promovues për të drejtat e fëmijëve, të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtat e fëmijëve migrantë, synimi i të cilit ishte ndërgjegjësimi dhe informimi i fëmijëve me të drejtat e tyre si dhe faktit sesa vulnerabël dhe sa ndjeshmëri ka për të drejtat e fëmijëve migrantë.

Gjithashtu, Avokatja e Popullit së bashku me Grupin e të Rinjve “16+”, ka ndërmarrë **nismën “Unë zgjedh t’ju dhuroj dashuri bashkëmohatarëve të mi”**, synimi kryesor i së cilës është promovimi i solidaritetit, vullnetarizmit tek fëmijët në mënyrë që të përfshihen drejtëpërsëdrejti për krijimin e një bote më të mirë. Aktiviteti i parë i organizuar, në muajin dhjetor, në ambjentet e Institucionit të Avokatit të Popullit me Grupin e të Rinjve 16+ së bashku me fëmijët e Akademisë Botërore të Tiranës (Eorld Academy of Tirana), është vetëm fillimi i një pune të mirë e cila do të shoqërohet në vitin 2018 me përfshirjen e fëmijëve në hartimin e Strategjisë së komunikimit me fëmijët me qëllim rritjen e besimit të rolit që Avokati i Popullit ka për të garantuar të drejtat e fëmijëve.

#### **(FOTO)**

Gjatë vitit 2017, janë 85 raste të trajtuara me iniciativën e Avokatit të Popullit me objekt të drejtat e fëmijëve. Pavarësisht numrit të ankesë/kërkesave të trajtuara, theksojmë se shumë nga ankesat e trajtuara kanë patur si objekt një numër të caktuar individësh-fëmijë, ndaj mund të themi se nga trajtimi i tyre mund të kenë përfituar një numër shumë më i madh personash.

Në kuadrin e statistikave, nga numri total prej 163 ankesa, kërkesa apo inspektive (në institucione publike të përkujdesit rezidencial për fëmijë, Shkolla Speciale, Institute për fëmijë me aftësi të kufizuara), janë zgjidhur pozitivisht apo sqaruar pa rekomandim 44 raste, ndërsa janë hartuar 68 rekomandime e ku përfshihen edhe rastet e të miturve në konflikt me ligjin, nga të cilat 44 janë në shqyrtim, 23 të pranuar nga administrata dhe 2 të refuzuara.

Problematikat e evidentuara gjatë këtyre inspektimeve/monitorimeve janë shumë dimensionale të cilat kanë kërkuar shqyrtimin e faktorëve si nxitës e mbajtës të problematikave të konstatuara, të

lidhur me veprimet ose mosveprimet e shumë institucione të administratës publike në nivel vendor edhe qendror.

Nga raportet e inspektimeve të realizuara në institucionet e përkujdesit social që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijët në nevojë nga gjetjet kryesore të konstatuara rezulton se:

✓ Institucionet vazhdojnë të jenë të fokusuar në zbatimin e standardeve që lidhen me aspektet fizike, dhe kanë vështirësi në zbatimin e standardeve që lidhen me aspektet e kujdesit psiko-social të fëmijëve, riintegrimin, pjesëmarrjen e prindërve e të afërmeve në procesin e hartimit të planeve individuale, lidhjet me komunitetin etj.

Janë vërejtur mangësi të personelit në drejtim të figurave profesionale dhe kapaciteteve/kualifikimeve profesionale për trajtimin e fëmijëve sipas grup-moshave, zhvillimit psikologjik e sipas nevojave të veçanta të tyre.

✓ Vështirësi janë konstatuar edhe në funksionimin e ekipeve multidisiplinare dhe në adresimin e nevojave të fëmijëve në ofrimin e tipologjive të reja të shërbimeve në interesin më të lartë të tyre.

✓ Ndjekja e procedurave për marrjen e kujdestarisë ligjore me vendim gjykate, po ecën me ritme të ngadalta për shkak të zvarritjes së proceseve gjyqësore, neglizhencës së personelit dhe vështirësive për të kontaktuar me familjarët e fëmijëve të vendosur në institucione.

✓ Në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror publike, ende nuk janë vënë në zbatim tipologjitë e reja të shërbimeve të udhëhequra nga plane të detajuara për deinstitutionalizimin, pasi plani i veprimit ka ngelur ende i pamiratur.

✓ Mungesa e shërbimeve në nivel vendor, moskoordinimi dhe bashkërendimi i punës nëpërmjet strukturave që ofrojnë shërbime për fëmijët ka sjell zgjatjen e kohëqëndrimit të tyre në institucionet e përkujdesit social rezidencial.

✓ Mungesa e indeksimit financiar të kuotës ushqimore me indeksimin e ushqimeve, sipas ndryshimeve të *Udhëzimit nr. 5, datë 1.8.2012 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror"*.

✓ Mungesa e fillimit të punës për të mundësuar finalizimin e procesit decentralizimit duke iu referuar nenit 52 të ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

Lidhur me inspektimet e realizuara në institucionet e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe Njësisë Për Mbrojtjen e Fëmijëve (strukturat e menaxhimit të rastit pranë Bashkive) janë konstatuar (i) mungesa e kapaciteteve (burimeve njerëzore) dhe (ii) mundësitë e kufizuara financiare të cilat bëjnë që qeverisja vendore të mos u përgjigjet kërkesave për ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve.

Vërehen gjithashtu, probleme të mos koordinimit dhe institucionalizimit të bashkëpunimit mes qeverisjes vendore, OJF-ve dhe strukturave të tjera shtetërore. Konstatohet se njohuritë në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve në praktikën e përditshme janë ende të kufizuara me gjithë trajnimet që janë ofruar herë pas here nga organizata të ndryshme.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të trajtimit të fëmijëve në shërbimet publike (konkretisht shërbime sociale dhe arsimore) lidhur me gjetjet e mësipërme me qëllim garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së tyre të jetës janë dërguar rekomandimet përkatëse Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Bashkive dhe Agjensisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të fëmijëve si edhe institucioneve ku ofrohen shërbimet e përkujdesit social.

Të gjitha institucionet kanë marrë përsipër zbatimin e tyre kjo e reflektuar nga komunikimi zyrtar. Shqetësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit mbetet implementimi konkret, brenda afateve kohore, i rekomandimeve të pranuar nga institucionet përgjegjëse.

### **3.3. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara**

Një ndër grupet e cënueshme, të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur në fokusin e tij të punës gjatë vitit 2017, është edhe mbrojtja e promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë këtij viti janë depozituar dhe trajtuar 30 ankesa për këtë kategori. Kanë përfundur 24 ankesa dhe janë në shqyrtim 6. Disa nga problematikat e trajtuara gjatë këtij viti, kanë qenë si më poshtë:

- ✓ Avokati i Popullit që sipas ligjit nr.93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*, është monitorues i zbatimit të këtij ligji në përputhje me Konventën e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, ka konstatuar se pavarësisht përcaktimit të afateve ligjore për nxjerrjen akteve nënligjore nga hyrja në fuqi e ligjit, ende ato nuk janë nxjerrë.

Më datë 06.02.2017 i kemi rekomanduar Ministrin të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë *marrjen e masave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3 (Shërbimet për një jetesë të pavarur); të nenit 7/pika3 (Vendimmarrja e mbështetur), të nenit 10/pika5 (Komisioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje), nenit 8/pika3, nenit 8/pika4 (Ndihmësi personal) të Ligjit nr.93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.*

Në përgjigje të rekomandimit tonë, jemi informuar se rikonceptimi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit bio-psiko-social është pjesë e një reforme për të cilën ish-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë po punon prej dy vitesh. Lidhur me vendimmarrjen e mbështetur, ishte e domosdoshme kryerja e një studimi dhe analiza e legjislacionit bashkëkohor ndërkombëtar.

Ka përfunduar një analizë e tillë, konkluzionet e së cilës do të përdoren për hartimin e aktit përkatës nënligjor, sigurisht të përshtatur për kushtet e Shqipërisë dhe në përputhje me legjislacionin aktual.

- ✓ Në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2017, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme që personat me aftësi të kufizuar të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre kushtetuese, i rekomanduam Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve *marrjen e masave për të garantuar të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuar në territorin e Shqipërisë.*

- ✓ Për mosdhënien e plotë të dyfishit të pagesës për shkak të verbërisë. Personave, të cilët gëzojnë Statusin e të Verbërit nuk u është dhënë e drejta për të përfituar të plotë dyfishin e pagesës për shkak të verbërisë në bazë të VKM-së nr.277 datë 18.06.1997 “*Për përfitimet nga Statusi i të Verbërve*”, i ndryshuar. U është dhënë pagesa vetëm për 9 muaj ndjekje të kursit të kualifikimit, niveli i parë dhe nuk po vijonte pagesa edhe për ndjekjen e nivelit të dytë të këtij kursi.

Pavarësisht paraqitjes së vërtetimit për ndjekjen e nivelit të dytë, kanë marrë përgjigje verbale se nuk i jepet dyfishi i pagesës, pasi po ndjekin dy kurse.

Pas shqyrtimit të këtij rasti, konstatojmë se mosdhënia e plotë e pagesës për shkak të verbërisë, binte në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.277 datë 18.07.1997 “*Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit*”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.2365 datë 26.1.2008 për zbatimin e këtij vendimi, të cilat nuk ia kufizojnë të drejtën e ndjekjes së kursit të kualifikimit deri në 9 muaj personave që përfitojnë statusin e të verbërit.

Duke qenë se nuk ishin zbatuar drejtë aktet nënligjore që dalin në zbatim të Ligjit nr.8098 datë 28.03.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*”, iu drejtuam me rekomandim Njësisë Administrative përkatëse për dhënien e dyfishit të pagesës për shkak të verbërisë, për një periudhë 9-mujore deri në mbarim të nivelit të dytë të kursit. Rekomandimi u pranua dhe pagesa u krye në masën 200% që nga lindja e së drejtës.

- ✓ Për mosdhënien e shtesës mujore në pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, një muaj pas daljes në Komisionin e Vlerësimit të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) për ata invalidë pune, të cilët e dorëzojnë Vërtetimin Tip “*Për invaliditet të plotë nga sëmundje të përgjithshme*”, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore pas afatit të përcaktuar ligjor. Me anë të këtij vërtetimi, vërtetohet fakti se personi është përfitues i pensionit të invaliditetit për një afat të caktuar dhe përfiton pagesën, si përfitim paaftësie sipas grupit të invaliditetit

Me këtë vërtetim ata nuk pajisen në momentin e dhënies së vendimit të përfitimit të grupit të invaliditetit, por pas verifikimit të vjetërsisë së punës, ku në 5-vjeçarin e fundit të lindjes së të drejtës, të kenë 12 muaj sigurim. Në këto kushte pajisja me Vërtetimin Tip mund të jepet edhe pas dy e tre muajve pas daljes në KMCAP nga ana e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Kjo praktikë pune krijon premisën për shkelje të së drejtës për përfitim sipas afatit të përcaktuar ligjor. Në këto kushte invalidët e punës nuk e përfitojnë shtesën në masën e pensionit të invaliditetit një muaj pas daljes në komision, por një muaj pas depozitimit të Vërtetimit Tip.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të tyre ligjshme, pasi bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 869 datë 18,06,2008 “*Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”*” dhe Udhëzimit nr.1406 datë 30.07.2008 “*Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 869 datë 18,06,2008 “Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”*”, kjo pagesë duhet të fillojë një muaj pas daljes në komision. Në këto kushte, janë dërguar rekomandimet përkatëse Administratorëve të Njësisë Administrative për marrjen e masave për dhënien e menjëhershme të shtesës mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie që nga lindja e së drejtës. Pavarësisht mos marrjes në konsideratë të rekomandimeve, institucioni i Avokatit i Popullit e do të vijojë me ndërhyrje të mëtejshme për këtë çështje.

Në raportin vjetor 2016, kemi informuar se me qëllim marrjen e shërbimeve dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore, Avokati i Popullit, në muajin Korrik 2016, u është drejtuar me rekomandim 61 Kryetarëve të Bashkisë *për marrjen e masave për realizimin e përshtatshmërisë së ambjentëve publike*.

Gjatë vitit 2017 ka vijuar kthimi i përgjigjeve nga Kryetarët e Bashkive, të cilët shprehen se janë angazhuar për zbatimin e rekomandimeve, duke marrë masat e nevojshme për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme, me qëllim eliminimin e barrierave fizike për personat me aftësi të kufizuara.

Vazhdojnë të mbeten ende si problematika të pazgjidhura çështjet e mëposhtme:

- ✓ Mungesa e përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara.
- ✓ Mospërfitimi i kompensimit të biletave në transportin urban të personave me aftësi të kufizuara.
- ✓ Mosdhënia e të drejtës për të përfituar rimbursimin për shpenzimet në blerjen e karburantit dhe vajit lubrifikant për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë.
- ✓ Mungesa e aksesit në transportin urban publik dhe mosrimbursimin e biletës.
- ✓ Moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin.
- ✓ Mungesa e statistikave për personat me sëmundje të rënda mendore.
- ✓ Mosngritja e qendrave rehabilituese rezidenciale për personat me sëmundje të rënda mendore.
- ✓ Aksesit i personave me aftësi të kufizuara në drejtësi, në strukturat qeveritare në nivel qendror dhe lokal, media dhe biznes.
- ✓ Mungesa e statistikave për personat me sëmundje të rënda mendore.
- ✓ Qendrat e votimit (kopshte, çerdhe dhe shkolla) nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

### 3.4. Barazia gjinore dhe të drejtat e personave LGB

Një nga temat e përfshira në Konferencën vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2017, ka qenë realizimi i barazisë gjinore thelbësore në përputhje me dispozitat e Konventës së CEDAË, gjatë gjithë procesit të zbatimit të Axfordës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara në institucionin e Avokatit të Popullit (ankesa, kërkesa, njoftime, inspektime dhe raste me iniciativë), për vitin 2017 rezultoi një numër i konsiderueshëm grash kryefamiljare, të papuna apo dhe të pastreha. Objekti i tyre është i shumëllojtë, duke përfshirë qoftë ato të ankesë/kërkesave me karakter social e ekonomik, ashtu dhe për marrëdhënie pune, ndihme ekonomike, aksesin në drejtësi, probleme të mosekzekutimit të detyrimeve ushqimore të vendosura në vendimet e gjykatave etj.

Ndihma aktuale ekonomike është e pamjaftueshme për të adresuar nevojat e grave kryefamiljare, grave romë apo atyre nga grupe të tjera vulnerabël, si viktimat e dhunës në familje apo viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Mungesa e shpalljes së minimumit jetik mbetet një pengesë shumë e madhe, në përcaktimin e politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë, përfshirë këtu edhe gratë.

Programi i ndihmës ekonomike ka si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tyre. Pra, ajo përcaktohet si ndihmë për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, të cilëve u mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht ose i kanë ato të pamjaftueshme.

Sistemi i ndihmës ekonomike mund të sigurojë të ardhurat e nevojshme për të varfërit, por ai nuk i ndihmon ata që të shpëtojnë nga varfëria. Shumë familje shqiptare jetojnë me pagesat e ndihmës ekonomike, duke mos patur asnjë të ardhur tjetër në familje. Për shumë prej tyre, ndihma ekonomike apo pagesat e paaftësisë janë i vetmi burim jetese dhe për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara fizike, psikologjike e shoqërore, ata nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike.

Avokati i Popullit vlerëson se Mekanizmat e Koordinimit dhe Referimit të rasteve të **dhunës në familje** në bashkitë e vendit duhen forcuar dhe mbështetur. Në nivel vendor mungojnë shërbime të tilla si akomodimi, linja telefonike 24 orëshe, programe rehabilitimi, etj., duke vështirësuar përmbushjen e përgjegjësive nga anëtarët e MKR-së. Mungesa e klinikave ligjore vendore duke filluar në rang qarqesh e më pas edhe më tej, dhe ofrimit të shërbimeve prej tyre sjell efekte në aksesin e grave nga qarqe të ndryshme në sistemin e drejtësisë.

Një risi gjatë vitit raportues në lidhje me dhunën ndaj grave është bërja publike nga Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), të raportit të vlerësimit në kuadër të monitorimit të zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”, ku Shqipëria është palë.

Ky raport jep një vlerësim të masave për zbatim të marra nga autoritetet shqiptare në lidhje me të gjitha aspektet e Konventës, si dhe ka identifikuar disa fusha shtesë ku nevojiten përmirësime me qëllim përmbushjen e plotë të detyrimeve të Konventës. Ndër të tjera, këto lidhen me përkufizimin ligjor të dhunës në familje; alokimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për makinerinë për luftën kundër dhunës ndaj grave si në rang bashkiak, ashtu edhe në qendror;



përgatitjen e kategorive të të dhënave administrative që pasqyrojnë llojin e marrëdhënies midis viktimës dhe dhunuesit për të gjitha format e dhunës ndaj grave; organizimin e sondazheve që masin mbizotërimin e formave të dhunës ndaj grave, të pavlerësuara më parë, veçanërisht në lidhje me ngacmimin seksual, dhunën seksuale dhe martesën e detyruar; përfshirjen e temës së dhunës ndaj grave në kurrikulat profesionale, programet e studimeve universitare dhe skemat e zhvillimit profesional; rritje të financimit për strehët dhe shërbimet sociale; aksesin në kompensim për viktimën; mbrojtja për të parandaluar martesat e detyruara të fëmijëve dhe masat mbrojtëse për viktimat, përfshirë fëmijët, gjatë seancave gjyqësore.

Megjithëse, është një nga objektivat sociale të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, **strehimi** përbën një nga çështjet më të mprehta me të cilën përballen gratë, në mënyrë të veçantë gratë në nevojë. Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit të njësive të pushtetit vendor mbi buxhetimin e prioritetëve gjinore. Bashkitë duhet të parashikojnë dhe aplikojnë për fonde me qëllim mbështetjen për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje, strehëzave të posaçme, shërbimeve psiko-sociale dhe ligjore për viktimat, programeve rehabilituese për dhunuesit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Tashmë, janë identifikuar prioritetet institucionale dhe në bashkëpunim dhe me organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, do të mundësohet trajnimi i forcimit të kapaciteteve për një monitorim efektiv të të drejtave njerëzore të grave (Gratë e Dhunuara; Trafikuara; Rome, me Aftësi të kufizuar; Gratë Azilkerkuese; Gratë e Ngujuara; Gratë e Moshës së tretë, Gratë e papuna, etj).

Zbatimi i Agjendës 2030 “Të mos lëmë askënd prapa”, kërkon gjithëpërfshirjen dhe partneritetin e aktorëve të rëndësishëm në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal, duke përfshirë në radhë të parë grupet në nevojë - gratë dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, si dhe Kuvendin, autoritetet qendrore dhe lokale, sektorin privat, institucionet akademike, organizatat e shoqërisë civile e më gjerë.

### *Monitorimi i Qendrave Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut/Dhunës*

Gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit ka mundësuar monitorimin dhe inspektimin e qendrave kombëtare pritëse për viktimat e trafikut/dhunës, si më poshtë:

- ✓ Inspektimi i Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut në Linzë e cila strehon personat e identifikuar në bazë të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit, i cili u realizua me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të strehuar në të.

Nga inspektimi rezultoi që përgjithësisht kishte gjetur zbatim rekomandimi i institucionit të Avokatit të Popullit, të vitit 2016, për rikonstruksionin e sistemit qendror të ngrohjes, ndërkohë u rekomandua: marrja e masave për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, për të parashikuar detyrat funksionale të këtij institucioni, shërbimet që ofrohen në të, si edhe përcaktimin e përfitueseve sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit; marrja e masave për sigurimin e fondeve për përfundimin e punimeve dhe rikonstruksionin e plotë të godinës së dytë dhe të disa ambienteve të brendshme të godinës së parë, si kuzhina, mensa, etj; marrja e masave

për punësimin me kohë të plotë të juristit dhe psikologut; marrja e masave për pajisjen me librezë shëndetësore dhe vënien në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjitha përfitueset e kësaj qendre.

- ✓ Inspektimi i Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje në Kamëz, në përfundim të të cilit iu rekomandua Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, marrja e masave për: shtimin e organikës me disa pozicione pune (psikolog, jurist, punonjës social me kohë të plotë); ndërmarrjen e iniciativës ligjore për ndryshimin e aktit normativ në të cilin parashikohet kuota ushqimore me qëllim indeksimin e kuotës ditore ushqimore, si pasojë e rritjes në vite të çmimeve të ushqimeve; sigurimin e fondeve financiare të nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës (instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore, blerjen e raftëve, dollapëve, blerjen dhe instalimin e kamerave të sigurisë, etj; vendosjen sa më shpejtë të regjistrimit të administrimit të ankesave dhe kërkesave të bëra nga përfituesit e kësaj qendre.

Nga përgjigjja e ardhur konstatohet se rekomandimet janë pranuar në parim dhe disa prej tyre janë zbatuar, ndërsa për të tjerat që lidhen me fonde financiare janë bërë kërkesa pranë institucioneve përkatëse.

- ✓ Inspektimi i Qendrës Psiko-Sociale “Vatra” në Vlorë, në përfundim të të cilit iu rekomandua Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror si dhe Qendrës Psiko-Sociale Vatra, marrja e masave për: ndryshimin e Udhëzimit të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 5, datë 01.08.2012 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”, me qëllim rritjen e kuotës ditore ushqimore, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të ushqimeve në vite; ndryshimin e Vendimit nr. 114, datë 31.1.2007 “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar, për të mundësuar trajtim të barabartë për përfitimin e kuotës 3000 (tre mijë) lekë në muaj për viktimat e trafikimit, viktimat e mundshme apo viktimat e dhunës të Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”, duke e unifikuar përfitimin i cili aktualisht aplikohet vetëm për subjektet publike të Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit në Linzë.

### *Të drejtat e Komunitetit LGBTI*

Të drejtat e personave LGBTI konsiderohen si pjesë e pandashme e tërësisë së të drejtave të njeriut, dhe për këtë institucioni ynë është shprehur qartë se nuk duhet të ketë pengesa ligjore për personat e komunitetit LGBTI në realizimin e të drejtave, të cilat gëzohen nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Për sa i përket të dhënave statistikore në lidhje me ankesat drejtuar Avokatit të Popullit për probleme që lidhen me komunitetin LGBTI, për vitin 2017 ka patur vetëm dy ankesa, me objekt mosmarrje të Shërbimit mjekësor (nga mjekët e spitalit ushtarak, si dhe stafit mjekësor të Qendrës Universitare “Nënë Tereza” Tiranë), ankesa të cilat pas hetimit administrativ nga ana jonë, kanë rezultuar të pabazuara.

Meqenëse personat që i përkasin komunitetit LGBTI mund të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, nevojiten masa me specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut për

këtë kategori personash. Këto të drejta fillojnë që nga e drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna, liria e shprehjes, punësimi, shëndeti, strehimi, mosdiskriminimi, etj. Në këtë kontekst pavarësisht se Avokati i Popullit ka luajtur rol proaktive në drejtim të promovimit dhe mbështetjes publike të të drejtave të këtij komunitetit, ka rritur nivelin e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse, përsëri mbetet mjaft shumë punë për tu bërë. Pas rekomandimeve dhe raporteve të veçanta nga Institucioni i Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve të administratës publike në nivel qendror, në Mars të vitit 2016 është miratuar nga Këshilli i Ministrave Plani i Ri Kombëtar i Veprimit për përmirësimin e cilësisë së jetës për personave LGBTI në Shqipëri. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka vlerësuar që Shqipëria po i përshtatet gjithmonë e më shumë standarteve ndërkombëtare në aspektin ligjor dhe normative, është e rëndësishme që këto arritje të mos ngelen vetëm në letër, por të ketë një angazhim serioz nga ana e institucioneve publike dhe e qeverisë sidomos në lidhje me zbatimin efektiv të Planit të Veprimit.

Avokati i Popullit, nisur nga bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë objket të pënjës së tyre mbrojtjen e të drejtave të Komunitetit LGBTI dhe konstaton se kemi sensibilizim të opinionit, sidomos në qendrat më të mëdha urbane, për të pranuar orientimin seksual të ndryshëm e rrjedhimisht për të pranuar dhe respektuar të drejtat e këtij komuniteti. Ky konstatim u vu re më së miri në paradën sensibilizuese të 13 Majit 2017, e cila u organizua gati në të njëjtën kohë dhe vend me mitingun me mijra pjesmarrës të opozitës dhe nuk pati asnjë problematikë për t'u shënuar.

Organizatat e shoqërisë civile luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTI. Vlen të theksohet këtu se këto organizata janë iniciuar nga vet ky komunitet dhe si rrjedhim, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komunitetit ka qenë shumë efikase.

Sot në Shqipëri problematika më themelore e komunitetit LGBTI është njohja e identitetit gjinor. Duke mos u parashikuar me ligj identiteti i ndryshuar i tyre, mos njohja e bashkëjetesës dhe e martesës, shkakton mos vijueshmëri të jetës normale të tyre, pavarësisht rekomandimeve të nisura nga Avokati i Popullit për njohjen e këtyre të drejtave dy Ministrave të Linjës në vitin 2016, nga të cilat vetëm nga Ministria e Drejtësisë kemi patur reagim pozitiv. Kemi kërkuar edhe gjatë vitit 2017 për të patur reagime, por ende nuk kemi inisiativa konkrete të qeverisë për njohjen e këtyre të drejtave. Nisur nga mos njohja e këtyre të drejtave, për zgjidhjen e tyre gjatë vitit 2017 institucioni i Avokatit të Popullit e ka përcjell këtë shqetësim edhe në Këshillin e Evropës.

Avokati i Popullit gjykon se, askush nuk ka të drejtë të abuzojë me këto të drejta, sikundër çdokush ka të drejtë të shprehë identitetin e tij dhe të denoncojë praktikën kundër të drejtave të personave që duan të jenë hetero.

### **3.5. Të drejtat e të moshuarve**

Institucioni i Avokatit të Popullit duke i trajtuar në vite problemet e moshës së tretë me objektivitet, gjykon se duhet pranuar dhe kuptuar fakti se situata e të moshuarve në Shqipëri nuk është e mirë. Ato përbëjnë një ndër grupimet më të mëdha numerike të shtresave dhe grupeve në nevojë.

Për të garantuar dhe forcuar të drejtat e të moshuarve kemi kërkuar prej vitësh miratimin e projekt-ligjit “Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimit të nevojave për moshën e tretë”.

Në mbrojtje të të drejtave të moshuarve, kemi kryer inspektime në Shtëpitë e të Moshuarve Tiranë,

Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Kavajë dhe në Qendrën Polivalente Poliçan. Pas inspektimeve të kryera, u kemi dërguar rekomandime Kryetarëve të Bashkive, Shërbimit Social Shtetëror për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre dhe për zbatimin sa më cilësor të standardeve të përkujdesit social për këtë kategori.

Në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2017, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme që personat e moshuar, të cilët strehohen në qendrat rezidenciale, u jemi drejtuar drejtuesve të Shtëpive të të Moshuarve Tiranë, Kavajë, Shkodër, Fier dhe Gjirokastrë për masat e marra për t'u mundësuar këtyre personave që të ushtrojnë në mënyrë të plotë dhe të qetë të drejtën e votës. Në përgjigje të kërkesave tona, jemi informuar se të gjithë të moshuarit janë pajisur me dokumenta identifikimi dhe janë marrë të gjitha masat që ata të ushtrojnë të drejtën e votës.

### 3.6. Të drejtat e minoriteteve

Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve ka vazhduar të jetë një nga prioritetet e punës së institucionit të Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2017. Krahas trajtimit të ankesave të paraqitura nga pjestarë të këtyre minoriteteve dhe që lidhen kryesisht me respektimin e të drejtave të tyre individuale, qasja jonë proaktive ka marrë përparësi me investigimet e kryera “ex-officio”.

Duke risjellë edhe një herë në vëmendje rekomandimin e Avokatit të Popullit, drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, në fund të vitit 2013, mbi nevojën e plotësimit të kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e minoriteteve në vendin tonë, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, konstatojmë se tashmë ky rekomandim jo vetëm është pranuar, por edhe është zbatuar. Ky zbatim është konkretizuar me miratimin e Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol aktiv gjatë gjithë procesit të draftimit të projektligjit, duke dhënë vërejtje dhe sugjerime, të cilat janë pasqyruar në një masë të mirë të tyre, në përmbajtjen e dispozitave të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ndër komentet dhe sugjerimet, që kemi dhënë gjatë procesit të sipërcituar do të veçonim:

**Së pari**, para miratimit të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në Shqipëri njiheshin zyrtarisht dy lloje minoritetesh (pakica), *minoritetet etnike kombëtare*, ku përfshihej minoriteti Grek, minoriteti Maqedon dhe minoriteti Serbo-Malazet, si dhe *minoritetet etno gjuhësore*, ku përfshiheshin minoriteti Vllah dhe minoriteti Rom. Pavarësisht kësaj, realiteti i shoqërisë shqiptare njihte “de facto” edhe disa komunitete të tjera, të ndryshme nga popullsia etnike shqiptare, siç edhe komuniteti Boshnjak, komuniteti Egjiptian etj.

Në fakt, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 20 të saj, shprehet vetëm për personat që u përkasin pakicave kombëtare gjë që krijonte edhe një debat, në lidhje me njohjen e zgjeruar nga ana e shtetit të kategorisë së minoriteteve etno gjuhësore. Në këtë kontekst, njehsimi dhe njohja zyrtare në projektligj si “pakica kombëtare”, i të gjithë pakicave të njohura zyrtarisht (deri para miratimit të Ligjit nr.96/2017), vendos në një linjë logjike statusin e këtyre pakicave në vend, sikurse krijon përputhshmërinë me termat kushtetues. Po kështu zgjerimi i numrit të pakicave kombëtare, siç parashikohet në nenin 3/2 të ligjit, ka sjellë një zhvillim tjetër rregullator pozitiv duke bërë që komunitete të tjera, historike në vend të marrin statusin e “Pakicës kombëtare”.

**Së dyti**, kemi rekomanduar nevojën e realizimit të inisiativës legislative për miratimin e një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, të ratifikuar me ligjin nr.8496 datë 3.06.1999. Në nenin 3/1, të Ligjit nr.96/2017, jepet tashmë një përkufizim për pakicat kombëtare, duke ezuaruar edhe këtë çështje delikate.

**Së treti**, ndër çështjet e tjera që kemi ngritur më herët për diskutim ka qënë edhe çështja se, si do të mund të njihej “de jure” një komunitet ekzistues, si pakicë kombëtare në Shqipëri? Efektivisht përcaktimet e dhëna në nenin 4, si dhe nenet 6 dhe 7, të ligjit nr.96/2017, vendosin një bazë konkrete (gjithsesi të nevojshme për t’u detajuar më tej me akte të tjera normuese), për njohjen formale të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë.

**Së katërti**, sipas nenit 3/2, të ligjit nr.96/2017, do të njihen zyrtarisht në Shqipëri këto pakica kombëtare; pakicat greke, pakicat maqedonase, vllahë/arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake dhe serbe.

Duke u ndalur në këtë moment duam të sjellim në vëmendje faktin se, një ndër raportet e posaçme që Avokati i Popullit ka depozituar pranë Kuvendit, që në muajt e parë të vitit 2015 (ende i padiskutuar) është Raporti i Veçantë, “Mbi të drejtat e minoriteteve në vend”.

Disa nga çështjet e trajtuara në këtë raport vazhdojnë të mbeten aktuale dhe ato kanë të bëjnë me:

- ✓ *Përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus disa përmirësime në nenin 1, të ligjit nr.10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.*
- ✓ *Fillimin dhe përfundimin e procesit, për ratifikimin e Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale, ose Minoritare.*
- ✓ *Zhvillimin e një censusi të ri të popullsisë, mbi bazën e kriterëve dhe standarëve më të mira ndërkombëtare, ku minoritetet do të gjenin veten për t’u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre.*

Duke u ndalur konkretisht tek censusi, mendojmë se ky zhvillim do të vinte në “ndihmë” edhe të implementimit real të disa dispozitave të Ligjit nr.96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Kjo gjë është kuptueshme po t’i referohemi përcaktimeve të dhëna në nenin 13 dhe nenin 15, të Ligjit nr.96/2017, ku gëzimi dhe realizimi i disa të drejtave, lidhet me terma të tillë si, “numri thelbësor dhe kërkesë e mjaftueshme”, si dhe “...mbi 20 % e numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj bashkie”.

Nga ana tjetër edhe dispozitat e ligjit krijojnë një lloj konfuzioni në këtë pikë pasi, shprehen për të drejtën e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, për mbledhjen e të dhënave në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare (neni 7/1). Cila do të jetë baza e mbledhjes së këtyre të dhënave censusi i vitit 2011, i cili nuk është pranuar dhe kontestuar nga organizatat që përfaqësojnë minoritetet apo “mincensuse” rajonale që do të zhvillohen rast pas rasti? Gjykojmë se, këto përcaktime të ligjit nr.96/2017, do të hasin vështirësi në implementim për arsye të cituara më sipër.

*Së pesti*, dispozitat e Ligjit nr.96/2017, parashikojnë ndër të tjera edhe ruajtjen e identitetit gjuhësor (neni 12), të drejtën e arsimit në gjuhën e pakicës (neni 13), të drejtën e shprehjes së opinionëve dhe të marrjes dhe shpërndarjes së informacioneve në gjuhën e pakicave (neni 14), si dhe përdorimin e gjuhës së pakicës në disa aspekte të jetës së përditëshme vetjake dhe komunitare, të pjestarëve të pakicave kombëtare, përfshirë këtu edhe kontaktin dhe komunikimin me institucionet shtetërore.

Ky është një zhvillim shumë pozitiv, por që do të njohë sërish vështirësinë e zbatimit në rastin e pakicës kombëtare egjiptiane. Kjo pasi, komuniteti egjiptian sot në Shqipëri nuk ka një gjuhë të vetën sikurse, ndodh me minoritetet e tjera në vend. Fakti është se, kudo ku ky komunitet është vendur në të gjithë rajonin e Ballkanit, flet gjuhën e vendit pritës.

Një tjetër çështje që është konstatuar në këtë kontekst është fakti se, ndarja e re territoriale administrative ka krijuar problematikë, përse i takon pranis reale të popullsisë së ndryshme nga ajo në mazhorancë, të vendosur në zona të caktuara të vendit. Sipas kësaj ndarjeje, në raste specifike rezulton se kufiri i ri territorial administrativ ndan në dy pjesë të veçanta komunitete, që i përkasin të njëjtut minoritet, por që pas kësaj nuk i përkasin më së njëjtës njësi territoriale administrative.

Kjo gjendje faktike tashmë, gjykojmë se do të krijojë probleme me zbatimin e dispozitave të ligjit, ku sanksionohet gëzimi dhe realizimi i disa të drejtave, të lidhura paraprakisht me plotësimin e termave “numri thelbësor dhe kërkesë e mjaftueshme”, si dhe “mbi 20 % e numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj bashkie”.

Aktualisht ky kuadër ligjor është e nevojshme që të plotësohet me aktet nënligjore, që do të detajojnë zbatimin e tij. Për këtë qëllim ka filluar procesi i hartimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.96/2017 "Për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", nga ana e një grupi ndër-institucional pune, ku marrin pjesë institucione shtetërore përgjegjëse, shoqata të pakicave kombëtare, shoqëria civile, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe institucione të pavarura shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me statusin e vëzhguesit. Avokati i Popullit, sikurse gjatë procesit të draftimit dhe miratimit të Ligjit nr.96/2017 "Për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", do të luajë një rol aktiv edhe në këtë proces.

Vizioni i Avokatit të Popullit bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit.

## **KREU 4**

### **Roli proaktiv i Avokatit të Popullit në respektimin e të drejtave të njeriut**

#### **4.1. Shërbimet ndaj qytetarëve**

Institucioni i Avokatit të Popullit funksionon me zyrën e pritjes dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve jo vetëm në Tiranë por përfaqësohet me zyra rajonale në shtatë prej qendrave më të mëdha administrative nga veriu në jug të vendit dhe konkretisht në bashkitë Shkodër, Kukës, Berat, Fier, Pogradec, Sarandë dhe Dropull.

Zyrat rajonale janë pjesë e vizionit të Institucionit të Avokatit të Popullit që ka në fokus mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve përmes kultivimit të një kulture të re dhe standardeve më të larta në ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe në rritjen e aksesit të qytetarëve për të adresuar në kohë ankesat e tyre ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike, pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë vitit 2017, zyrat rajonale kanë vijuar të forcojnë një prani të vlerësueshme të institucionit të Avokatit të Popullit më afër qytetarëve në këto rajone, nëpërmjet një pune të vazhdueshme të përfaqësuesve në terren, duke u mundësuar qytetarëve informacione të nevojshme mbi rolin dhe funksionin e institucionit të Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave dhe dërgimin në kohë për shqyrtim nga ekspertët sipas seksioneve, si dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda një kohe të shkurtër dhe optimale.

Fushatat promovuese dhe puna në terren e përfaqësuesve rajonalë kanë qenë pjesë të rëndësishme të aktivitetit të përditshëm të punës së tyre, duke synuar në vazhdim rritjen dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek Avokati i Popullit jo vetëm si një objektiv për t'u arritur por edhe si sodisfaksion dhe përgjegjësi. Puna në terren është bazuar në një planifikim paraprak të gjithësecilit, nëpërmjet hartimit dhe realizimit të plotë të planeve mujore duke evidentuar aktivitetin dhe problematikat e hasura me relacione konkrete dhe fotografi.

Në vijim të punës në terren, përfaqësuesit rajonalë, bazuar në nenin 17/1 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" janë orientuar të marrin pjesë në mbledhjet e Keshillit Bashkiak që janë të hapura për publikun, të njihen nga afër me problemet që ngrihen, qasjet dhe vendimarrjet e Keshillit Bashkiak në dobi të qytetarëve, me qëllim që të informojnë qytetarët që jo gjithmonë e kanë këtë informacion si dhe të promovojnë të drejtën e qytetarëve në vendimarrjen lokale.

Rrjeti i zyrave rajonale online ka vijuar të jetë në funksion të përmirësimit të cilësisë së performancës së gjithësecilit, duke e konsideruar komunikimin në grup si mjet thelbësor të efektivitetit, që inkurajon bashkëpunimin, kreativitetin dhe ndihmon në garantimin e angazhimit të gjithësecilit përfaqësues për të marrë rezultatin e duhur dhe arritur objektivat e synuar.

Në Janar 2017, vendi ynë u përfshi nga një situatë emergjente civile, për shkak të temperaturave shumë të ulëta. Zyrat rajonale kanë qëndruar hapur në monitorim të situatës dhe në ndihmë të qytetarëve, bazuar në urdhërin e brendshëm të institucionit për këtë rast, por edhe me përgjegjësinë morale dhe qytetare të vetë përfaqësuesve tanë.

Ndërhyrja e përfaqësuesve të zyrave rajonale (siç është sidomos rasti i përfaqësuesit të zyrës së Kukësit), ka mundësuar trajtimin nga autoritetet përkatëse të rasteve emergjente që lidheshin me persona endacake që rrezikonin dhe jetën për shkak të kushteve të vështira atmosferike.

Gjatë këtij viti ka vijuar puna për rritjen e kapaciteteve të punonjesve të zyrave të pritjes në Tiranë dhe atyre rajonale. Këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen profesionale, rritjen e performancës, përmirësimin e etikës dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, në forcimin e një komunikimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me qytetarët, për t’ju përgjigjur interesimit të tyre rreth objektit të ankesave dhe rrugët që duhet të ndjekin për zgjidhjen e të drejtës të pretenduar prej tyre.

Zyrat rajonale të Avokatit të Popullit kanë treguar të jenë shumë efektive dhe në plotësim të pritshmërive të Institucionit të Avokatit të Popullit, referuar promovimit të këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriu në gjithë hapësirat gjeografike ku këto zyra operojnë.

Një indikator matës që tregon efektivitetin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit si dhe për rrjedhojë edhe rritjen e besimit të qytetarëve tek këto zyra është numri i ankesave gjithmonë në rritje që në fund të vitit 2017 rezultoi të *përbëjë rreth 42% të të gjithë totalit të ankesave të depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit këtë vit.*

Referuar objektit të ankesave brenda juridiksionit/kompetencës së Avokatit të Popullit të ardhura nga zyrat rajonale, për të cilat ankohen qytetarët më së shumti në këto zona, të pranuar dhe trajtuara nga specialistët e fushave përkatëse të Institucionit të Avokatit të Popullit, do të veçonim: probleme në pajisjen me çertifikata pronësie nga zyrat e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme; zvarritje të procedurave të legalizimit nga ALUIZNI; mbifaturimi i energjisë elektrike nga OSHEE; mosfurnizimi me ujë të pijshëm; mosdhënie/zvarritje e kompensimit financiar për dëmtimet nga fatkeqësitë natyrore; shërbimet e munguara nga pushteti vendor.

Ndër objekte të njëjta të ankesave jashtë juridiksionit/kompetencës të Avokatit të Popullit për të cilat përfaqësuesit e zyrave rajonale kanë mundësuar për qytetarët këshillimin ligjor dhe orientimin mbi rrugët që duhet të ndjekin për të kërkuar zgjidhjen e problemeve të tyre, do të veçonim: ankesat mbi çështje pronësie; kërkesa për punësim; kërkesa për strehim; mostrajtim me ndihmë ekonomike; ankesa ndaj sigurimeve shoqërore dhe KMCAP; si dhe çështje në proces gjyqësor.


Për gjithë periudhën e vitit 2017, në zyrën e pritjes së qytetarëve, zyrat rajonale dhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit, atij postar dhe on-line, janë paraqitur **4546** ankesa pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat 1752 ankesa kanë qenë pjesë e objektit të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe janë cilësuar “brenda juridiksionit dhe kompetencës“ dhe 2794 ankesa janë trajtuar në formën e “këshillimeve dhe orientimeve”, mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të ankesave dhe institucionet që duhet t’u drejtohen.

Gjendja e përgjithshme e ankesave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017 paraqitet si më poshtë:

<b>ANKESAT 2017</b>		<b>Në shifra</b>	<b>Në përqindje</b>
1	Ankesa pranë Zyrës së Pritjes së Popullit	881	19.38 %
2	Ankesa nga Zyrat Rajonale	1918	42.20 %
3	Ankesa në rrugë postare	1026	22.57 %



4	Ankesa on-line ( <i>portal, e-mail, rrjete sociale</i> )	432	9.50 %
5	Ankesa me telefon ( <i>fix, mobile, numri jeshil</i> )	279	6.13 %
6	Ankesa nga “Ditët e Hapura”	10	0.22 %
<b>TOTAL</b>		<b>4546</b>	<b>100%</b>



Rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin dhe rritjen e cilësisë së punës së stafit të institucionit, ka luajtur Zyra e Pritjes dhe Shërbimeve ndaj Qytetarëve. Nisur nga përmbajtja e ankesave të prezantuara nga qytetarët të cilat nuk janë objekt i punës të Avokatit të Popullit, specialistët u kanë ofruar qytetarëve këshillimin ligjor mbi rrugët që duhet të ndjekin për rivendosjen e së drejtës së pretenduar prej tyre.

Krahas detyrës për pritjen e qytetarëve dhe dhënien e informacionit të nevojshëm mbi procedurat e marrjes së ankesave, Zyra e Pritjes dhe Shërbimeve ndaj Qytetarëve ka shërbyer dhe si një “filtër” për ndarjen e ankesave me objekt “brenda juridiksionit dhe kompetencës” dhe në “këshillime dhe orientime”, mbi bazën e kërkesave të ligjit për “Avokatin e Popullit”.

Numrin më të madh të ankesave të vlerësuara jashtë objektit të punës së Avokatit të Popullit, e dhe gjatë vitit 2017, e përbëjnë ankesat e qytetarëve që kundërshtojnë vendimet e formës së prerë të gjykatave si dhe vendimet e prokurorive për pushim të çështjeve të caktuara. Këtyre ankuesve u është dhënë këshilla ligjore për të ndjekur shkallët e ankimimit sipas shkallëve të sistemit gjyqësor.

Gjithashtu, në lidhje me ankesat me objekt kundërshtimin e vendimeve për pushim të çështjeve në prokuroritë e rretheve gjyqësore, qytetarët janë këshilluar t’u drejtohen me ankesë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Mbetet i lartë numri i ankesave në lidhje me proceset gjyqësore ose kërkesat individuale për këshillim për çështje juridike të natyrës penale dhe/ose civile, që nuk janë në kompetencën tonë.

Konflikti brenda familjes mbetet shqetësues për shoqërinë dhe shtetin shqiptar. Në rastet e këtyre ankesave, qytetarët janë këshilluar dhe orientuar të parandalojnë ngjarjet e rënda duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e policisë dhe të prokurorisë dhe në rastet e konstatimit të vonësive dhe zvarritjeve nga ana e këtyre organeve, t'i drejtohen menjëherë Avokatit të Popullit për të ushtruar të drejtën e tij kushtetuese dhe ligjore.

Në lidhje me ankesat për mbrojtjen e fëmijëve dhe të grave nga dhuna e ushtruar nga persona brenda dhe jashtë familjes, personat e ankuar janë këshilluar t'i drejtohen organeve të policisë dhe më tej gjykatës për t'u pajisur me urdhëra mbrojtje sipas ligjit.

Një grup i konsiderueshëm qytetarësh janë drejtuar tek Avokati i Popullit me ankesa që kanë objekte të ndryshme si, probleme punësimi, strehimi, çështje pronësie, ndërprerje apo mospërfitim të ndihmës ekonomike, kundërshtim të vendimeve të KMCAP-it rajonal dhe qëndror në lidhje me pagesat e aftësisë së kufizuar etj, për të cilat qytetarët janë këshilluar t'u drejtohen institucioneve përkatëse ligjzbatuese, apo tu drejtohen e dhe gjykatave në rastet kur e përmban dhe ligji.

## **4.2. Ndryshimet legjislative**

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2017, ka ndjekur me vëmendje ndryshimet legjislative në vend, duke dhënë komente dhe sugjerimet për draft- ligje të ndryshme sa herë është kërkuar nga institucionet ligjvënëse ashtu si dhe me iniciativë të vetë institucionit.

Gjatë vitit raportues, janë dhënë mendime dhe sugjerime për aktet e mëposhtme:

### **• Projekt-ligji “Për ndihmën juridike falas”**

Nisur dhe nga rekomandimet e paraqitura nga Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), ku ndërmyjet të tjerash rekomandohej që “autoritetet shqiptare të sigurojnë akses efektiv në drejtësi për viktimat e diskriminimit nëpërmjet një sistemi të ndihmës ligjore që është funksional dhe plotësisht i financuar”, institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të diskutimeve të këtij projekt-ligji, rekomandoi disa ndryshime që lidheshin kryesisht me:

- a. Zgjerimin e kriterëve dhe rrethit të personave përfitues (kategoritë në nevojë), me qëllim sigurimin dhe garantimin e një aksesit të shpejtë, të drejtë dhe të rregullt në drejtësi si dhe për të garantuar shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut në Republikën e Shqipërisë;
- b. Rritjen e buxhetit për shërbimin e ndihmës juridike.

Këto rekomandime u morën në konsideratë gjatë diskutimit dhe miratimit të këtij projekt-ligji.

### **• Projekt-ligji “Për tarifat gjyqësore”**

Në lidhje me këtë projekt-ligj, jo vetëm gjatë procesit të hartimit të tij, por edhe pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë dhe dërgimit të tij për dekretim nga Presidenti i Republikës, në konsultimet e zhvilluara me përfaqësues të presidencës dhe shoqërisë civile, institucioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur qëndrimin se tarifatat gjyqësore të përcaktuara janë tepër të larta duke pasur parasysh minimumin jetik në vendin tone dhe se në rastin konkret nga ligjvënësi nuk mbahen parasysh parimet e proporcionalitetit dhe progresivitetit. Kjo, pasi një kategori personash që i drejtohen rrugës gjyqësore janë persona me të ardhura ekonomike të ulëta, me ndihmë ekonomike, apo me asistencë sociale.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u konsultua dhe me shoqërinë civile, shprehu mendimin se ligji i duhej kthyer Kuvendin të Shqipërisë për rishikim dhe rivlerësim të tarifave gjyqësore, me synim uljen e tyre pasi ai cënon aksesin e qytetarëve për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë. Ky rekomandim nuk u mor parasysh nga Kuvendi i Shqipërisë.

### **• Projektligji “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”**

Mendimet dhe sugjerimet tona mbi përmbajtjen e projektligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i hartuar në bazë të kontributeve të anëtarëve të grupit ndër-institucional të punës të ngritur për këtë qëllim, me konsulentë të ekspertëve të Këshillit të Europës, janë dhënë në dy faza të procesit të diskutimit dhe miratimit të tij. Pra, si gjatë fazës së diskutimit të këtij projektligji në variantin e tij ekzistues, në Këshillin e Ministrave, ashtu dhe gjatë diskutimit dhe miratimit të projektligjit në Kuvendin e Shqipërisë dhe konkretisht në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Sugjerimet dhe rekomandimet e paraqitura janë trajtuar në mënyrë të detajuar në Kreun 3, pika 3.5 të këtij raporti. Kuvendi i Shqipërisë në vijim ka miratuar Ligjin nr.96/2017, datë 13.10.2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

### **• Projektligji për buxhetin e shtetit të vitit 2018**

Gjatë diskutimeve në komisionet parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2018, institucioni i Avokatit të Popullit u ftua të jepte mendime dhe opinione pranë komisioneve përkatëse parlamentare në lidhje me disa fusha të caktuara.

Pas vlerësimit të parashikimeve buxhetore, nisur dhe nga ndjekja dhe trajtimi në vazhdimësi i problematika të hasura, institucioni i Avokatit të Popullit paraqiti pranë komisioneve parlamentare disa vërejtje dhe sugjerime sa i përket rritjes apo parashikimeve të reja buxhetore e që lidheshin konkretisht me të drejtat e femijëve, zbatimin e ligjit për minoritetet, shëndetësinë, policia dhe burgjet.

### 4.3. Konferenca kombëtare

Fokusi i konferencës me shoqërinë civile, që Avokati i Popullit në bazë të ligjit të tij organik zhvillon çdo vit, në vitin 2017 ishin të drejtat e njeriut të fëmijëve, grave dhe njerëzve në lëvizje, në kontekstin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendës 2030 të OKB-së. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, trupi diplomatik, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile etj.



Sesioni i parë u hap nga Zonja Erinda Ballanca, e cila bëri një parashtrim të vizionit të saj për institucionin e Avokatit të Popullit. Ndër të tjera ajo theksoi se si drejtuese e re e Institucionit, e zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë në qershorin e vitit 2017, ajo do të bashkëpunojë gjerësisht me të gjithë aktorët dhe faktorët për përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për përmirësimin e shërbimeve të administratës ndaj qytetarëve.

Ajo vuri në dukje se institucioni do të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile, median, aktivistët e të drejtave të njeriut dhe pa asnjë dyshim edhe me komunitetin ndërkombëtar në Shqipëri e jashtë saj.

Sesioni i dytë iu kushtua të drejtave të fëmijës dhe nevojës për forcimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave. Angazhimi i Kuvendit dhe Grupit Parlamentar “Miq të Fëmijëve” në ushtrimin e funksionit të kontrollit publik ndaj veprimeve të Qeverisë, veçanërisht për promovimin e programit të saj lidhur me të drejtat e fëmijës, u konsideruan një kusht parësor për avancimin e këtyre të drejtave.

Në këtë sesion foli edhe një përfaqësuese e institucionit të Avokatit të Popullit, e cila e vuri theksin tek situata e të miturve në institucionet e kufizimit të lirisë duke kërkuar me forcë respektimin e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë dhe përdorimin sa më gjerësisht të jetë e mundur e masave alternative ndaj ndalimit të të miturve.

Përfaqësuesi i Tirana Legal Aid Society, i cili solli zërin e shoqërisë civile në këtë sesion, u ndal në nevojën për forcimin e aksesit të të miturve në drejtësi me përparësi dëgjimin e zërit të tyre sa herë është fjala për vendim-marrje apo hartimin e politikave që prekin interesat e tyre. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës ishte leitmotivi i të gjithë folësve që morën fjalën.

Sesioni i tretë, e vendosi fokusin tek barazia gjinore dhe fuqizimi i gruas. Që në krye u theksua se fuqizimi i gruas është i barabartë me fuqizimin e familjes dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Temat kryesore të trajtuara ishin: Roli i Kuvendit në çuarjen përpara të barazisë gjinore në Shqipëri dhe në integrimin e elementeve gjinore në proceset legislative; Roli i agjencive të Kombeve të Bashkuara në mbështetje të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe të procesit të monitorimit të detyrimeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

Në konferencë u bë prezantimi i përvojës së Avokatit të Popullit me rastin e Raportimit të Shqipërisë përpara Komitetit CEDAE për situatën e të drejtave të grave dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri.

U theksua ndihma e dhënë nga UN Eomen në këtë proces i cili u kurorëzua me një raport alternativ ndaj atij të qeverisë që Avokati i Popullit paraqiti përpara këtij Komiteti. Ashtu siç theksohet edhe në vërejtjet përmblylëse të këtij Komiteti, folësit vunë theksin në kundërveprimin e shoqërisë dhe institucioneve ndaj dhunës në familje dhe dhunës kundër grave.

U kërkua me force që institucionet të veprojnë në kohë dhe madje të kenë një rol pro-aktiv në parandalimin e dhunës ndaj grave, për të mos lejuar precipitimin e situatës në dëm të tyre dhe ndonjëherë edhe në dëm të jetës së nënave, bijave, motrave dhe grave.

Më tej u theksua se fuqizimi ekonomik, shoqëror dhe politik i grave duhet të jetë përparësi në punë dhe aktivitetin e çdo strukture të shtetit e shoqërisë me ç'rast u bë thirrje për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave të referimit të dhunës në çdo bashki të vendit dhe për ngritjen e grupeve multidisiplinore në mbrojtje të të drejtave të grave dhe fëmijëve.

Në një seksion më vete u trajtuan edhe çështjet e të drejtave të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Këto të drejta marrin rëndësi të veçantë në kushtet kur një numër i madh personash, ndër të cilët gra, fëmijë, të moshuar e të sëmurë, largohen nga vendet e tyre për shkak të luftës apo shkaqe të tjera. Shqipëria, si dhe shumë vende të rajonit, është përballur me një fluks të personave që lenë vendet e tyre.

Theksi u vu në detyrimin e shtetit shqiptar për respektimin e të drejtave të këtyre personave në mënyrë të veçantë për pritjen, informimin e tyre për të drejtën e azilit në Shqipëri, sigurimin e informacionit në gjuhën e tyre dhe të shërbimeve të një përkthyesi gjatë intervistimit të tyre. Edhe në këtë sesion, theksi u vu në respektimin me përparësi të të drejtave për personat vulnerabël, si të sëmurë, të moshuar, të mitur, gra dhe personave me aftësi të kufizuara që gjenden në mesin e tyre.

E gjithë konferenca u zotërua nga motoja “*Mos lini pas askënd*” e cila është edhe kryefjala e Agjendës 2030 të OKB-së.

## **KREU 5**

### **Rritja e angazhimeve institucionale të Avokatit të Popullit**

#### **5.1. Reforma në drejtësi**

Avokati i Popullit, si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, për mbrojtjen, parandalimin e shkeljes dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, ka vlerësuar Reformën në Drejtësi, si kryefjalën e reformave për ecurinë dhe zhvillimin cilësor demokratik të jetës shoqërore, si dhe të vetë demokracisë në Shqipëri.

Avokati i Popullit ka qenë dhe vazhdon të jetë në mbështetje të plotë të zbatimit të Reformës në Drejtësi, si një reformë jetike për të gjithë shqiptarët, pasi shumë nga çështjet që adresohen nga qytetarët, lidhen me sistemin e drejtësë në vend, për shkak të problematikave që rëndojnë këtë sistem.

Duke vlerësuar lidhjen e natyrshme të këtyre reformave me të drejtën për mirëqeverisje, si dhe me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vendin tonë, Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe konsideruar prioritet maksimal në veprimtarinë e tij, mbarëvajtjen e proceseve që legjislacioni në fuqi për zbatimin e Reformës në Drejtësi, i ngarkon atij si një përgjegjësi ligjore.

Pas përfundimit të procesit për verifikimin dhe listimin e kandidatëve që shprehën interesin për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konkretisht për Anëtar të Komisionit; Gjyqtar i Kolegjit të Apelit, si dhe Komisionerit Publik, dhe për të cilin është raportuar ne raportin e vitit të kaluar, Avokati i Popullit gjatë gjithë vitit 2017 ka treguar gjithë angazhimin e tij për zbatimin me përgjegjëshmëri dhe pavarësi të të gjitha përgjegjësiave ligjore të parashikuara në paketën e ligjeve të Reformës në Drejtësi.

Institucioni i Avokatit të Popullit në bazë të ligjit nr.115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, përfundoi procesin e verifikimit të kriterëve formale ligjore për kandidatët nga rradhët e avokatisë të cilët shprehën interesin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ashtu si dhe për kandidatët që shprehën interesin nga rradhët e Shoqërisë Civile për Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP).

Më konkretisht, në mbështetje të neneve 19-24 dhe neneve 119-121 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Komisioni Ad Hoc i kryesuar nga Avokati i Popullit, filloi punën me mbledhjen e tyre të parë më 20.02.2017 duke u njohur me dokumentacionin e kandidatëve që kishin shprehur interesin për KLGJ dhe KLP.

Pas verifikimit të kriterëve formale ligjore dhe pas realizimit të seancave dëgjimore, me të gjithë kandidatët, Komisioni Ad Hoc përpiloi listën me renditje, kandidatët që plotësonin kriteret ligjore dhe kandidatët që nuk plotësonin kriteret ligjore, në bazë të formularit të vlerësimit për secilin kandidat nga Komisioni Ad Hoc. Pas përfundimit të listimit, më datë 17.05.2017, dosjet fizike të të gjithë kandidatëve që shprehën interesin për Këshillin e Lartë Gjyqësor, u dorëzuan në ambjentet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë duke vazhduar procedurën e mëtejshme ligjore.

Në lidhje me procesin për verifikimin e kandidatëve që shprehën interesin për KLP, procesi u shoqërua me një rithirrje për kandidatët, si rrjedhojë e mos plotësimit të numrit të kandidatëve në bazë të kriterëve ligjore. Si rrjedhojë, listimi i kandidatëve për KLP përfundoi më datë 13.07.2017, duke u shoqëruar me dorëzimin e dosjeve fizike në ambientet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për t'iu nënshtruar fazës tjetër ligjore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, përbushi detyrimin ligjor të verifikimit të përbushjes së kriterëve formale ligjore për kandidatët nga rradhët e shoqërisë civile që shprehën interesin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Ky proces filloi më datë 31.01.2017 dhe përfundoi më datë 29.12.2017, duke u shoqëruar me shumë faza rithirrje për shkak të mos plotësimit të numrit të kandidatëve sic e kërkon ligji.

Në bazë të neneve 54 – 56 dhe neneve 152-154 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, pas verifikimit të kriterëve formale ligjore dhe verifikimit publik të të gjitha dosjeve të kandidatëve, institucioni i Avokatit të Popullit dorëzoi me date 24.04.2017 relacionin përkatës dhe dosjet fizike të kandidatëve të cilët shprehën interesin për Këshillin e Lartë Gjyqësor, pranë Komisioni i Shoqërisë Civile për vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore. Më datë 19.06.2017 Avokati i Popullit dorëzoi pranë Kuvendit të Shqipërisë raportin e vlerësimit dhe dokumentacionin plotësues të praktikës së Komisionit të Shoqërisë Civile për kandidatët nga rradhët e shoqërisë civile të cilët shprehën interesin për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, procesi për kandidatët nga rradhët e shoqërisë civile që shprehën interesin për Këshillin e Lartë të Prokurorisë u shoqërua gjithë harkun kohor prej një viti me disa rithirrje për shprehje interesi duke qenë se nuk plotësohej kriteri numri i kërkuar në ligj. Më datë 28.12.2017, institucioni i Avokatit të Popullit dorëzoi pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, raportin e vlerësimit dhe dokumentacionin plotësues të praktikës së Komisionit të Shoqërisë Civile për kandidatët nga rradhët e shoqërisë civile për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, duke shënuar dhe fundit e procesit.

Gjithashtu, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e proceseve që ndërthur kjo reformë dhe rolin që Avokati i Popullit mund të luajë për transparencën dhe respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Avokati i Popullit në përputhje me nenin 284 pika 6 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ka monitoruar procesin e zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të zhvilluar në datën 7.12.2017, në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Mbi bazën e këtij monitorimi, Avokati i Popullit hartoi dhe bëri publik raportin e monitorimit për procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Avokati i Popullit ka qenë dhe vazhdon të jetë në mbështetje të plotë të zbatimit të Reformën në Drejtësi, si një reformë jetike për të gjithë shqiptarët, të rëndësishme për ecurinë dhe zhvillimin cilësor demokratik të jetës shoqërore si dhe vetë demokracisë në vend.

Duke vlerësuar maksimalisht përfshirjen e institucionit tone si reference në disa prej aspekteve të zbatimit të reformës në drejtësi, Avokati i Popullit konstaton se dhënia e kësaj detyre nuk është shoqëruar me buxhet apo kapacitete njëzëzore shtesë, qoftë dhe në mënyrë të përkohshme. Sa më sipër, ka ndikuar në uljen e kapaciteteve të institucionit për të trajtuar çështje të të drejtave të njeriut, të cilat janë në mandatin thelbësor të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit mbetet i mendimit se pa një sistem drejtësie të pavarur, eficient dhe të drejtë, Shqipëria nuk do të ndërtojë dot një ekonomi konkurrense që garanton investimet e brendshme dhe të huaja, një politikë të pastër, një jetë të sigurtë për qytetarët e saj, Shtetin e së Drejtës.

## **5.2. Respektimi i të drejtave të migrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve**

Mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Shqipërisë, ligjin nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, në lidhje me respektimin e të drejtave të migrantëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve, rëndësinë e sigurimit të kushteve të përshtatshme të pritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në kufijtë e saj si dhe detyrimet qeverisë së Republikës së Shqipërisë në administrimin e flukseve të përziera migratore duke respektuar standardet e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit si mbrojtës dhe promotor i të drejtave të njeriut ka kryer një sërë monitorimesh për masat dhe politikën që janë ndërmarrë për çështjet e emigracionit, kthimin e shtetasve shqiptarë nga vendet e Evropës dhe riintegrimin e tyre, si dhe masat e ndërmarra dhe procedurat e azilit për azilkërkuesit potencialë që vijnë nga zonat e luftës.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka nxitur qeverinë Shqiptare për më shumë transparencë dhe gatishmëri për bashkëpunim, me qëllim që nevojat e të gjitha atyre që kërkojnë azil në Shqipëri të plotësohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe trajtimi i atyre që nuk kërkojnë azil të jetë sa më në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Më konkretisht ka vazhduar puna për ofrimin dhe garantimin e aksesit maksimal në procedurat e ankesave, dhe në trajtimin e çështjeve specifike të migrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve, përmes ndjekjes në vijimësi të procedurave të azilit. Gjatë këtij procesi, është vënë re se:

- ✓ Procedurat për përfaqësimin me avokat apo mbrojtës ligjor falas, janë të komplikuar duke krijuar vështirësi të panevojshme të cilat shpesh kanë sjellë edhe pamundësinë e azilkërkuesve për mbrojtje ligjore falas e rrjedhimisht refuzimin e rasteve të tyre.
- ✓ Zbatimi i procedurës së përzgjedhjes nga Policia e Kufirit ka ardhur duke u përmirësuar, pasi rezultojnë që ka pasur rritje të numrit të referimeve si azilkërkues, por probleme vërehen tek personat që janë migrantë të parregullt përsëritës.
- ✓ Drejtoria për Azilin ka kufizime të shumta në aftësinë e saj për të mbledhur informacion nga vendet nga vijnë azilkërkuesit e rrjedhimisht njohja e gjendjes në këto vende mbetet e cekët dhe vendimet çalojnë në arsye të mëdha.
- ✓ Pavarësisht nga parashikimi ligjor, vendimmarrja për përcaktimin nëse një person është apo jo refugjat nuk bëhet në mënyrë kolegjiale e rrjedhimisht as UNHCR nuk ftohet të marrë pjesë në to.
- ✓ Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët (KKAR) i cili filloi veprimtarinë në prill 2017, gjatë veprimtarisë së tij nuk është i hapur për monitorim nga organizatat e interesuara, përfshirë këtu edhe UNHCR. Duke qenë se gjatë diskutimit të vendimmarrjes mbi ankimin e azilkërkuesit, nuk mund të jetë i pranishëm asnjë subjekt veç anëtarëve të KKAR, nuk mund të nxirret ndonjë përfundim mbi cilësinë e diskutimeve që zhvillohen brenda kësaj strukture.
- ✓ Nga përmbajtja e vendimeve dhe vëzhgimi i fazave kur intervistohet azilkërkuesi para KKAR, vihet re një nevojë urgjente për trajnime të anëtarëve vendimmarrës.

Institucioni i Avokatit të Popullit është përfshirë gjerësisht në monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar ndaj të huajve të parregullt, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri, duke ndërmarrë një sërë nismash, përfshirë këtu inspektimet periodike në



Qendrën e Mbyllur për të Huajt e Parregullt-Kareç, në Qendrën e Azilkërkuesve- Babru, dhe në pikat e kalimit kufitar, me qëllim final ushtrimin e një presioni pozitiv dhe të vazhdueshëm ndaj autoriteteve përkatëse për përmbushjen e detyrimeve dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë respektimin e të drejtave të refugjatëve.

Duke pasur parasysh se mekanizmi i referimit dhe procedurat për pritjen dhe menaxhimin e grupeve të sipërpërmendura duhet të kryhet plotësisht e me një përqsasje të diferencuar të bazuar në karakteristikat dhe nevojat individuale, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se hapat e marra ende nuk e garantojnë plotësisht këtë proces. Nga inspektimet në pikat e kalimit kufitar, në qendrat e pritjes e trajtimit të të huajve të parregullt dhe të azilkërkuesve, si dhe bazuar në informacionet e marra mbi përshtatjen e Qendrës Sociale për të moshuarit në Gjirokastër për ofrimin e strehimit për azilkërkuesit me nevoja të veçanta në pritje të dërgimit të tyre pranë Qendrës Kombëtare Pritëse në Tiranë, është konstatuar se ka ende shumë sfida që duhen tejkaluar, në mënyrë që ato të konceptohen si qendra funksionale jo vetëm për regjistrimin dhe ndihmesën afatshkurtër ndaj personave në nevojë, por edhe si qendra rezidenciale që do të mundësojnë një qëndrim më afatgjatë të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në to.

Bazuar në gjetjet janë hartuar rekomandime specifike ndaj autoriteteve përkatëse, por ndonëse rekomandimet janë pranuar, ato nuk janë zbatuar për mungesë fondesh, trend i cili parashikohet të vazhdojë dhe gjatë vitit 2018, pasi në buxhetin e Policisë së Shtetit për vitin 2018 nuk është parashikuar fond për Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Kareç lidhur me: shtimin e stafit me një punonjës social, një psikolog, një jurist, një stomatolog dhe një punonjës sanitar; plotësimin e ambienteve rekreative të brendshme e të jashtme dhe pajisjet e nevojshme për aktivitete sportive, si dhe për ndërtimin e një këndi lojërash për fëmijët; vënien në funksionim të sistemit të monitorimit me kamera të perimetrit të jashtëm dhe atij të brendshëm; sigurimin e të drejtës së informimit dhe mbajtjes së kontakteve me jashtë duke i pajisur me aparate kartofonike dhe televizorë në ambient e përbashkëta të brendshme, si dhe lidhjen me antenë satelitore për të mundësuar informimin e të huajve me ngjarjet që ndodhin nga vendet e tyre dhe në botë në gjuhët që ata kuptojnë.

Gjatë këtyre inspektimeve Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar një sërë çështjesh individuale të grumbulluara në formë ankesash. Ndër këto çështje, vlen të përmendet rasti i një shtetasi afgan, i cili i kapur nga forcat e rendit me dokument identifikimi fallco, kishte marrë dënimin nga gjykata respektive duke u dënuar me burgim, e më pas kishte kaluar në shërbim prove me detyrim paraqitje, vendim i cili nuk ishte respektuar si rrjedhojë e mbajtjes në kundërshtim me ligjin të shtetasit të huaj në Qendrën e Mbyllur. Pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, u mundësua kalimi i shtetasit në Qendrën e Hapur për Azilkërkues në Babru. E rëndësishme në këtë rast është që u mundësua sqarimi i procedurës që duhet ndjekur në raste të ngjashme me qëllim garantimin e të drejtave legjitime të shtetasve të huaj me vendim gjykate për përfshirje në shërbimin e Provës.

Me shqetësim Avokati i Popullit ka vërejtur se dispozitat e ligjit për Azilin (neni 24, pika 1, germa C), për të drejtën e azilkërkuesve për pajisje me leje pune, nuk janë respektuar në asnjë rast nga autoritetet përkatëse që lëshojnë lejet e punës (Ish -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), të cilët kanë vendosur në kundërshtim me ligjin të lëshojnë leje pune vetëm për refugjatët. Në lidhje me muxhahedinët, nuk ka ende një vendim për statusin e tyre.

Një ndër çështjet në të cilat institucioni i Avokatit të Popullit është investuar fuqimisht, në përmbushje të Direktivës 2008/115/EC të Parlamentit European, është monitorimi në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTX i operacioneve të riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Schengen.

Mbi bazën e monitorimeve dhe informacionit të autoriteteve përgjegjëse shtetërore, Avokati i Popullit ka konstatuar mungesën e një strategjie kombëtare për ri integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga vendet e tjera të Evropës, si dhe të një Plan-Veprimi zbatues.

Në kuadrin e krijimit dhe forcimit të rrjeteve të bashkëpunimit me aktorët e interesuar, institucioni i Avokatit të Popullit ka thelluar bashkëpunimin me UNHCR dhe Departamentin për Kufirin dhe Migracionin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të shtruar për zgjidhje çështjet që lidheshin me migrantët e parregullt dhe me identifikimin dhe referimin e azilkërkuësve dhe refugjatëve. Po kështu, institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur edhe bashkëpunimin me Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme si organi kompetent për sigurimin e të drejtave të refugjatëve në Shqipëri.

Përgjatë bashkëpunimit me UNHCR, Institucioni i Avokatit të Popullit:

- ✓ Ka marrë pjesë në trajnime të përbashkëta apo të organizuara nga UNHCR.
- ✓ Ka kryer monitorime të përbashkëta në Qendrën e Kareç-it, në pikat kufitare e në drejtoritë rajonale të kufirit dhe në mjediset nën kontrollin e policisë kufitare ku vendosen të huajt e parregullt që nuk i nënshtrohen një procedure ripranimi e si rrjedhim nuk dërgohen në Qendrën e Mbyllur.
- ✓ Ka nënshkruar një marrëveshje me UNHCR për të ndihmuar në forcimin e monitorimit të kufijve, zbatimit të procedurës së përzgjedhjes, si edhe të trajtimit të të huajve të parregullt në Shqipëri.
- ✓ Ka shkëmbyer informacion dhe këshillim për sa i përket përgatitjes së dokumenteve të ndryshme.

Avokati i Popullit i ka dhënë rëndësi zhvillimit të bashkëpunimit konkret midis vendeve anëtare të organizatave të cilat janë vende origjine, tranziti dhe destinacioni për forcimin e të drejtave të migrantëve përgjatë rrugëve migratore dhe deri në kthimin e tyre të mundshëm në vendet e origjinës. Në këtë kuadër, përgjatë vitit 2017, Avokati i Popullit dhe personat e autorizuar prej tij, kanë marrë pjesë dhe kanë dhënë kontributin e tyre në 13 aktivitete ndërkombëtare të cilat kanë pasur për qëllim përmirësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave në lëvizje me fokus të veçantë personat vulnerabël.

Po ashtu janë koordinuar veprimet për transferimin juridiksional të çështjeve me Institucionet e Obudsmenëve, me qëllim sigurimin e një përgjigjeje të shpejtë dhe efektive ndaj ankesave me dimension ndërkombëtar dhe ndërkufitar. Ndër këto, vlen të përmendet kërkesa që Avokati i Popullit i ka dërguar homologut francez, për të hetuar rreth rrethanave të vdekjes së 23 vjeçarit shqiptar Florenc Beqiraj, i cili humbi jetën në një spital francez më datë 22.12.2017, si pasojë e plagëve të marra, në rrethana ende të paqarta në Centre de Réention Administratif du Canet, Marseille. Pala Franceze është përgjigjur që kërkesa është pranuar dhe se çështja po ndiqet prej tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit është angazhuar gjerësisht në fushata të rritjes së ndërgjegjësimit mbi të drejtat e migrantëve dhe refugjatëve. Në kulm të kësaj përpjekjeje ishte organizimi i Konferencës vjetore: “Mos lini pas asnjë! Mbrojtje, Barazi dhe Fuqizim për të Gjithë” më datë 12 dhjetor 2017, për të kremtuar Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Konferenca u fokusua, ndër të tjera, edhe mbi të drejtat e fëmijëve, grave dhe personave në lëvizje nga një vend në tjetrin, nën dritën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm/Agjendës 2030.

Si rrjedhim i përpjekjeve dhe aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me migrantët dhe refugjatët, si edhe bashkërendimit me aktorë të tjerë në këtë fushë dhe bashkëpunimit me autoritetet shtetërore kompetente:

- ✓ Institucioni i Avokatit të Popullit është parë nga gjithë aktorët e interesuar në këtë fushë (UNHCR, Ambasada e SHBA, etj), si një nga partnerët më të besueshëm për bashkëpunim.
- ✓ Institucioni i Avokatit të Popullit është përfshirë në monitorimin konstant në vend në kufirin jugor të Shqipërisë, me qëllim vlerësimin e procedurave që ndiqen gjatë procesit të intervistimit dhe përzgjedhjes.
- ✓ Në përgjigje të rekomandimit nga institucioni i Avokatit të Popullit, qeveria Shqiptare (përmes Departamentit të Policisë Kufitare dhe të Migracionit), ka ripohuar dhe marrë përsipër zbatimin e detyrimeve të saj, pavarësisht nga vështirësitë, që t'i japë strehim dhe ndihmë të gjithë atyre që e kërkojnë këtë dhe ndjekin procedurat e azilit e njihen si refugjatë apo persona nën mbrojtje plotësuese në Shqipëri. Në vërtetim të sa më sipër, është rritur numri i referimeve nga policia kufitare tek organet që merren me azilin (Drejtoria për Shtetësinë dhe Azilin) duke arritur në një numër prej 308 azilkërkuesish në vitin 2017.
- ✓ Janë përmirësuar herë pas here kushtet e trajtimit të të huajve në Qendrën e Karreçit. Policia Kufitare është bërë më e ndërgjegjshme për vështirësitë e mbajtjes në Qendrën e Karreçit të fëmijëve (përfshirë këtu ata të pashoqëruar) dhe të personave të tjerë me nevoja të veçanta. Si rrjedhim, në shumicën e rasteve që nga viti 2014, kjo kategori është sistemuar në qendra të tjera, përfshi këtu Qendrën e Babrrusë, pavarësisht se nuk kishin kërkuar azil.
- ✓ Në marrëveshje me policinë kufitare, autoritetet e azilit dhe pushtetin vendor, si edhe me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, janë rritur ndjeshëm kapacitetet pritëse në vend përmes:
  - a. Ndërtimit të një qendre pritëse tranzit për të huajt e parregullt që kapen në afërsi të zonave kufitare në Gjirokastrë.
  - b. Rehabilitimit të një qendre sociale në Gjirokastrë për rastet e të huajve të parregullt dhe të azilkërkuesve me nevoja të veçanta.
  - c. Rritjes/dyfishimit të kapacitetit të Qendrës së Babrru-së përmes një ndërtimi të ri në territorin e qendrës.

### **5.3. Monitorimi i Pavarur i Kthimeve të Detyruara të qytetarëve shqiptarë**

Rëndësia e krijimit të një sistemi të brendshëm dhe të jashtëm për monitorimin e kthimeve të detyruara, është theksuar në raportet e organizmave ndërkombëtare dhe veçanërisht në raportet e përgjithshme të Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Dënimit apo Trajtimin Degradues dhe Johuman (C.P.T.). Monitorimi i jashtëm gjatë operacioneve të kthimit është parashikuar edhe në legjisllacionin e BE-së.

Direktiva për Operacionet e Kthimit, parashikon, para së gjithash, që “nevojiten rregulla të qarta, transparente dhe të drejta për të siguruar një politikë kthimi efektive si një element i nevojshëm i një politike migracioni të mirë-menaxhuar”. Për më tepër, neni 8, paragrafi 6 i Direktivës shpreh që “Shtetet Anëtare duhet të marrin masat për një sistem monitorimi efikas të kthimeve të detyruara”. Neni 8, paragrafi 4, përcakton se kthimi mund të jetë i detyruar dhe i pavullnetshëm, por ai duhet të kryhet në përputhje me “të drejtat themelore dhe me respektin e duhur për dinjitetin dhe integritetin e personave të kthyer”.

Këto operacione duhet të organizohen në mënyrë humane dhe në përputhje me të drejtat themelore të mishëruara në instrumentet përkatës ndërkombëtar, në veçanti:

- ✓ parimit të dinjitetit njerëzor
- ✓ të drejtën e jetës
- ✓ parimin e mosdorëzimit
- ✓ të drejtën e azilit
- ✓ ndalimin e torturës dhe trajtimin johuman, ose ndëshkues apo degradues,
- ✓ të drejtën e lirisë së sigurisë
- ✓ të drejtat e fëmijës
- ✓ të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale
- ✓ të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare

Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT) gjithashtu ka nënvizuar nevojën për trupa monitoruese të pavarura me qëllim mbikëqyrjen e të gjithë procesin e kthimit nga shteti mikpritës në shtetin që është destinacioni final i personit të shoqëruar, për të mundur një nivel më të lartë transparence dhe llogaridhënieje sa i përket kushteve dhe trajtimit të të shoqëruarve. Kjo përfshin monitorimin e fazave pasuese të procesit, si p.sh. vendet në të cilat personat mbahen në pritje të deportimit, procesin e transferimit (përfshirë marrjen nga qendra e mbyllur në aeroport), ruajtjen dhe sigurinë gjatë qëndrimit në aeroport dhe procedurat e transferimit në avion. Kur gjykohet e arsyeshme, monitoruesit zhvillojnë intervista individuale me të shoqëruarit dhe personat e tjerë, përfshirë stafin mjekësor dhe shoqëruesit.

Është e rëndësishme të kuptohet që procesi i kthimit të detyruar është pjesë e fushës së veprimit dhe mandatit që buron nga Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës (OPCAT). Gjatë kthimeve të detyruara, emigrantët janë të privuar nga liria sipas kuptimit të OPCAT. Në mënyrë specifike, neni 4 i OPCAT parashikon autorizimin për vizita monitoruese dhe shpreh se Mekanizmat Kombëtarë për parandalimin e torturës dhe Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës (SPT) kanë mandat të monitorojnë kthimet e detyruara të ndërmarra në rrugë tokësore, detare dhe ajrore. Për këtë arsye, shumë Mekanizma Kombëtarë të Parandalimit në Europë janë përfshirë në monitorimin e kthimeve të detyruara, përfshirë dhe Mekanizmin Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar pranë Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEx, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riadhesimit të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve për të cilët ishte marrë vendimi i riadhesimit nga autoritetet përkatëse. Ekspertët e MKPT-së, ishin pjesë e grupit monitorues të *17 operacioneve të riadhesimit*, duke u bashkërenduar dhe me organizmat ndërkombëtare dhe me mekanizmat kombëtarë të vendeve të tjera, duke ushtruar rolin ligjor si garant, dhe njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Europian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorimin e pavarur nga ana e Mekanizmave Kombëtarë të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës. Monitorimi i plotë i kthimeve të detyruara përfshin të gjitha fazat e kthimit: fazën e para-kthimit, fazën e kthimit dhe fazën e pas-kthimit (arritjen dhe pritjen në destinacion).

Në përmbushje të misionit të tyre ekspertët e MKPT-së kanë pasur si detyrë funksionale, përveç monitorimit të respektimit të Kartës Ndërkombëtare të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut edhe monitorimin e respektimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të cilat sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor të të gjithë personave pjesëmarrës në operacionin e riadhesimit. Në përfundim të operacioneve të kthimit, vëzhgimet e procesit të plotë të monitorimit përfshihen në raportet e MKPT-së të cilët në raste specifike i dërgohen dhe FRONTEx dhe në kuadrin kombëtar autoriteteve relevante, si Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit në Ministrinë e Brendshme. Gjatë vitit 2017 janë kryer 17 monitorime të operacioneve të kthimit të detyruara të shtetasve Shqiptarë nga Franca. Shtojmë se shtetasit shqiptarë të rikthyer në këto operacione, jo të gjithë janë sjellë nga policia franceze, pasi pothuajse në çdo operacion ka pasur edhe shtetas shqiptarë të sjellë nga Belgjika, ndërsa në dy raste edhe nga Holanda.

#### **5.4. Monitorimi i zgjedhjeve të përgjithshme**

Procesi i monitorimit të zgjedhjeve është një ndër elementët kyç që Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur dhe vazhdon të ketë në vëmendje gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij si institucion i pavarur kushtetues, në kuadër të mbrojtjes, garantimit dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi dhe garantimit mbi ushtrimin efektiv të së drejtës së votës në veçanti.

Gjatë vitit 2017, nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit monitorimi i procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme në Kuvendin e Shqipërisë (Qershor 2017), ka patur për qëllimin konstatimin e problematikave dhe marrjen e masave me qëllim garantimin e të drejtës së votes.

Ky monitorim u realizua përgjatë dy fazave:

Faza e parë kishte në fokus monitorimin dhe konstatimin e problematikave para zhvillimit të procesit zgjedhor, mbi marrjen e masave për ushtrimin e të drejtës efektive të votës dhe garantimin e infrastrukturës së nevojshme për ushtrimin e kësaj të drejte për kategori të veçanta individësh si personat me aftësi të kufizuar apo personat e privuar nga liria, pa përjashtuar pjesën tjetër të individëve në përgjithësi.

Gjatë kësaj periudhe sipas monitorimeve të kryera janë konstatuar disa problematika për të cilat janë hartuar rekomandimet përkatëse drejtuar ministrive sipas fushave që mbulojnë dhe Bashkive, rekomandime për të cilat jo në çdo rast është marrë përgjigje nga ana e autoritetit të cilit i janë drejtuar, por ka patur edhe nga ato rekomandime ku institucioni ka gjetur bashkëpunim dhe qëndrim pozitiv. Informacioni mbi konstatimet nga monitorimet e kryera, bashkë me rekomandimet e dërguara, i janë bërë me dije edhe Kryeministrisë përmes korrespondencës zyrtare, drejtuar Zëvendëskryeminstres Znj. Ledina Mandia.

Rekomandimet e hartuara u janë drejtuar:

- ✓ Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku i është kërkuar marrja e masave lidhur me monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin financiar si dhe marrjen e masave për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara.
- ✓ Të gjitha Bashkive, ku është kërkuar zbatimi me rigorozitet i ligjit, për sa i takon afishimit të materialeve propagandistike, dhe për këtë është marrë përgjigje vetëm nga 5 prej tyre.
- ✓ Ish Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike si dhe të gjitha Bashkive, ku u është kërkuar marrja e masave organizative për mospërfshirjen e punonjësve të administratës publike dhe asaj lokale në fushatën elektorale gjatë orarit zyrtar të punës. Nga ky institucion nuk ka patur përgjigje, kurse nga ana e Bashkive vetëm 18 prej tyre kanë kthyer përgjigje.
- ✓ Ministrisë Arsimit dhe Sporteve mbi marrjen e masave organizative për mospërfshirjen e fëmijëve të sistemit arsimor parauniversitar në aktivitete elektorale.
- ✓ Drejtorit të Policisë së Shtetit, për zbatimin me korrektesë të detyrave ligjore nga Policia e Shtetit.
- ✓ Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Drejtorit të Policisë së Shtetit, Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile mbi garantimin e të drejtës së votës për personat e paraburgosur dhe të dënuar, ku ka patur përgjigje vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Faza e dytë konsistoi në monitorimin e procesit të votimit gjatë ditës së zgjedhjeve. Institucioni i Avokatit të Popullit ngriti disa grupe pune me qëllim monitorimin e qëndrave të votimit në qytetin e Tiranës në shkolla, kopshte, çerdhe si dhe nëpër Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Nga monitorimet e kryera në qendrat e votimit, në fokus ishte verifikimi kryesisht i infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara nga ku u konstatua se në disa qendra votimi rampat për personat me karrocë ishin funksionale por në disa qendra të tjera votimi ndonëse të vendosura, nuk ishin të aksesueshme dhe në disa të tjera mungonin. Nga një këndvështrim i përgjithshëm, infrastruktura e nevojshme për aksesin e pavarur të personave me aftësi të kufizuara nëpër qendra votimi, mungonte. Personat e verbër si dhe ata me aftësi të tjera të kufizuara, duhej detyrimisht të ishin të shoqëruar duke iu cënuar në këtë mënyrë ushtrimi i të drejtës së votës si një e drejtë vetjake.

Lidhur me monitorimet e kryera në institucionet e vuajtjes së dënimit kryesisht: në IEVP Durrës, Shënkoll (Lezhë), Rrogozhinë, Peqin, Elbasan, Kukës si dhe në Tiranë (IEVP “Mine Peza”, “Ali Demi”) dhe Intitucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB) Tiranë, rezultoi se ambientet e votimit në këto qendra votimi ishin me kushte normale dhe të pajisuara me bazën e nevojshme materiale për realizimin e procesit të votimit.

Sa i përket ushtrimit të së drejtës së votës, një numër i konsiderueshëm i të dënuarëve që ndodheshin në këto institucione ishin përjashtuar nga e drejta e votimit sipas ligjit për dekriminalizimin.

Nga grupet e punës u kryen gjithashtu intervista konfidenciale me disa të dënuar dhe të paraburgosur lidhur me procesin e votimit dhe ushtrimin e lirë të së drejtës së votës ku rezultoi se ndaj tyre nuk ishte ushtruar asnjë lloj presioni apo ndikimi nga administrata e IEVP-ve lidhur me votimin për subjekte të caktuara zgjedhore.

Në disa IEVP u konstatuan vonesa në dërgimin e listave të zgjedhësve nga ana e Bashkive dhe për këto problematika institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi:

- ✓ Marrjen e masave të nevojshme nga Bashkitë për dërgimin në afatin ligjor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor të listave të zgjedhësve në IEVP të cilat janë në juridiksionin tokësor të tyre;
- ✓ Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoritë e IEVP-ve duke i kërkuar bashkive respektive dërgimin e listave të zgjedhësve për personat e privuar nga liria, të dënuar dhe paraburgosur, në rastet kur konstatojnë se ato nuk janë dërguar në institucion në afatin ligjor si dhe për të njoftuar dhe sensibilizuar disa muaj para datës së zgjedhjeve, personat e privuar nga liria për të bërë të mundur pajisjen e tyre me dokumente identifikimi, me qëllim garantimin dhe ushtrimin e të drejtës për të votuar.

Monitorimit të procesit zgjedhor iu bashkuan dhe përfaqësuesit e Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit në rrethe (Fier, Shkodër, Berat, Sarandë, Dropull, Kukës dhe Pogradec).

## **KREU 6**

### **Bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja**

#### **6.1. Bashkëpunimi me institucionet e Administratës Publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit**

Zbatimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga institucionet e administratës publike është treguesi më i mirë i zbatimit të ligjit organik dhe kuadrit rregullator përkatës, rrjedhimisht edhe i përmbushjes së misionit institucional, e si përfundim edhe i garantimit të autoritetit dhe pavarësisë së këtyre institucioneve.

Një nga çështjet dhe sfidat me të cilat përballlet institucioni i Avokatit të Popullit në praktikën e tij të përditshme, është realizimin i bashkëpunimit efektiv institucional për nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga organet e administratës publike. Më konkretisht, shqetësimet lidhen me tre elementë kryesorë:

- ✓ *moskthimi i përgjigjeve për kërkesat për shpjegime;*
- ✓ *moskthim të përgjigjeve ndaj rekomandimeve;*
- ✓ *moszbatim të rekomandimeve të pranuarra paraprakisht nga institucionet shtetërore.*

Gjithashtu, edhe Progres raportet e fundit të shërbimeve të Komisionit Evropian (2014, 2015, 2016), kanë ngritur si shqetësim dhe komentuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve kushtetuese sikundër është edhe Avokati i Popullit, duke i ngarkuar një rol specifik Kuvendit të Shqipërisë për të monitoruar në mënyrë sistematike nivelin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Sa më sipër, Avokati i Popullit ka kërkuar dhe sugjeruar:

- ✓vendosjen e detyrimit për ngritjen e mekanizmave të brendshëm përgjegjëse nga çdo institucion i Administratës Publike (qendrore dhe vendore), për evidentimin e problematikës në fjalë dhe zgjidhjen në një kohë sa më të shpejtë rast pas rasti. Ky sugjerim ka ardhur për shkak se, gjatë veprimtarisë së përditshme është konstatuar mungesë bashkëpunimi jo vetëm nga institucionet në nivel qendror, por edhe nga institucionet në nivel vendor. Për rrjedhojë, kjo do të ndihmonte edhe njësitë e pushtetit vendor për respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në nivel lokal.
- ✓vlerësimin e mundësisë që të paktën një herë vit Qeveria duhet të raportojë në Kuvend mbi gjëndjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, duke e konsideruar si një instrument për forcimin e nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga administrate publike si dhe mirëqeverisjes.

Vlerësohet shumë pozitiv fakti që tashmë Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar vendimin nr.49/2017, “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavaruara kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, në të cilën janë përfshirë edhe sugjerimet e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se veprimtaria e këtij institucioni e ka shumë të nevojshme që të ketë një mekanizëm eficient dhe sistematik të ndjekjes dhe përmbushjes së rekomandimeve që i drejtohen administratës publike.

Gjithashtu, Avokati i Popullit vlerëson se ndjekja dhe zbatimi rigoroz i këtij vendimi do të rrisë kontrollin parlamentar ndaj Qeverisë për të kuptuar se përse nuk zbatohen rekomandimet e institucioneve të pavarura nga këto organe dhe, natyrisht, do të përmirësojë edhe mekanizmat e tij parlamentarë për të rritur informimin dhe shqetësimin e institucioneve në çdo rast për çdo çështje ku Kuvendi, si organ ligjvënës dhe kontrollues i zbatimit të ligjit e Qeverisë, mund të kontribuojë.

#### *Niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit*

Gjatë vitit 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 188 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve rezulton se:

- a. Të pranuar 123
- b. Të refuzuara 29
- c. Pa përgjigje 24
- d. Në proces 12 rekomandime.

1. Siç ju përmëndem më lartë 123 rekomandime janë të pranuar nga organet shtetërore, nga të cilat **80 rekomandime janë pranuar dhe zbatuar, ndërsa 19 rekomandime janë pranuar por nuk janë zbatuar. Ndërkohë, për 24 rekomandime që janë pranuar prej tyre, institucionet përgjegjëse nuk kanë dërguar informacion për ecurinë e zbatimit të tyre.**

2. Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total 188, rezulton se vetëm 123 prej rekomandimeve të pranuar, kanë gjetur zbatim të plotë. Pra, referuar raportit të rekomandimeve të pranuar me rekomandimet e zbatuara, **rezulton se 65% e rekomandimeve të pranuar kanë gjetur zbatim nga institucionet përkatëse.**



3. Lidhur me rekomandimet pa përgjigje, konstatohet se 24 rekomandime për vitin 2017, rezultojnë pa përgjigje nga institucionet shtetërore. Pra, në përputhje me raportin midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit **rezulton se 12.7 % e rekomandimeve të adresuara nuk kanë përgjigje.**

4. Përsa i takon numrit të kërkesave për informacion, rezulton se për vitin 2017, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total **2015 kërkesa për informacion**, prej të cilave 60 prej tyre rezultojnë pa përgjigje, ose **2.9% e kërkesave për informacion të adresuara** nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

5. Avokati i Popullit vëren se në varësi të rëndësisë së çështjes dhe problematikës që ajo parashtron, varion edhe bashkëpunimi i pritshëm dhe i ofruar rast pas rasti, nga ana e organeve të administratës publike. Vazhdon të shfaqet si problematikë çështja e përgjigjeve formale që na dërgohen nga organet e administratës publike por që në thelb nuk përmbajnë informacionin e kërkuar, sikundër edhe mosdërgimin e këtij informacioni pamvarërisht kërkesave tona të përsëritura për këtë qëllim.

Në përfundim, nisur nga analiza e statistikave të mësipërme, për vitin 2017 rezulton dhe sikundër evidentohet ka një rritje të numrit të rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucionet e Administratës Publike, si dhe, kemi një rritje në përqindje e rekomandimeve të zbatuara. Ndërkohë që edhe lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2017 janë më pak rekomandime pa përgjigje, krahasuar me vitin 2016.

## **6.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Viti 2017 ishte viti i mbarimit të mandatit të Zotit Igli Totozani dhe zgjedhjes së Avokates së re, Zonjës Erinda Ballanca. Përveç kësaj, në mesin e vitit 2016 dhe në gjysmën e parë të vitit 2017, Avokati i Popullit u përfshi intensivisht në proceset e pranimit dhe përzgjedhjes paraprake të kandidatave për organet e vetingut. Për rrjedhojë, aktiviteti ndërkombëtar i institucionit në këtë periudhë ka qenë më pak intensiv krahasuar me periudhat pararendëse.

Megjithatë, edhe gjatë vitit 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh të Institucionit, të renditura si vijon:

Më **22-24 mars** në Serbi u organizua një dialog rajonal për reduktimin e pabarazisë, përjashtimit dhe luftës kundër homofobisë dhe transfobisë në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, FYROM dhe Serbi, në kuadër të projektit të UNDP “**Të jesh LGBTI në Europën Lindore.**” Në takim u evidentua fakti që organizatat LGBTI në të gjitha vendet e përmendura kanë një dialog të vazhdueshëm midis tyre, çka nuk mund të thuhet për dialogun që duhet të ekzistojë edhe midis qeverive të vendeve të rajonit në këtë drejtim. Takimi vuri theksin në faktin se, në përmbushje të detyrave të tyre në mbrojtje të drejtave të njeriut, edhe ombudsmenët duhet të bashkëpunojnë midis tyre për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e personave LGBTI.

Në datat **27-28 qershor** në Sarajevë u zhvillua një Konferencë për të drejtat sociale dhe ekonomike të **personave të zhvendosur me forcë** gjatë konfliktit në ish Jugosllavi. Organizatorë të kësaj konferencë ishin Këshilli i Europës dhe UNHCR. Konferenca mori shkas nga fakti se të drejtat e personave të zhvendosur me forcë në këtë pjesë të rajonit nuk janë respektuar nga shtetet përkatëse dhe se, edhe pas gjithë këtyre viteve, shumë nga këta persona vazhdojnë të vuajnë pasojat negative

të një zhvendosjeje të padrejtë dhe jashtë vullnetit të tyre.

Po në këtë kontekst dhe po në Sarajevë, në datën **29 qershor** Avokatja e Popullit zonja Erinda Ballanca mori pjesë në një takim konsultativ rajonal në Ballkanin Perëndimor mbi **Impaktin Global të Emigracionit**. Konferenca u organizua nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

Me rëndësi të veçantë ishte Forumi i gjashtë i shoqërisë civile për Ballkanin Perëndimor, organizuar nga Komiteti Europian Ekonomik dhe Social në panelin “**Liria e shprehjes dhe media në Ballkanin Perëndimor**” i cili u mbajt nga data **10-11 korrik** në Sarajevë. Në kohë të vështira krizash globale si kriza e refugjatëve, si pasojë e rritjes së populizmit dhe ksenofobisë, të drejtat e njeriut, dhe në mënyrë të veçantë liria e shprehjes, vihen nën trysinë e politikës. Media, e cila duhet të jetë kampione e fjalës së lirë në shumë nga vendet e Ballkanit Perëndimor është disa herë e mpleksur me politikën dhe biznesin. Takimi theksoi faktin se institucioneve të të drejtave të njeriut dhe ombudsmanëve u bie për detyrë të promovojnë më fort lirinë e shprehjes dhe së bashku me të edhe lirinë e medias.

Në Oslo nga **7-8 shtator** u mbajt seminari i dytë global i Aleancës për raportimin mbi ecurinë e barazisë gjithëpërfshirëse dhe drejtësisë në shoqëri organizuar nga UNDP/UNDOC/UNESCO. Rritja e pabarazisë sociale përbën jo vetëm një shqetësim, por edhe një padrejtësi sociale dhe seminari theksoi rolin që duhet të luajnë institucionet, përfshirë edhe ato të të drejtave të njeriut, për të bërë të mundur që individët dhe grupet shoqërore vulnerabel të mos përjashtohen, por të bëhen pjesëmarrës dhe përfitues të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe politik.

Konferenca e 9-të e institucioneve të **ombudsmanëve për forcat e armatosura** u mbajt në Londër, nga data **8-10 tetor**. Në vijim të kësaj ishte edhe aktiviteti i EUROMIL. Rëndësi të veçantë, EUROMIL (European Organization of Military Associations) u jep të drejtave të njeriut për anëtarët e forcave të armatosura. Në këtë kontekst, më 19 dhjetor 2017, z. Emmanuel Jacob, Drejtues i EUROMIL, zhvilloi një takim në Ministrinë e Mbrojtjes në Tiranë me zv/Ministrin e Mbrojtjes z. Petro Koçi dhe Avokaten e Popullit zj. Erinda Ballanca. Vëmendje e veçantë në takim iu kushtua së drejtës për organizim të anëtarëve të forcave të armatosura.

Në Novi Sad, Vojvodinë, nga data 16-17 nëntor 2017 u mbajt konferenca ndërkombëtare, “**Liria dhe Siguria: E Drejta për Privaci**”. Kjo konferencë u organizua nga Ombudsmani rajonal i Vojvodinës dhe pati më së shumti karakterin e një forumi për shkëmbimin e ideve për nevojën e ballancimit të masave për forcimin e sigurisë me atë të mbrojtjes së të drejtave të jetës private të individit, e cila gjithnjë e më shumë po rrezikohet në kushtet e rritjes së terrorizmit dhe masave të qeverive për të forcuar sigurinë.

Gjatë vitit 2017, u zhvilluan një numër aktivitetesh ndërkombëtare **me fokus të veçantë te fëmijët**. Më konkretisht:

- ✓ Konferenca vjetore e 21-të e Rrjetit Europian të Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve (ENOC) zhvilluar në Helsinki, në datat **19-21 shtator**. Tema e Konferencës për këtë vit ishte: “**Edukimi për Marrëdhëniet dhe Seksualitetin – Zbatimi i së Drejtës së Fëmijëve për Informim**.” Gjatë gjithë Konferencës theksi u vu në nevojën e edukimit të fëmijëve për llojet e ndryshme të marrëdhënieve që krijohen në shoqëri dhe në mënyrë të veçantë marrëdhënieve të seksualitetit, në mënyrë që ata të përgatiten për të mbrojtur vetveten përballë sjelljeve abuzuese, shpesh edhe nga njerëz të afër të familjes. Konferenca doli edhe me një rezolutë që u

drejtohen qeverive dhe në mënyrë të veçantë autoriteteve arsimore për përfshirjen e këtij lloj edukimi në kurrikulën mësimore. Me këtë rast, u mbajt edhe mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të ENOC.

- ✓ Në Ankona, në 25 nëntor u mbajt takimi i ombudmanëve për fëmijë në lidhje me **mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar**. Takimi që nënvizoi rreziqet që u kanosen fëmijëve të pashoqëruar doli edhe me një deklaratë drejtuar qeverive.
- ✓ Komisioni Evropian organizoi Forumin e 11-të Evropian për të Drejtat e Fëmijëve me temë, **“Fëmijët e privuar nga liria dhe alternativat e ndalimit.”** Qëllimi i forumit ishte nënvizimi i rëndësisë së përdorimit të formave alternative të ndëshkimit për të mitur dhe përdorimi i ndalimit vetëm si mjet i fundit.
- ✓ Në Athinë, **13-14 nëntor** u mbajt takimi rajonal për Ombudsmanët për fëmijët me temë: **“Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve në Lëvizje në Evropë – Sfidat e Përfshirjes Sociale.”** Theksi sërish u vendos në rritjen e pjesëmarrjes në shoqëri dhe përfshirjes sociale si masa më efikase për pakësimin e numrit të fëmijëve në lëvizje në vendet evropiane.
- ✓ Më **29-30 nëntor**, në Strazburg u organizua një tryezë me ekspertë në lidhje me **mënyrat e komunikimit dhe mjetet e përdorura për të informuar fëmijët migrantë** rreth të drejtave që gëzojnë dhe procedurat që duhet të ndjekin.

#### *Aktivitete në kuadër të AOM*

Në kuadër të Shoqatës së Ombudsmanvë të Mesdheut (AOM), si President i kësaj Shoqate dhe në kontekstin e detyrave të lëna nga Konferenca Ndërkombëtare e Tiranës për të drejtat e personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, në cilësinë e presidentit të AOM, zoti Totozani vizitoi qendrat e refugjatëve në Maqedoni. Në vizitën e tij, e cila u zhvillua në datat 13-14 mars 2017, zoti Totozani shoqërohej nga Mbrojtësi i të Drejtave të Francës, Jacques Toubon si dhe nga Ombudsmani i Maqedonisë, Ixhet Memeti. Nga kampet në Maqedoni, të tre Ombudsmanët u bënë thirrje qeverive përkatëse dhe organizatave ndërkombëtare të anagazhohen në mbrojtje të të drejtave të njeriut për personat e vendosur në këto kampe.

Në vijim të kësaj vizite, në kuadër të AOM, u organizua një vizitë tjetër në Itali në **datat 25-26 prill** lidhur me situatën e të drejtave të refugjatëve. Kësaj here zoti Totozani shoqërohej nga Ombudsmania spanjolle, Soledad Becerill, dhe Mbrojtësi i të Drejtave të Francës. Ata u pritën nga Zoti Mauro Palma, Garanti i të Drejtave të Personave të Ndaluar apo të Privuar nga Liria në Itali. Ndërsa në datat **15-16 maj**, një delegacion Italian i kryesuar nga zoti Palma vizitoi vendin tonë në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh.

Në datat **25-26 shtator**, Ombudsmani turk mbajti simpoziumin e përvitshëm ndërkombëtar me ombudsmanë nga e gjithë bota. Tema e takimit të 2017 kishte të bënte me rolin dhe funksionet e ombudsmanit në shoqëri. Me këtë rast, Avokatja e Popullit zj. Ballanca mbajti një fjalë lidhur me mënyrën e trajtimit të ankesave në institucionin tonë. Duke përfituar nga fakti se ombudsmanët e vendeve anëtare të AOM do të ishin të pranishëm në konferencën e organizuar nga Ombudsmani turk, sekretariati i AOM organizoi edhe **mbledhjen e strukturave të AOM** në pasditën e datës **26 shtator** në Stamboll.

Në Kasablanca (Marok), nga **18-19 tetor** u mbajt trajnimi i organizuar nga AOM me temë: “Deontologjia e forcave të armatosura dhe të drejtat e migrantëve: roli i institucioneve të Ombudsmanit.” Trajnimi synonte rritjen e kapaciteteve të punonjësve të ombudsmanëve për të bërë të mundur krijimin dhe ngulitjen e një kulture demokratike në punën dhe praktikën e forcave të armatosura me qëllim respektimin e të drejtave të migrantëve.

#### *Aktivitete në kuadër të AOMF*

Në **3-4 maj 2017**, në Rabat, Marok, u mbajt mbledhja e instancave të AOMF. Më këtë rast AOMF kishte organizuar edhe një seminar lidhur me deontologjinë e institucioneve. Ky seminar shërbeu si një përvojë njohëse me deontologjinë që duhet të zotërojnë në institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në **23-24 nëntor**, në Tunizi, nga Shoqata e Ombudsmanëve Frankofonë u organizua takimi me temë: “Parlamentarët dhe Mediatorët, aktorë të forcimit të qeverisjes së mirë.” Theksi u vu në rolin e ndërmjetësimit midis qytetarit dhe administratës që kanë parlamentarët dhe mediatorët/ombudsmanët në funksion të forcimit të qeverisjes së mirë.

AOMF në datat **4-5 dhjetor**, organizoi për vendet anëtare nga Amerika e Veriut dhe Europa një seminar lidhur me planifikimin strategjik dhe matjen e cilësisë. Ndërsa për stafin teknik më **6-7-8 dhjetor**, AOMF organizoi një seminar me temë: Marrëdhëniet e institucioneve të ndërmjetësimit me qytetarët.

AOMF-AOM organizuan një udhëtim studimor në datat **18-20 dhjetor** në Spanjë të Grupit të Përbashkët të Punës për Fëmijët ku bën pjesë edhe një anëtar i stafit të institucionit të Avokatit të Popullit. Në fokus të vizitës studimore ishin të drejtat e fëmijëve migrantë.

#### *Bashkëpunimi në kuadër të GANHRI DHE ENNHRI*

Gjatë vitit 2017, Avokati i Popullit ndoqi të gjitha aktivitetet e GANHRI-t (Aleanca Globale e Institucioneve të të Drejtave të Njeriut). Në këtë kuadër, ndihmës komisionerë të Avokatit të Popullit, ndihmuan me informacione dhe plotësim pyetësorësh një numër studimesh të ndërmarra nga aleanca në drejtim të përmirësimit të promovimit dhe mbrojtjes së drejtave të njeriut, me përparësi në drejtim të parandalimit të shkeljeve të këtyre të drejtave.

Por veprimtarinë më të madhe brenda GANHRI-t, Avokati i Popullit e zhvillon në gjirin e Rrjetit European të Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)- nënndarja e GANHRI-t që grupon vendet e Europës. Falë rolit shumë pro-aktiv të Sekretariatit të ENNHRI-t në funksion të rritjes së ndërveprimit midis institucioneve anëtare, punonjës të Avokatit të Popullit morën pjesë në Grupin e Punës për Personat me Aftësi të Kufizuar, Grupin e Punës për të Drejtat e Personave të Moshës së Tretë, Grupin e Punës për Parandalimin e Konfliktëve Etnike, Grupin e Punës për të Drejtat e Grave, etj. Kjo pjesëmarrje i shërben shkëmbimit të përvojave, por edhe përmirësimit të kapaciteteve dhe rritjes së standardeve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

**Asambleja e Përgjithshme e ENNHRI** për vitin 2017 u mbajt më **28-29-30 nëntor** në Bruksel. Përveç mbledhjes së Asamblesë, në datën 28 nëntor u mbajt një seminar lidhur me kujdesin ndaj personave të moshës së tretë. Po ashtu, u zhvillua edhe një seminar për mënyrat, format dhe rrugët e bashkëpunimit midis ombudsmanve/institucioneve të të drejtave të njeriut dhe strukturave të Bashkimit European. Në seminar morën pjesë një numër drejtuesish nga strukturat relevante të

Bashkimit European, dhe takimi mori trajtën e një bashkëbisedimi për rrugët e mundshme të bashkëpunimit.

#### *Bashkëpunimi me UNDP dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara*

Gjatë vitit 2017, institucioni i Avokatit të Popullit forcoi edhe më tej bashkëpunimin me UNDP dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara. Me zgjedhjen e Avokates së re së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, u mbajt një takim midis stafit të Avokatit të Popullit dhe stafit të Agjencive të Bashkuara për të parë mundësitë konkrete të bashkëpunimit midis palëve. Me video konferencë, të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Zyrës Ndërlidhëse të UNDP në Turqi dhe Përgjegjësi i Zyrës për Institucionet e të Drejtave të Njeriut, Mekanizmat Rajonalë dhe Shoqërinë Civile, në Gjenevë. Gjatë takimit, u ra dakord për disa fusha të mundshme bashkëpunimi si dhe për krijimin e një grupi koordinues ndër-institucional.

Frut i parë i këtij bashkëpunimi ishte organizimi i përbashkët i Konferencës Vjetore të Avokatit të Popullit me temë: *“Mos lini asnjë pas! Mbrojtje, Barazi dhe Fuqizim për të gjithë”*. Fokusi i Konferencës u vendos në të drejtat e Grave, Fëmijëve, Grupeve Vulnerabël dhe të drejtat e personave migrantë. Në Konferencë morën pjesë autoritetet e vendit, përfaqësues të rëndësishëm të Komunitetit Ndërkombëtar dhe përfaqësive diplomatike si dhe një numër i madh përfaqësuesish të organizatave të shoqërisë civile.

#### *Aktiviteti Ndërkombëtar i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës*

Edhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) zhvilloi aktivitetin e tij ndërkombëtar në 2017. Kështu në **3 tetor** në Vienë të Austrisë u mbajt Forumi European i MKPT-ve me temë **“Krijimi i mjeteve që mundësojnë krahasimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe praktikave të punës dhe kushtet në mjediset e ndalimit.”** Forumi European i MKPT-ve është një strukturë jo formale e Këshillit të Europës për të komplementuar rrjetet rajonale të MKPT-ve. Krijimi i një rrjeti european të formalizuar për MKPT-të e vendeve të Europës është një ide që po fiton terren gjithnjë e më shumë.

Në datat **14-15 nëntor**, nga Këshilli i Europës u organizua në Pragë takimi **“Kompetencat normative dhe aftësitë menaxhuese të MKPT-ve.”** Siç e thotë edhe titulli i takimit, theksi u vendos mbi kompetencat e MKPT-ve për të nxjerrë akte normative që përmirësojnë punën e tyre dhe nevojën për forcimin e aftësive të tyre menaxhuese. Në këtë takim mori pjesë edhe Avokatja e Popullit, zonja Erinda Ballanca.



Një Konferencë Rajonale për MKPT-të e vendeve të prekura nga kriza e refugjatëve të Kosovës (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, FYROM) u mbajt në Shkup në datat **20-21 nëntor** me temë: **Integrimi i refugjatëve të Kosovës, zgjidhje e qëndrueshme dhe kthimi vullnetar i tyre.**”

Në Varshavë nga **4-5 dhjetor** u mbajt takimi ekspertëve lidhur me **Monitorimin e Kushteve të Ndalimit dhe Trajtimin të të Ndaluarve në kontekstin e Përballjes me Ekstremizmin e Dhunshëm dhe Radikalizimin që çon në Terrorizëm në institucionet e burgimit.**

Ndërsa në **12-13 dhjetor 2017** u mbajt në Beograd takimi i MKPT-ve të Europës Juglindore me temë “Metodologjia e Vizitave Parandaluese në vendet e paraburgimit.”

### **6.3. Bashkëpunimi më kuadër të projekteve**

Gjatë muajit nëntor 2017, Avokati i Popullit arriti një **Marrëveshje me UNHCR** për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Në këtë kuadër, në Gjirokastrë është vendosur një ekspert i jashtëm i kontraktuar nga institucioni i Avokatit të Popullit, i cili është i pranishëm në momentin e pritjes dhe intervistimit të refugjatëve që mbërrijnë përmes kësaj pike kufitare. Marrëveshja, e cila do jetë efektive edhe gjatë vitit 2018, parashikon promovimin dhe monitorimin i aksesit në territorin dhe në procedurat e azilit për azilkërkuesit dhe refugjatët e identifikuar në kufijtë shqiptarë, rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse lidhur me azilin dhe të drejtat e njeriut, si dhe mbështetjen për promovimin e informacionit për refugjatët dhe azilkërkuesit

Në muajin dhjetor 2017, Avokati i Popullit nënshkroi një marrëveshje për bashkëpunimi me **Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)** me qëllim përmirësimin e shërbimeve sociale. Fokusi i projektit ka të bëjë me përmirësimin e kapaciteteve për lëvrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë, veçanërisht romët. Krahas ngritjes së kapaciteteve,

projekti parashikon edhe ndërgjegjësimin e përfituesve për të drejtat e tyre sociale, përfshirë të drejtën e mosdiskriminimit. Duke qenë se projekti është rajonal, një vend të rëndësishëm ze edhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira me partnerët që kontribuojnë në këtë fushë në vendet e rajonit.

Më datë 3 tetor 2017, Avokati i Popullit dhe University Research CO., LLC, nënshkruan **Memorandumin e Mirëkuptimit për zbatimin e projektit të USAID “Transparenca në Sistemin Shëndetësor”** në Shqipëri. **Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID)**, është duke financuar një projekt për transparencën në shëndetësi.



Avokati i Popullit së bashku me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe ILDKPI janë përfitues të këtij projekti. Deri tani projekti ka ofruar një numër trainimesh për stafin e Avokatit të Popullit, përfshirë edhe zyrat rajonale të tij. Synimi është forcimi i koordinimit ndërinstytucional për të luftuar korrupsionin në sektorin e shëndetësisë përmes rritjes së ndërgjegjësimit të pacientëve dhe publikut në tërësi por edhe të strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikqyerjen e shërbimit shëndetësor dhe respektimin e standardeve dhe protokolleve mjekësore. Projekti do të shtrihet edhe për vitin 2018.

Në kuadër të një programi të **Agjencisë Bullgare për Zhvillimin Ndërkombëtar**, Avokati i Popullit është përfitues i një projekti për forcimin e kapaciteteve administrative të institucionit. Projekti është finalizuar në fund të vitit 2017 dhe do të zgjasë 18 muaj. Ai parashikon forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve për rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të ankesave në institucion.

## 6.4.Projekti Danez

Siç është raportuar edhe më parë, Mbretëria e Danimarkës nëpërmjet një granti të akorduar që prej vitit 2012 e ka ndihmuar financiarisht institucionin e Avokatit të Popullit në drejtim të përmbushjes së rolit të tij kushtetues në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve.

Edhe pse janë vërejtur nga viti në vit ndryshime pozitive në aspektin e realizimit të Projektit Danez “Mbështetja Daneze për Avokatin e Popullit të Shqipërisë – më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2016)”, në fund të vitit 2016 mbetën ende fonde të papërdorura, dhe kjo kryesisht për shkak të procedurave që lidheshin me prokurimet publike.

Megjithatë, shumica e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar sipas planit të miratuar.

Janë bërë përpjekje të mëdha për të përdorur në mënyrë rigorozë të gjitha fondet e vëna në dispozicion me qëllim realizimin e sa më shumë aktiviteteve në funksion të realizimit të objektivave institucionale, por gjithmonë duke ndjekur dhe respektuar rigorozisht legjislacionin shqiptar në fushën e prokurimeve publike.

Një hap pozitiv përpara ishte vendimi i Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Danimarkës për një shtrirje pa kosto së pari deri në fund të vitit 2016 dhe më vonë **deri në fund të shtatorit 2017**. Kjo i dha hapësirë Institucionit AP që të vazhdojë të ushtrojë aktivitetet e saj kryesore pa pasur ndonjë kufizim financiar për të realizuar misionin e vet promovues dhe ndërgjegjësues në fushat e mbuluara nga projekti.

Në bazë të këtij vendimi, institucioni i Avokatit të Popullit hartoi dhe realizoi një plan aktiviteteesh për tu realizuar gjatë vitit 2017, pamvarësisht angazhimeve madhore që kishte Avokati i Popullit, në kuadër të mbarëvajtjes së proceseve që legjislacioni në fuqi për zbatimin e Reformës në Drejtësi, i ngarkonte atij si përgjegjësi ligjore.

Në kuadër të realizimit të aktiviteteve për vitin 2017, vlen të përmenden studimet e realizuara, nëpërmjet kontraktimit të organizatave jo-fitimprurëse, e që lidheshin me “Ngacmimin moral dhe seksual në administratën publike shqiptare” (mars 2017) si dhe “Përcaktimi i minimumit jetik”(prill 2017), studime të cilat u prezantuan në aktivitetet e zhvilluara për bërjen publike të gjetjeve dhe rekomendimeve të ofruara për institucionet publike; organizimin e dy vizitave studimore në Spanjë dhe Danimarkë; vazhdimin e botimit të revistës së institucionit; realizimin e seminareve në lidhje me trajnimin e mësuesve në lidhje me fushën e të drejtave të njeriut; fuqizimin e mëtejshëm me literaturë të Qendrës së Dokumentacionit për të Drejtat e Njeriut; trajnimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të zyrave rajonale të Avokatit të Popullit; përkthimin dhe botimin e raporteve të institucionit; nisjen e procesit të hartimit të Planit të ri Strategjik të institucionit të Avokatit të Popullit, etj.

Në përgjithësi, duhet të nënvizohet se Projekti Danez ishte për Institucionin e AP-së një mbështetje e madhe drejt ushtrimit të rolit të tij kushtetues në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Projekti ka arritur shumë rezultate dhe ka rritur në mënyrë të konsiderueshme kapacitetet e stafit të saj përmes trajnimeve, inspektimeve më cilësore, vizitave studimore, përgatitjes së dokumenteve profesionale, raporteve studimore dhe materialeve të tjera promovionale.

Institucioni i Avokatit të Popullit u përpoq të ndryshonte kulturën e trajtimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri në këto vite dhe projekti danez ndihmoi në mënyrë të konsiderueshme në arritjen e këtij qëllimi. Institucioni i Avokatit të Popullit tani është më i aftë në menaxhimin e projekteve të kësaj natyre si dhe do të ketë mundësinë të çojë një hap përpara rezultatet e arritura nëpërmjet



mbështetjes të projektit danez. Pavarësisht kufizimeve buxhetore, Institucioni i AP-së do të jetë në gjendje të marrë vendime të qëndrueshme bazuar në njohuritë e fituara në kuadër të këtij projekti.

Për gjithë këtë kontribut të ofruar nga qeveria e Mbreterisë së Danimarkës, në muajin shtator 2017, Avokatja e Popullit, znj. Ballanca, gjatë vizitës së zhvilluar në Danimarkë dhe takimeve të zhvilluara me Ministrinë daneze të Punëve të Jashtme, Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut dhe Ombudsmanin Parlamentar të Danimarkës, falënderoi institucionet daneze për ndihmën e tyre të vazhdueshme dhe theksoi rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me Avokatin e Popullit të Danimarkës dhe dhe Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut edhe pas përfundimit të projektit, pasi ky bashkëpunim konsiderohet vendimtar për institucionin.



Si rrjedhojë e këtyre takimeve, është rënë dakort që Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut të vazhdojë të mbështesë me ekspertizë hartimin e **Planit të ri Strategjik (2018-2021)** të institucionit të Avokatit të Popullit, për të vazhduar përpara punën e nisur që në vitin 2017. Ky plan strategjik, i cili mendohet të përfundojë brenda muajit shtator 2018, do të shërbejë si një udhëzues i dobishëm në përmbushjen e angazhimeve të Avokatit të Popullit ndaj qytetarëve dhe institucioneve, si dhe në përmirësimin dhe zgjerimin e fokusit të veprimtarisë së Institucionit.

Gjithashtu, ky dokument strategjik do të duhet të përfshijë një seri prioritetesh dhe fushash, me qëllim për të kontribuar në arritjen e vizionit të Institucionit për një shoqëri që udhëhiqet nga parimet e të drejtave të njeriut, e ku institucionet shtetërore veprojnë në mënyrë transparente, të drejtë, të përgjegjshme dhe efektive.

Gjatë muajit tetor 2017, me përfundimin e projektit danez u hartua dhe raporti përkatës i cili përshkruan progresin e bërë në kuadër të zbatimit të projektit, gjatë fazës së fundit të zbatimit të tij nga 1 korriku 2016 deri në 30 shtator 2017. Ky raport u përgatit nga institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me drejtuesin kryesor të projektit (z. Francesco Castellani) dhe njëkohësisht Këshilltarin për monitorim dhe vlerësim të projekteve në Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut, raport i cili u dërgua pranë Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Danimarkës.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 37, të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, me shkresën nr.80, datë 26.02.2018, i është dërguar zyrtarisht Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat) një informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të Projektit Danez për periudhën janar- shtator 2017.

Ajo çka duhet të theksohet është fakti që Avokati i Popullit si një institucion kushtetues që promovon dhe mbron të drejtat e njeriut, duhet të ketë vlerësimin maksimal dhe mbështetjen e nevojshme financiare, në rradhë të parë, nga buxheti i shtetit me qëllim realizimin e aktiviteteve të cilat janë në funksion të mbrojtjes së qytetarëve nga veprimet apo mosveprimet e paligjishme të organeve të administratës publike.

Kjo, për arsye se përfundimi i këtij projekti (shtator 2017), u shoqërua nga mosmiratimi nga Kuvendi i Shqipërisë, në kuadër të hartimit të buxhetit të shtetit për vitin 2018, të kërkesave mininale të paraqitura nga institucioni i Avokatit të Popullit për të mbuluar financiarisht një pjesë të aktiviteteve të financuara më parë nga projekti Danez Projekti.

## **KREU 7**

### **Shërbimet mbështetëse**

#### **7.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative**

Në një administratë publike moderne, nëpunësit civilë konsiderohen si pjesë e një trupe të mirëpërgatitur, profesionale dhe elitë, të cilët janë rekrutuar për t'i shërbyer interesit publik dhe për të qenë të përgjegjshëm për veprimet e ndërmarra në interes të qytetarëve. Menaxhimi i burimeve njerëzore synon zhvillimin e një shërbimi civil profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë. Gjithashtu, ky menaxhim duhet të jete i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, drejt qasjeve demokratike të drejtimit duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe performancës së sukseshme.

Për këtë arsye, menaxhimi i burimeve njerëzore në institucionin e Avokatit të Popullit përbën një qasje sistematike që synon:

- zhvillimin e vazhdueshëm dhe rekrutimin e personelit të përshtatshëm që ti shërbejë më mirë objektivave organizativ dhe institucional, në përputhje me legjislacionin në fushën e shërbimit civil;
- Sigurimin e mundësive të barabarta për trajnimin dhe zhvillimin e karrierës, si dhe
- Motivimin e punonjësve.

Një institucion kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (siç është institucioni i Avokatit të Popullit), duhet të veprojë domosdoshmërisht me “Parimet e Parisit”, të cilat përcaktojnë kompetencat, përgjegjësitë, përbërjen dhe garantojnë pavarësinë dhe pluralizmin. Për më shumë, Parimet e Parisit, sanksionojnë se “Një institucion kombëtar duhet të ketë një infrastrukturë që mundëson një drejtim të kënaqshëm të aktiviteteve të tij....Institucioneve të tilla u nevojitet një mbështetje e vazhdueshme politike dhe financiare nga parlamenti dhe qeveria, për të vazhduar të kryejnë detyrat e tyre në një mënyrë sa më efektive dhe të pavarur”.

Me miratimin e ligjit nr.130/2016, datë 15.12.2016, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2017”, numri i punonjësve të institucionit shkoi në 56 (pesëdhjetë e gjashtë), duke marrë në konsideratë propozimin e paraqitur nga institucioni në lidhje me shtimin e një punonjësi për pozicionin e ri “**Bibliotekar/Arkivist**”, në përputhje me klasifikimin e pozicioneve të punës të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”. Ky pozicion pune rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punes, dhe fokusohet në mirëmbajtjen dhe restaurimin e fondit arkivor/dokumentar të institucionit, krijimin e sistemeve të arkivimit të dokumentacionit në përputhje me ligjin përkatës për arkivat si dhe në menaxhimin, drejtimin, dhe mbarëvajtjen e Qendrës së Informimit për të Drejtat e Njeriut të ngritur pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Një nga arsyet e propozuara për ndryshimin e strukturës ekzistuese, lidhet edhe me faktin e rishikimit të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i miratuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015. Në bazë të këtij rishikimi, ligji përcakton kritere të reja për pozicionin e nëpunësit zbatues, sipas të cilit “Nëpunësi zbatues i nivelit të parë dhe të dytë, është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues (Sekretari i Përgjithshëm) dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike (master shkencor ose profesional) dhe ka përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion”. Bazuar në ndryshimet e ligjit, të gjitha njësitë publike duhet që të marrin masa për përmbushjen e këtyre kritereve për nëpunësit zbatues ekzistues të të gjitha niveleve, brenda një periudhe kalimtare dyvjeçare.

Duke mos pasur “luksin” e krijimit të dy drejtorive të ndara për shkak të numrit të kufizuar të burimeve njerëzore të cilat nuk mundësojnë plotësimin e standardeve që kërkohen në drejtim të formatimit të njësitë të strukturës, që lidhen me drejtoritë dhe sektorët përkatës, zgjidhja më e mirë ishte krijimi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, e cila mbulon kryesisht çështjet që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve të ofruara për institucionin, ndërkohë që Sektori i Financës dhe Prokurimeve, duke ruajtur të njëjtin numër punonjësish dhe duke pasur të njëjtin përshkrim pune, kaloi në varësi të drejtpërdrejtë të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit.

Një tjetër ndryshim në strukturën e institucionit ishte dhe shtimi me një ndihmëskomisioner i Seksionit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Kjo strukturë funksiononte në bazë të formatit 1+2 (një Komisioner dhe dy ndihmëskomisioner). Duke pasur parasysh rolin dhe misionin që institucioni ka në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të fëmijëve, promovimin dhe respektimin e vazhdueshëm të të drejtave të tyre, për të

nxitur garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së tyre të jetës, si dhe problematikave që hasen në jetën e përditshme për respektimin e këtyre të drejtave, u konsiderua e domosdoshme fuqizimi i kësaj strukture me një tjetër ndihmëskomisioner. (*Formati 1+3, nje Komisioner dhe tre ndihmëskomisioner*)

Në situatën kur numri i ndihmëskomisionerëve, dhe me miratimin e buxhetit të vitit 2017, mbeti i pandryshueshëm, e vetmja zgjidhje që u ndoq në këtë rast ishte ndryshimi i numrit të ndihmëskomisionerëve të Seksionit të Përgjithshëm nga pesë në katër ndihmëskomisionerë.

Të gjitha ndryshimet e mësipërme, u formalizuan nëpërmjet miratimit të urdhërit të Avokatit të Popullit nr. 05, datë, 04.01.2017 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”.

Pas amendimeve që ju bënë në nëntor 2014 ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, institucioni i Avokatit të Popullit në vazhdimësi, ka përsëritur procesin e përzgjedhjes së kandidaturave për dy vende vakante për Komisioner (*Komisioner në Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe Komisioner në Mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës*).

Për arsye të ndryshme ky proces nuk arriti të përfundonte, ndaj në respekt të pikës 2, të nenit 33/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, gjatë muajit janar 2017, institucioni i Avokatit të Popullit, se bashku me dy vendet e paplotësura për pozicionet e lartpërmendura, shpalli edhe nisjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për 3 (tre) Seksionet e tjera, përkatësisht:

a. *Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

b. *Komisioner për policine, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor;*

c. *Komisioner në Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve*

Pas zhvillimit të një procesi vlerësimi, Avokati i Popullit z.Igli Totozani, në datë 22.05.2017, i përcolli Kuvendit të Shqipërisë, listën e kandidaturave për pozicionet e mësipërme<sup>2</sup>.

Më pas Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend, ftoi në një seancë dëgjimore në datë 14 nëntor 2017 kandidatët e propozuar nga Avokati i Popullit z. Igli Totozani, por brenda vitit 2017 Kuvendi nuk arriti të merrte një vendim për zgjedhjen e Komisionerëve të Avokatit të Popullit (ky proces përfundoi vetëm për dy Komisionerë në mars 2018). Vlen të theksohet se mungesa e gjatë e Komisionerëve, ka vështirësuar punën e institucionit.

Një moment mjaft i rëndësishëm për institucionin ishte edhe zgjedhja e Avokatit të ri të Popullit. Mandati i Avokatit të mëparshëm të Popullit z. Igli Totozani, përfundoi në fund të dhjetorit 2016. Konform parashikimeve të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar z. Totozani ndeji në detyrë deri në zgjedhjen e Avokatit të ri znj. Erinda Ballanca, e cila më 22 maj 2017 u zgjodh nga Parlamenti në detyrën e Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë për një mandat pesëvjeçar.

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike”, Avokati i

---

<sup>2</sup> Në lidhje me problematikën e konstatuar Avokati i Popullit me shkresën nr. 369 prot., dt.

20.10.2017, ka vënë në dijeni Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit

Popullit, ka miratuar rregulloren e brendshme “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit”, si dhe ngritjen e funksionimit të njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në institucionin e Avokatit të Popullit.

Këto akte administrative të miratuara, janë në funksion të parandalimit dhe goditjes së çdo praktike të dyshuar korruptive në institucionin e Avokatit të Popullit si dhe nxisin dhe mbrojnë individët që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

## 7.2. Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Në mbështetje të ligjit nr. 130/2016, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2017", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 8, datë 13.01.2017, "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2017", performanca e produktit të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2017, paraqitet si më poshtë:

### Programi - “Shërbimi Avokatisë”

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2017-2019 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave të produktit të përcaktuar të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2017-2019).

### Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2017.

Me Ligjin Nr. 130/2016, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2017", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

#### Raporti i Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Tabela nr. 1

Nr. Lloj	Emërtimi	Plani	Shtesa &	Plani	Fakti
600	Paga	72.300.000		72.300.000	68.223.048
601	Sig. Shoqërore	12.200.000		12.200.000	9.623.548

602	Mallra dhe shërbime të	16.500.000	-200.000	16.300.000	12.161.377
605	Transferta. Korente të	1.500.000	200.000	1.700.000	1.673.605
606	Transf për buxhetet		723.600	723.600	723.600
231	Investimet	4.000.000		4.000.000	3.922.047
	<b>TOTALI</b>	<b>106.500.000</b>	<b>723.600</b>	<b>107.223.000</b>	<b>96.327.225</b>

## Raporti Vjetor i Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2017

**Tabela nr. 2**

Nr	Emërtimi	Plani i	Fakti		Realizimi në
1	Paga	72.300.000	68.223.048	4.076.952	94,40
2	Sig. Shoqërore e	12.200.000	9.623.548	2.576.452	78,90
3	Mallra dhe shërbime të	16.300.000	12.161.377	4.138.623	74,60
4	Transferta. Korente të	1.700.000	1.673.605		98,40
5	Transf për buxhetet	723.600	723.600		100
6	Investimet	4.000.000	3.922.047		98,00
	<b>Totali</b>	<b>107.223.000</b>	<b>93.464.397</b>	<b>10.896.375</b>	<b>87,20</b>



### 1-Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikë, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fond i akorduar për vitin 2017, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli është 72.300.000 lekë, ndërsa realizimi është 68.223.048 lekë ose 94,40%, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë në plan 12.200.000 lekë, ndërsa realizimi është 9.623.548 lekë ose në masën 78,90%. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2017 janë realizuar në masën 92,10%. Gjatë vitit 2017, numri mesatar i punonjësve ka qenë 51,10 punonjës nga 56 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2016 dhe gjatë vitit 2017, si dhe nga lëvizja e punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera.

## **2.- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera**

Fondi i akorduar për periudhën Janar – Dhjetor 2017 për shpenzime mallra dhe shërbime (**zëri 602**) ishte 16.500.000 lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 6579/1 Prot., datë 12.05.2017, “Transferim fonde për vitin 2017” në 16.300.000 lekë, ndërsa realizimi është 12.161.337 lekë ose 74.60% e buxhetit të ndryshuar.

Për vitin 2017 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, furnizime me materiale të tjera zyre, njoftime publikime në gazeta dhe botime, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafonë, shërbimi postar, siguracion automjeteve, blerje karburant, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime për mirëmbajtje ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtje aparatura e pajisje teknike, shpenzime pritje-përcjellje të huajve, shpenzime për taksa të paguara

Fondi për transferta korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2017, ishte 1.500.000 lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 6579/1 Prot., datë 12.05.2017, “Transferim fonde për vitin 2017” në 1.700.000 lekë ndërsa realizimi është 1.673.605 lekë ose 98,40% i buxhetit të ndryshuar.

Për vitin 2017 këto fonde janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në kohë të kuotave të anëtarësimit ku institucioni i Avokatit të Popullit është anëtarë në organizata ndërkombëtare si Association des Ombudsmans et Mediateurs de la Francophonie (AOMF), European Ombudsman Institute (EOI), Association of Mediterranean Ombudsman (AOM), International Ombudsman Institute (IOI), Global Alliance of National Human Rights Institutions (GANHRI), European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI), si dhe European Network of Ombudspersons for Children (ENOC).

Fondi për transferta buxhetore familjare dhe individë (**zëri 606**) për periudhën Janar - Dhjetor 2017, është 723.600 lekë, ndërsa realizimi është 723.600 lekë ose 100% i buxhetit.

## **3.- Shpenzime në investime**

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2017 është 4.000.000 lekë, ndërsa realizimi është 3.922.047 lekë ose 98% i buxhetit të rishikuar. Për përmirësimin e kushteve të godinës të institucionit të Avokatit të Popullit janë bërë këto investime (shiko tabelën e

mëposhtme).

në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
1. Blerje pajisje	M660001	1.000	970	97
2. Blerje automjeti	M660003	3.000	2.952	98
<b>TOTALI</b>		<b>4.000</b>	<b>3.922</b>	<b>98</b>

#### 4. Miratimi i Buxhetit të institucionit për vitin 2018

Duke filluar nga viti 2013, institucioni i AP është financuar nga Projekti Danez, i cili ka mbuluar një teresi aktiviteteve të realizuara në funksion të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Me konkretisht, në kuadër të këtij projekti janë harxhuar ndër vite:

VITET	Buxheti i Institucionit (602)		Projekti Danez	%
	Plan	Realizimi	Realizimi	
<b>2013</b>	14.450.000	13.845.607	5.546.110	40,06
<b>2014</b>	15.000.000	12.254.477	8.683.302	70,86
<b>2015</b>	17.000.000	15.243.643	22.219.468	145,76
<b>2016</b>	15.500.000	12.283.991	21.473.401	174,81
<b>2017</b>	16.500.000	12.161.377	8.986.747	73,90

Gjate këtyre viteve të sipër-përmendura, fondet e marra nga buxheti i shtetit për institucionin e Avokatit të Popullit, kanë ndjekur të njëjtin trend duke mbetur në të njëjtat linja buxhetore si dhe duke ruajtur ato nivele financimi të përcaktuara nga Programi Buxhetor Afat-mesëm (PBA), ndërkohe që nuk ka qenë e nevojshme paraqitja e kërkesave apo nevojave për ndryshimin e nivelit të financimit të këtij buxheti. Kjo, për atë kohë sa aktivitetet kryesore që lidheshin me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut mbuloheshin nga projekti Danez.

Duke pasur në konsideratë perfundimin e projektit danez (shtator 2017), në kuadër të përgatitjes së Projekt buxhetit për vitin 2018, iu kërkua fillimisht MF dhe Komisionit për Çështjet Ligjeve, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë, një fond minimal shtesë në zërin **Shpenzime Operative (602), në shumën prej 5 milione lek.**

Kjo kërkesë kishte të bënte me mbulimin aktivitetëve që lidheshin: me ndjekjen dhe monitorimin e pranimin dhe zbatimin të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga administrata publike; Prodhimin/publikimin e raporteve të veçanta, materialesh promovuese, revistes së institucionit,



banera etj; Organizimin e konferencave, auditoriumeve, trajnime të ndryshme, studime në fusha të veçanta; inspektime dhe organizim te diteve te hapura.

Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ligjeve, u mirëkuptua dhe pranua kërkesa për mbështetjen e këtij propozimi (për një shtesë prej 5 mil), ndërkohë që në raportin e përgatitur nga ky Komision per Komisionin e Ekonomise, sugjerohej **vetëm miratimi i një shtesë prej 2 milionë lekë.** Komisioni i Ekonomise nuk mori fare në konsideratë propozimin përkatës, **duke mos miratuar asnjë fond shtesë** për institucionin e AP, për vitin 2018.

Krahasuar me buxhetin e vitit 2017 (ku për më shumë institucioni vazhdonte kishte edhe mbeshtetjen financiare te projektit Danez), buxheti i vitit 2018 në zërin Shpenzime Operative (602), rezulton në shumën prej **1mil lek më pak,** gjë që afekton veprimtarinë normale të institucionit në kuadër të realizimit të objektivave institucionalë.

### **7.3. Forcimi i kapaciteteve**

Forcimi i kapaciteteve të stafit vazhdon të jetë një ndër prioritetet e institucionit të Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2017. Një ndihmesë shumë e madhe në këtë drejtim kanë qenë mbështetja e ofruar nga donator të ndryshëm, ku vlen të përmendet në rradhë të pare mbështetja e ofruar nga projekti danez për forcimin e kapaciteteve të Avokatit të Popullit.

Ky projekt mundësoi dy udhëtime studimore për dy grupe punonjësish. Vizita e parë studimore u krye në Danimarkë në datat 10-13 shtator 2017. Gjatë kësaj vizite, stafi i Avokatit të Popullit realizoi takime në zyrën e Ombudsmanit danez, pranë Institutit Danez për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe pranë Ministrisë së Jashtme daneze.

Gjatë kësaj vizite, anëtarët e delegacionit panë nga afër mënyrën e funksionimit të këtyre institucioneve dhe, përmes prezantimeve të ndryshme, u njohën me problematikat e ndeshura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Vizita e dytë u realizua në Barcelonë në datat 18-21 shtator dhe ishte e dedikuar për stafin mbështetës të institucionit me qëllim marrjen e përvojës menaxhuese pranë Omdusmanit të Katalonjës. Fokusi i vizitës u vendos mbi problemet e menaxhimit financiar dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe çështje të tjera administrimit të institucionit.

Po ashtu, projekti i financuar nga BE, dhe i zbatuar nga KiE për forcimin e efektivitetit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe luftës kundër diskriminimit, mundësoi një vizitë studimore në Strazburg pranë KiE dhe pranë Gjykatës së të Drejtave të Njeriut.

Pjesëmarrësit u njohën nga afër me punën që bëjnë struktura të caktuara të Kie si p.sh, në mbrojtje të minoriteteve, personave LGBTI, kundër diskriminimit, etj. Në mjediset e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, pjesëmarrësit u njohën me çështjet e trajtuara nga Gjykata dhe mënyrën e funksionimit të saj.

Një tjetër mundësi për trajnimin e stafit u ofrua nga Akademia e përvitshme e ENNHRI, e cila në 2017 u zhvillua në Poznan, Poloni nga 29 maj deri në 2 qershor. Tema e vitit 2017 kishte dy boshte: a. Promovimi i të drejtave të njeriut në mjedise të vështira dhe b. Të drejtat e njeriut dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG).Të dyja temat paraqitën rëndësi të veçantë sa i

takon punës promovuese të institucionit për të drejtat e njeriut dhe vendosjen e SDG-ve në themel të punës së institucioneve dhe administratës për përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë, veçanërisht shtresave vulnerabël.

Në kuader të programit të përbashkët BE/Këshilli i Evropës mbi rritjen e efektivitetit të Sistemit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit, gjatë muajit nëntor 2017, ekspertë lokalë dhe ndërkombëtarë mundësuan realizimin e dy raunde trajnimesh për stafin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe stafin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në lidhje me amicus curiae.

Gjatë periudhës Tetor 2017 – Janar 2017, Këshilli i Europës në zbatim të Programit Evropian për Edukimin për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë (HELP) zhvilloi dy trajnime online për një pjesë të stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të zyrave rajonale me temë: “Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut” si dhe “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Azil-Kërkuesit”.

Qëllimi i tyre ishte që stafi i Institucionit të Avokatit të Popullit të trajnohej: 1. lidhur me fushën e të Drejtave të Njeriut në sektorin privat, zbatimin dhe respektimin e të Drejtave të Njeriut nga bizneset, kompanitë apo korporatat, si edhe përgjegjësia e shtetit në rastet kur sektori privat nuk respekton të drejtat e punonjësve ose në rastet kur shërbimi i ofruar prej tij dëmton komunitetin apo mjedisin përreth; 2. lidhur me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të azil-kërkuesve, procedurat administrative dhe të drejtën e ankimit të azil-kërkuesve sipas legjislacionit shqiptar.

## Kreu 8

### Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

#### 8.1. Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të shqyrtuara

Në Raportin Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit një vend të veçantë zë edhe pasqyrimi i statistikave për prezantimin e numrit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të shqyrtuara nga Institucioni ynë për gjatë gjithë vitit 2017.

Më poshtë do të gjenden të detajuara statistikatat për vitin 2017, të cilat pasqyrojnë më qartë objektin e ankesave, numrin e tyre, mënyrën e trajtimit nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017. Të dhënat e paraqitura i përkasin periudhës 1 janar-31 dhjetor 2017. Në total janë trajtuar nga zyra e Avokatit të Popullit 4546 ankesa, kërkesa dhe njoftime (*duke përfshirë dhe ato të pritjes së qytetarëve*).

Ankesa, kërkesa, njoftime gjatë vitit 2017 që kanë qenë pjesë e objektit të institucionit të Avokatit të Popullit janë 1752 gjithsej. Nga zyra e pritjes së qytetarëve, 2408 ankesa i janë dhënë përgjigje menjëherë, ndërsa 386 ankesa i janë dhënë përgjigje në formën e këshillimeve shkresore.

#### Gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit rezultojnë se janë mbyllur 1263 ankesa si më poshtë vijon:

- 101 Ankesa jashtë Juridiksionit
- 163 Ankesa jashtë Kompetence
- 412 Ankesa të pabazuar
- 17 Ankesa me Rekomandime të Refuzuar
- 48 Ankesa me Rekomandime të Pranuar
- 490 Ankesa të Pranuar pa Rekomandim (*të zgjidhura në favor të qytetarëve*)
- 32 Ankesa me heqje Dorë

#### Paraqitja grafike Nr.1-Trajtimi i ankesave



**Grafiku më poshtë tregon mnyrën e shpërndarjes së ankesave, kërkesave dhe njoftimeve sipas seksioneve në Institutin e Avokatit të Popullit, konkretisht:**


Seksioni i Administratës	<b>604</b> ankesa
Seksioni i Fëmijëve	<b>64</b> ankesa
Seksioni i Veçantë	<b>574</b> ankesa
Seksioni i Përgjithshëm	<b>412</b> ankesa
Njësia e parandalimit të Torturës	<b>98</b> ankesa

**Paraqitja grafike Nr.2-Shpërndarja e Ankesave Sipas Seksioneve**




Tabelat në vijim japin në mënyrë grafike një informacion rreth ankesave që janë trajtuar gjatë viteve nga Institucioni i Avokatit të Popullit.


**Paraqitje grafike Nr.3- Ankesat e ardhura në Institutin e AP ndër vite.**




**Paraqitja grafike Nr.5 – Shpërndarja e ankesave përgjatë vitit 2017 sipas qyteteve**




**Paraqitja grafike Nr.6 – Ankesat e regjistruara gjatë vitit 2017 sipas të drejtës që i janë shkelur qytetarëve**



**Paraqitja grafike Nr.7 – Shpërndarja e ankesave drejtua Institucionit të Avokatit të Popullit drejt Institucioneve Shtetërore dhe institucionet që janë në vartësi të tyre.**




**Paraqitja grafike Nr.8 – Ndarja e ankesave sipas mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes 2017**



## 8.2. Rastet e mbartura në vite

Gjatë vitit 2017 janë mbartur ankesa nga vitet e tjera të cilat janë përfunduar në vitin 2017. Në vitin 2017 janë mbyllur 947 ankesa të cilat janë nga vitet e tjera. Seksioni i Fëmijëve nuk ka ankesa nga vitet e tjera. Më poshtë kemi paraqitur si janë zgjidhur këto ankesa sipas Seksioneve:

### Paraqitja grafike Nr.9 – Zgjidhja e ankesave të mbartura nga vitet e tjera sipas Seksioneve dhe zgjidhja e tyre në 2017



### Paraqitja grafike Nr.10 – Rekomandimet sipas Seksioneve nga ankesat e mbartura 2017

